

PRISHTINA



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

RAPORTI I PUNËS SË KRYESHEFIT EKZEKUTIV DHE I BORDIT TË DREJTORËVE PËR VITIN 2004

PRISHTINË, PRILL - 2005

KRYESHEFI EKZEKUTIV DHE ZËV. KRYESHEFI EKZEKUTIV

Në kuadër të fushëveprimit të tyre, kryeshefi ekzekutiv dhe zëv. kryeshefi ekzekutiv, gjatë periudhës raportuese kanë kryer këto punë:

- Mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe konsultative të Bordit të drejtorëve;
- Kujdesin për ligjshmërinë e punës së organeve administrative, ligjshmërinë e çështjeve financiare, zbatimin e procedurave dhe kontrollit të efektiveve financiare;
- Kujdesin për organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit;
- Bashkëpunimin e ngushtë me udhëheqjen politike dhe komitetet profesionale të Kuvendit;
- Aktivitetet rreth Raportit të punës së Bordit të drejtorëve për vitin 2003 dhe planifikimi për vitin 2004;
- Propozimin e Skemës organizative të administratës së Komunës për vitin 2004 dhe propozimin e vendimeve të tjera për ndryshimet dhe plotësimet e rregulloreve të caktuar komunale;
- Bashkëpunimin e ngushtë me Presidentin, Qeverinë e Kosovës dhe Asociacionin e Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës. Janë bërë takime pune, sidomos me ministrat, apo përfaqësuesit e këtyre ministrive: të Transportit dhe të Telekomunikacionit; të Ekonomisë dhe të Financave; të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë; të Kulturës, të Sportit dhe të Çështjeve Jorezidente; të Planifikimit Hapësinor etj.;
- Bashkëpunimin me: administratën komunale të UNMIK-ut, nivelin qendror të UNMIK-ut, OSBE-në, KFOR-in, Policinë e UNMIK-ut, SHPK-në dhe TMK-në;
- Takimet e punës me: AKM-në, Agjencionin Kadastral të Kosovës, AER-in, UNDPI-në, RIINVEST-in etj.;
- Lëshimin e urdhëresave administrative, të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe me mbarëvajtjen dhe ngritjen e efikasitetit në punën e shërbimit civil të Komunës;
- Aktivitetet lidhur me emërimin e drejtorëve të Shtëpisë së Shëndetit dhe të Entit për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore;
- Aktivitetet lidhur me Planin zhvillimor strategjik urban 2004 – 2020 dhe planet rregullative të disa pjesëve të qytetit;
- Aktivitetet lidhur me formimin e Grupit punues për standarde dhe lidhur me hartimin e Planit strategjik për kthime;
- Pjesëmarrjen aktive të kryeshefit në hartimin e Projektligjit mbi vetëqeverisjen lokale;
- Riorganizimin dhe intensifikimin e punës së Komisionit për identifikimin dhe evidencimin e pronës komunale;
- Organizimin e trajnimeve me punëtorët e komunës lidhur me përdorimin e “intranetit”;
- Fillimin e punës së “intranetit”, i cili ka ndikuar shumë në ngritjen e efikasitetit në punët e administratës;
- Aktivitetet rreth fillimit të punës së “WEB “– faqes së Komunës;
- Aktivitetet lidhur me parandalimin e dhunës gjatë ngjarjeve të marsit dhe formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve;
- Aktivitetet lidhur me tejkalimin e problemeve në ndërmarrjet komunale publike “Trafiku Urban” dhe “Hortikultura”;

- Takimet e shpeshta, individuale apo grupe, me qytetarë lidhur me zgjidhjen e problemeve të ndryshme, sidomos nga fusha e infrastrukturës;
- Takimet e kryeshefit me grupet punuese për standardet, në Durrës;
- Takimet e kryeshefit me Grupin punues për definimin e kompetencave në mes të Nivelit qendror dhe atij lokal (OSBE);
- Pjesëmarrja e zëv.kryeshefit në delegacionin e Komunës, të cilin e udhëhoqi kryetari i Komunës, në vizitën e bërë Budapestit, prej 11-13.10.2004. Gjatë kësaj vizite u organizuan takime me kryetarin e Budapestit, z. Gabor Demskyn dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Budapestit. Vizita ishte organizuar me ftesë të z. Demsky dhe kishte për qëllim thellimin e bashkëpunimit në mes Prishtinës dhe Budapestit;
- Pjesëmarrja e zëv.kryeshefit në takimin e organizuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur i Kosovës (KFOS), të mbajtur në Golem të Shqipërisë, me temën: “Ecuria e funksionimit të rrjetit të intranetit në dhjetë komunat e Kosovës” në të cilat është instaluar ky rrjet;
- Aktivitetet e zëv.kryeshefit në cilësinë e anëtarit të Bordit mbikëqyrës të Pallatit të Rinisë.

DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

1. SEKTORI I PUNËVE TË PËRGJITHSHME JURIDIKE

a) Shërbimi për marrëdhënie pune

Në pajtim me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, përfshirë këtu të gjitha drejtoratet, janë të punësuar gjithsej **636** punëtorë. Prej tyre, 175 janë me PSP (fakultet), 27 me PL (shkollë të lartë), 391 me SHM (shkollë të mesme) dhe 43 me SHF (shkollë fillore). Në listën e pagave të punëtorëve të Kuvendit të Komunës, gjithashtu figurojnë edhe **147** punëtorë të tjerë të disa organizatave si: të teatrit “Dodona”, të bibliotekës komunale “Hivzi Sylejmani” dhe të Qendrës së Pionierëve në Prishtinë.

Shërbimi për marrëdhënie pune, gjatë vitit fiskal 2004, ka kryer këto punë dhe detyra:

- është bërë rregullimi, sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionit personal të të punësuarve në organet e administratës komunale,
- janë përpiluar aktvendime dhe akte të tjera të ndryshme nga marrëdhënia e punës si:
 - aktvendime mbi pushimin e lehonisë,
 - aktvendime për pushim pa pagesë,
 - aktvendime për pushim vjetor,
 - vërtetime të ndryshme për punëtorët e shërbimit civil komunal,
- është bërë futja e dosjeve personale të punëtorëve në kompjuter,
- është bërë kompletimi i dosjeve të punëtorëve me dokumentacionin e nevojshëm,
- janë përpiluar aktvendime mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së punëtorëve,
- janë përgatitur dhe janë shpallur konkurset përkitazi me vendet e lira të punës në administratën komunale,
- është bërë pranimi i aplikacioneve për konkurrim, evidencimi dhe sistemimi i tyre,
- është bërë përpilimi dhe përcjellja e kontratave të punës për të gjithë punëtorët e shërbimit civil komunal, evidencimi dhe futja e tyre në dosjet personale.

b) Shërbimi i byroteknikës

Në këtë shërbim, gjatë periudhës raportuese, gjegjësisht gjatë vitit fiskal 2004, është bërë shumëzimi-fotokopjimi i materialeve për nevojat e drejtorateve të Komunës.

Pasqyra tabelore e kryerjes së këtyre shërbimeve sipas drejtorateve, do të dukej si vijon:

Drejtoratet	nr.i kopjeve	nr. i risëve
1. Drejtorati i Administratës së Përgjithshme.....	283300	566
2. Drejtorati i Pronë dhe i Financave	57200	114
3. Drejtorati i Ekonomisë.....	12630	
4. Drejtorati i Urbanizmit dhe i Planifikimit.....	8930	19
5. Drejtorati i Rinisë dhe i Sportit.....	7340	15
6. Drejtorati i Kulturës dhe i Gjinisë	910	2
7. Drejtorati i Shërb. Publike	4420	9
8. Drejtorati i Zhvillimit Rural	7569	15
9. Drejtorati i Sigurisë Civile dhe i Emergjencës	18872	38
10. Drejtorati i Shëndetësisë	23232	47
11. Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës	28174	56
12. Drejtorati i Inspeksionit.....	12417	25
13. Drejtorati i Kadastërit dhe i Gjeodezisë.....		
14. Zyra e Prokurimit.....	103774	207
15. Kuvendi i Komunës	32002	64
16. Të tjera.....	138871	28
Gjithsej.....	614641	1229

2. SEKTORI PËR SHËRBIME PROFESIONALE TË KUVENDIT DHE TË EKZEKUTIVIT

Sektori për shërbime profesionale të Kuvendit dhe të Ekzekutivit gjatë vitit fiskal 2004 ka kryer këto punë:

- punët administrative në përgatitjen e materialeve për mbledhjet e mbajtura (vendimet, rregulloret e ndryshme etj.),
- përkthimin, lekturimin dhe shpërndarjen e materialeve,
- përpilimin e ekstrakteve nga procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura,
- përgatitjen e rregulloreve, vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga organet komunale dhe shpërndarja e tyre organeve përkatëse.

Është bërë informimi lidhur me aktivitetin e Kuvendit dhe të Ekzekutivit, nga shërbimi përkatës, gjegjësisht nga Zyra për informim.

Në kuadër të këtij Sektori, gjithashtu është koordinuar edhe puna e komiteteve.

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur:

- 8 (tetë) mbledhje të Bordit të drejtorëve,
- 10 (dhjetë) mbledhje të rregullta dhe 2(dy) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa,
- 9 (nëntë) mbledhje të rregullta dhe 1(një) e jashtëzakonshme të Kuvendit, si dhe një mbledhje tjetër e rregullt me qytetarë,
- 236 mbledhje të komiteteve dhe të komisioneve të Kuvendit.

Kuvendi, gjatë kësaj periudhe ka miratuar 51 (pesëdhjetë e një) vendime të ndryshme, përfshirë këtu ndryshimet dhe plotësimet e disa rregulloreve, e në këtë kuadër edhe Rregulloren për lehtësirat e investimeve të jashtme dhe të bizneseve vendore fillestare, si dhe Vendimin mbi aprovimin e Planit strategjik të zhvillimit urban të Prishtinës.

3. SEKTORI TEKNIK

Sektori teknik, në periudhën janar-qershor 2004, ka kryer këto punë dhe shërbime:

- janë mbajtur takime të rregullta pune me përgjegjësit e shërbimeve,
- janë kryer disa punë lidhur me mirëmbajtjen e objekteve të Komunës dhe lidhur me aftësimin e nxehjes qendrore,
- është bërë renovimi i zyrave në autoparkun e Komunës, ku është bërë edhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve,
- janë kryer disa punë teknike në telefoninë fikse, në funksion të zvogëlimit të shpenzimeve,
- është bërë furnizimi me autopjesë dhe me derivate të naftës sipas nevojave, respektivisht sipas kërkesave,
- janë kryer punë lidhur me riparimin teknik të automjeteve,
- është udhëhequr evidenca lidhur me shfrytëzimin e automjeteve dhe përkitazi me shpenzimet e karburanteve ,
- është bërë ndërtimi i trasesë, gjegjësisht i platos në ndërtesën e Komunës,
- është instaluar teknika e klimatizimit në zyrat e regjistrimit civil dhe është bërë vendosja e dy kontejnerëve për nevojat e Sektorit të regjistrimit civil,
- është bërë montimi i aparaturës së “internetit” dhe të “intranetit” në lokalet e Komunës,
- është bërë lidhja e drejtpërdrejtë e ndërtesës së Komunës me atë të Kadastrit përmes hapjes së një dere dhe ndërtimit të shkallëve, që në të kaluarën nuk kanë ekzistuar,
- është bërë gëlqerosja, përkatësisht ngjyrosja e disa zyrave brenda Komunës por edhe disa zyra të bashkësive lokale,
- janë kryer punë shërbyese në bufe, për nevojat e stafit udhëheqës të Komunës dhe për nevojat e punëtorëve,
- është bërë sigurimi i objekteve të Komunës, në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës dhe me Drejtoratin e Sigurisë Civile dhe të Emergjencës,
- është bërë pajisja me aparatet kundër zjarrit, me radio lidhje dhe me uniforma për punëtorët e sigurimit.

4. SEKTORI I BASHKËSIVE LOKALE

Në periudhën raportuese, përkatësisht prej 01.01.2004 deri më 31.12.2004, konform planit vjetor, në Sektorin e bashkësive lokale janë kryer këto punë dhe detyra:

- janë mbajtur takime të rregullta (12 sosh) me kryetarët e bashkësive lokale. Në këto takime janë prezantuar kërkesa të ndryshme lidhur me: infrastrukturën rrugore, ujësjellësin, kanalizimet, lëmin e arsimit, të shëndetësisë dhe të sigurisë civile të qytetarëve. Pastaj, jemi angazhuar që në bashkëpunim me drejtoratet përkatëse, t'i realizojmë këto kërkesa mbi baza të prioriteteve të përcaktuara.
- është realizuar projekti për ndërtimin e zyrës së Bashkësisë llokale në Keçekollë.
- është realizuar projekti për renovimin e zyrave të këtyre bashkësive lokale: të Bashkësisë VII, VII/1 dhe VII/2. Përveç realizimit të projekteve të lartpërmendura, gjithashtu kemi bërë edhe renovimin e zyrave të Bashkësisë X, XIII dhe XIV lokale, këtu në Prishtinë. Për realizimin e këtyre projekteve janë shpenzuar afërsisht 100.000 euro.
- është bërë montimi i dyerve dhe i grilave mbrojtëse në Zyrën e vendit dhe në Bashkësinë lokale në Graçanicë, si dhe në Bashkësinë lokale në Lapllasellë.
- është caktuar lokacioni për ndërtimin e zyrave të BL-ve në fshatrat Hajvali dhe Kishnicë, projekte që do të realizohen gjatë vitit 2005.
- i është kushtuar rëndësi e veçantë ngritjes së nivelit, cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve në administratën e bashkësive lokale,
- janë mbajtur tubime me qytetarë, të cilat ishin në funksion të realizimit të interesave të qytetarëve dhe me qëllim të informimit në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e

tyre. Këto tubime u mbajtën në fshatrat: Besi, Vranidoll, Barilevë, Rimanishtë etj. në të cilat morën pjesë edhe kryetari i Kuvendit të Komunës, z. Ismet Beqiri, me bashkëpunëtorë.

- janë furnizuar me stufa dhe me lëndë ngrohëse të gjitha zyrat e bashkësive lokale, përfshirë këtu edhe zyrat në Graçanicë dhe në Llaplasellë.

5. SEKTORI I REGJISTRIMIT CIVIL - OFIÇARIA

a) Shërbimi i ofiçarisë

Në periudhën raportuese, përkatësisht prej 01.01.2004 deri më 31.12.2004, në këtë shërbim janë kryer këto punë :

- regjistrime të reja në LAL (librat për të lindurit)..... 10582
- regjistrime të mëvonshme në LAL..... 24824
- regjistrime të reja në LAM (librat e të martuarve)... .. 1048
- regjistrime të mëvonshme në LAM..... 1477
- regjistrime të reja në LAV(librat për të vdekurit)..... 2613
- regjistrime të mëvonshme në LAV..... 1605

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar:

- certifikata të lindjes..... 37894
- certifikata të martesës 3428
- certifikata të vdekjes..... 3321
- certifikata mbi statusin martesor..... 3280
- vërtetime që personi është i gjallë..... 589
- deklarata mbi bashkësinë familjare..... 851

Lindjet, martesat dhe vdekjet e qytetarëve tanë që gjenden në botën e jashtme (jashtë Kosovës), që janë evidencuar në shërbimin tonë gjatë periudhës raportuese janë:

- regjistrime speciale në LAL (librin për të lindurit)..... 779
- regjistrime në LAM(librat për të martuarit)..... 132
- regjistrime speciale në LAV(librin për të vdekurit)..... 30
- certifikata të lindjes..... 2616
- certifikata të martesës..... 203
- certifikata të vdekjes..... 36

Ndërrime, korigjime dhe përmirësime të emrave personal:

- ndërrime të emrave personal..... 79
- korigjime të emrave personal..... 418
- përmirësime të emrave personal..... 734

Në Zyrat e vendit, në fshatrat: Marec, Besi, Bardhosh, Dabishec, Slivovë, Llukar, dhe Keçekollë, llogaritur në mënyrë kumulative, janë kryer këto punë :

- regjistrime në LAL..... 4
- regjistrime të mëvonshme në LAL..... 292
- regjistrime të reja në LAM..... 198
- regjistrime të mëvonshme në LAM..... 78
- regjistrime të reja në LAV..... 41
- regjistrime të mëvonshme në LAV..... 64

Janë lëshuar:

- certifikata të lindjes 2972
- certifikata martesore 920
- certifikata të vdekjes 85

- certifik. mbi statusin martesor	740
- vërtetime që personi është i gjallë.....	10
- deklarata mbi bashkësinë familjare.....	02

b) Shërbimi i vërtetimeve dhe i përkrahjeve

Gjatë periudhës raportuese, përkatësisht prej 01.01.2004 deri më 31.12.2004, në këtë shërbim janë përkrahur dhe janë vërtetuar dokumentet si në vijim:

- deklarata me dy dëshmitarë.....	183
- deklarata mbi bashkësinë familjare.....	1227
- vërtetim të fotokopjeve(përkrahjeve).....	28582
- vërtetim i nënshkrimeve.....	03

Në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil, gjatë periudhës raportuese janë kryer këto punë:

- regjistrime të konfirmuara dhe rish. për të rritur.....	4157
- regjistrime të fëmijëve.....	2285
- regjistrime të fëmijëve për dokumente të udhëtimit.....	2285
- kërkesa speciale-regjistrim.....	11
- dokumente të identifikimit të UNMIK-ut, të lëshuara.....	10164
- kanë aplikuar për dokumente të udhëtimit të UNMIK-ut.....	5606
- janë lëshuar dokumente të udhëtimit të UNMIK-ut.....	11384
- kanë aplikuar për vazhdim të dokumenteve të udhëtimit.....	8260
- janë vazhduar dhe lëshuar dokumente të udhëtimit.....	2086
- dok. të udh. dhe d. të id. të humb., të vjedh. dhe të dëmt.	1595
- korrigjime dhe ndërrime të d. i. dhe të d. u.	5134
- kopje të l. nj. dhe të pasaportave jugosllave, të lëshuara.....	3634

Objektet, respektivisht hapësirat që shfrytëzohen nga Sektor i regjistrimit civil, nuk i plotësojnë kushtet për punë efikase siç kërkojnë nevojat e kohës. Andaj, vlerësojmë se është i nevojshëm krijimi i hapësirave të reja për punë normale dhe për punë më efikase në shërbim të qytetarëve.

Konsiderojmë se është me interes të përmendet në këtë raport fakti se gjatë periudhës raportuese d.m.th gjatë këtij viti, numri i të lindurve dhe ai i të martuarve është rritur në krahasuar me vitet e kaluara.

Çështje me rëndësi për t`u përmendur, lidhur me Zyrat e vendit në zonën rurale, të cilat janë pjesë e Sektorit të ofiçarisë, është kompetenca jo e plotë për nënshkrimin dhe vulosjen e dokumenteve të lëshuara nga zyrat në fjalë.

Përveç punëve të përkrahura në këtë raport, në kuadër të Drejtoratit të Administratës së Përgjithshme janë kryer edhe disa punë të tjera, siç janë punët rreth ndërrimit të patentë-shoferëve. Siç dihet, ndërrimi i patentëshoferëve është kompetencë e Ministrisë së Shërbimeve Publike, por prej korrikut të vitit 2001, kjo kompetencë është bartur te Drejtorati i Administratës së Përgjithshme. Përkundër kërkesës së Drejtoratit të Administratës, Ministria e Shërbimeve Publike, deri më sot, asnjëherë nuk ka derdhur mjete financiare në dobi të Komunës, përkitazi me kryerjen e këtyre shërbimeve.

Vërejtje: Përkundër faktit se punët e kryera në Qendrën komunale të regjistrimit civil janë përfshirë brenda raportit të Drejtoratit të Administratës së Përgjithshme, ato janë kompetencë e rezervuar për administratën e UNMIK-ut.

DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT, MBROJTJE SË AMBIENTIT DHE I TOKËS NDËRTIMORE

Lëmin të cilën e mbulon Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore është mjaft e gjerë. Uji, kanalizimi, rryma, ngrohja, pastërtia, transporti, infrastruktura rrugore, ndriçimi publik dhe mbrojtja e ambienti, janë objektiva tona që kërkojnë angazhime maksimale. Me qëllim të kompletimit sa më të mirë të projekteve, janë angazhuar DUPN-ja, DGJK-ja dhe DZHR-ja.

Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore, aktivitetet e veta është duke i zhvilluar në përputhje me planin e punës për vitin 2004.

SHËRBIMI I ADMINISTRATËS SË DREJTORATIT

Gjatë vitit 2004 kemi hartuar akte normative, vendime dhe aktvendime të përgjithshme juridike të Drejtoratit. Në këtë periudhë kemi realizuar 257.990.18 € të hyra në kuadër të Drejtoratit. Kemi përcjellë për pagesë situacione, fatura dhe lëndë për eksproprijim e verifikim të pronësisë - 181 lëndë dhe akte të përcjella nga Drejtorati ynë, në drejtoratet tjera. Kemi bërë furnizimin me shërbime, mallra, inventar të nevojshëm dhe mjete themelore, planifikimin e shpenzimeve të materialit hargjues dhe detyrat e përgjithshme në Drejtorat.

Gjatë vitit 2004 kemi pranuar dhe zgjidhur këtë numër të lëndëve, akteve, përgjigjeve në Drejtoratin tonë:

- 1357 lëndë të pranuar,
- 1336 lëndë të zgjedhura (kryera) dhe
- 21 lëndë në procedurë.

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Është bërë sanimi i rrjetit të ngrohjes në disa rrugë të qytetit (investim i Ngrohtores).

1. Higjiena publike në qytet

Në krahasim me vitin e kaluar, në këtë vit është paraparë të pastrohen 42 rrugë në qytet. Pastrimi dhe larja e rrugëve dhe e trotuareve i është besuar NP "Higjiena-teknika" për 17 rrugë, ndërsa Kompanisë "Toifor" 25 rrugë. Projekti për pastrimin e rrugëve është kryer me sukses dhe ka përfunduar më 15.11.2004, vëllimi financiar 226.931,60.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve është e ndarë në dy grupe.

Në grupin e parë janë 31 rrugë, të mirëmbajtura nga SH P K „TOIFOR” me gjatësi prej 24.36 km, si dhe debllokimin e kanalizimit atmosferik të gjithsejtë 196 pusetave, të 25 rrugëve. Nr.L.01-62/04, të dt. 12.11.2004. Vëllimi financiar 47.307,37 €

Në grupin e dytë janë 51, rrugë të mirëmbajtura nga N K P, „Higjiena -teknika”, me gjatësi 41.46km, si dhe pastrimi dhe debllokimi i pusetave të kanalizimit atmosferik, gjithsejtë 159 copë, me vëllim financiar 53.190,32 €. Nr.L.01-62/04, të datës 12.11.2004.

Furnizimi me kripë dhe zhavor „V.invest – 2004” 16.699,09.

Kemi pranuar 10 lëndë, 5 prej tyre janë të zgjidhura, ndërsa 5 janë në procedurë.

2. Shërbimi elektro energjetik

Gjatë vitit 2004, në shërbimin energjetik kanë arritur 138 kërkesa nga lëmi i elektrikës dhe ai i PTK-së etj, prej të cilave 137 janë zgjidhur, ndërsa 1 prej tyre gjendet në procedurë e sipër, me këtë përmbajtje:

- mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe
- mirëmbajtja e semaforëve .

2-a Mirëmbajtja e ndriçimit publik

Për sanimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, për vitin 2004, mjetet kanë qenë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës, në shumë prej 200.000,00 €
Në bazë të kontratës nr. 01-7/04 të dt 27.05.2004, punët për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i janë besuar NPE “MONTEN” nga Prishtina, e cila deri më 31.12.2004 e ka realizuar tërësisht programin për vitin 2004.

Gjatë vitit 2003 kanë qenë të ndriçuara 39 rrugë (të riparuar), gjatë vitit 2004 kanë qenë të sanuara gjithsej 59 rrugë, ndërsa në 14 rrugë është kryer ndriçimi i ri publik. Për mirëmbajtje të ndriçimit publik, gjatë vitit 2004, kanë qenë gjithsej 112 rrugë .

Për ndërtimin e ndriçimit të ri publik, në ofertë të veçanta janë kontraktuar këto rrugë, mirëpo ne kemi punuar dhe jemi duke punuar edhe ndërtime të reja të ndriçimit publik dhe të kanalizimit kablovik, si projekte të përbashkëta me rrugët (shih tabelën e ndërtimit të rrugëve).

1. **Rr. “Ali Pashë Tepelena”, rr.“Gazmend Zajmi”, rr. “Rrahim Beqiri” dhe rr.“Xheladin Hana” nga “NP Monten” Prishtinë.**
 - Vlera e kontraktuar, vetëm për ndriçim publik, arrin shumën 88.550,00 €
 - Projekti është realizuar.
2. **Rr. “27 Nëntori “ nga ndërmarrja „Linda” Kaçanik.**
 - Vlera e kontraktuar e kanalizimit kablovik dhe e ndriçimit publik është 217,338,50 €
 - Projekti në realizim e sipër.
3. **Rr.”Haxhi Zeka” nga NPT “Termomontimi” Prishtinë**
 - Vlera e kontraktuar e kanalizimit kablovik dhe e ndriçimit publik është në shumë prej 134.104,50 €
 - Projekti në realizim e sipër.
4. **Rruga prej Shkollës Normale, deri në “Gërmi” nga nd.“El - Trafomont”.**
 - Do të bëhet ndërtimi i ndriçimit publik dhe sanimi i atij ekzistues.
 - Vlera e kontraktuar është 141.960,60 €
 - Punët janë në përfundim e sipër, projekt në realizim e sipër.

2-b Mirëmbajtja e semaforëve

Për mirëmbajtjen e semaforëve, mjetet në shumë prej 140.000,00 euro kanë qenë të siguruara. Në bazë të kontratës nr. 01-4/04, të dt. 31.03.2004 punët për mirëmbajtjen e semaforëve i janë besuar **DPZ “JAME”** nga Prishtina, që janë në realizim e sipër dhe do të zgjasin deri më 28.02.2004. Realizimi i mjeteve buxhetore deri më 31.12.2004 është në vlerë prej 114.005,25 €.

Për shpenzimin e energjisë elektrike për ndriçimi publik dhe për semaforë, deri më 30.11.2004 janë shpenzuar 155.058,86 € Përveç punëve të lartcekura, ky Drejtorat ka mbikëqyrë edhe punët rreth rikonstruktimit të rrjetit të tensionit të lartë ajror 10 KV dhe të tensionit të ulët 380/220 V në rr.”Muharrem Fejza”, në vlerën prej 7.444,40 €

Gjithashtu, gjatë vitit 2004 është realizuar projekti për vendosjen e invertorëve në 8 nyja semaforike, në shumë 24.355,00 € nga NTPSH “BOTA-TEKNIK” Prishtinë, me nr. të Marrëveshjes 02 – 18/04, të dt. 02.04.2004.

3. Shfrytëzimi i hapësirave publike 01.01.2004-31.12.2004.

Gjatë kësaj periudhe kanë arritur gjithsej 543 kërkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve, standave lëvizëse dhe panove reklamuese. Prej tyre 534 janë zgjidhur, ndërsa 9 janë në procedurë të zgjidhjes.

4. Gjatë vitit 2004, shërbimi i infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve ka realizuar 244 lëndë dhe 6 janë në procedurë të zgjidhjes, d.m.th. 250 lëndë.

RRUGËT E REALIZUAR NË VITIN 2004

nr	Rruga	Aktiviteti	Punëkryesi	Gjatësia	E Kontraktuar	Dinamika
1	Te Shkolla e Mesme Ekonomike	Kan. Atmos.Asfa Itim.Trotuar	Dina -Ing.	301	55.847,11	E Realizuar
2	"Dervish Shaqa"	Asfaltimi	Beni- Com	382	19.893,60	E Realizuar
3	As. I Shk. Ekon.	Asfaltimi	Dina -Ing.	20	3.427,60	E Realizuar
4.	"V. Hygo"	Asfaltimi	Burimi	206	9.584,10	E Realizuar
5.	"Ali. P. Gucia"	Asfaltimi	Burimi	208	9.828,01	E Realizuar
6.	"Vlora"-Rru. lidhëse	Asfaltimi II	Trasing	252	9706,15	E Realizuar
7.	"Ahmet Krasniqi"	Asfaltimi	Ekskavatori	1.870,37	195.546,51	E Realizuar
8.	Trot.në rr. "Ahmet Krasniqi"	Me pllaka të betonit	Dijar-Co	1.458.75	33.051,69	E Realizuar
9.	"Ernest Zariqi", "Viktor Hygo", "Ali Pashë Gucia", "Durrësi", "Tahir Meha", "Kalabri"	Zhavor Puna shtesë	Burimi	2.450 410	55.715,31 5.560,25	E Realizuar E Realizuar
10	Përroi I Njelmët Mehmet Beci "Ali P.Gucia"	Zhavor	Noti	2.025	33.715,12	E Realizuar
11	Kolovica e Vjetër	Zhavor	Kosnor-Enterprise	600	13.041,85	E Realizuar
12	"Kuvendi i Bujanit"	Asfalt-sanim	Trasing	560	15.497,00	E Realizuar
13	"Hamdi Gashi"	Asfaltim	Agro-Llapi	400	23.000,00	E Realizuar
14	"Enver Berisha"	Me pllaka të betonit	Kolgeci	360	27.527,75	E Realizuar
15	"Idriz Gjilani"	Kanal.atm. Asfaltim	Agro-Llapi	560	87.542,00	Në Realizim
16	Riparimi I gropave	Asfaltim	Unicom		168.586,98	E Realizuar
17	"Emin Duraku" dhe "Rrustem Hyseni"	Asfaltim	Eurogarden	150 165	58.599,64 5.544,01	E Realizuar
18	"Afrim Loxha"	Asf.Kanal. I kombinuar	Çlirimi	174.66	47.110,74	E Realizuar
19	"Gazmend Zami" "Ali A.Tepelena"	Asfaltim	Agro-Llapi	960	223.133,47	E Realizuar
20	"Ymer Lutfi Paçarizi"	Me kubza Rikonst.	Euro Garden	270	40.855,47	E Realizuar
21	"Adrian Krasniqi"	Asf.kanal.uj sjellës,k.ka bllovik,ndriçim publik	Plankos	280,87	186.053,65	E Realizuar
22	Mbulimi I përroit në Lagj.Spitalit	Kanalizim	Gashi-Ing	152	46.920,00	E Realizuar
23	Çamëria(H.Zeka)	Kanalizim	Proterm	177	8.786,50	E Realizuar
24	"Haxhi Zeka" Lot-I-	Kan.asfalt	Ekskavatori	1737,22	572.348,95	Në realizim
25	"Caraleva"	K.i komb.k. Kablllovik-asfaltim	Beni-Com	696	386.973,90	Në realizim
26	"Mentor Retkoceri"	K.atm.asfa. ndriç-kanal kablllovik	Gashi-Co	197	115.257,35	Në realizim
27	"Mic Sokoli"	Kan.asfalt	Koal-ing	209	132.950,04	Në realizim
28	"Ibrahim Fehmiu"	Zhavor	Kosnor	365	61.945,00	Në realizim

29	“Sylejman Vokshi” “2 Korriku”	Kanal.asfalt ujësjell- ndriçim pub	Alko-Impex	448,77	184.266,44	I realizuar
30	“Edmond Hoxha” “Shaip Kamberi” “Mustafë Kruja”	Betonim, sanim me Kubza	Protech	1476,0	Goll-75.000,00 K.K. -162.596,20	Në realizim
31	“Rrahim Beqiri”, “Xheladin Hana”	Asfaltim	Kastrioti	950	272.002,74	Në realizim
32	Sofali	Ujësllësi	GranitiCom		192.170,48	Në realizim
33	“27 Nëntori” Lot.I.	Kan.asfalt	Unicom	1.096,43	520.029,85	Në realizim
34	“Bedri Gjini”	Asfaltim	Eng-Pan Al	350	40.000,00	Në realizim
35	“Pashko Vasa” dhe “Sejdi Kryeziu”	Asfaltim	Euro-Gardën	505	132.956,70	Në realizim
36	“Mujo Ulqinaku” “Radovan Zogoviq” “Mbreti Zog”	Asfaltim	Eskavatori	525	106.820,16	Në realizim
37	“Llapi”-“Drenica”	Kan.asfalt	Gashi-Ing	725,10	98.457,54	Në realizim
38	“Ali Hadri”, “Zenel Salihu”	Asfaltim	Eng-Pan Al	752,00	96.420,83	Në realizim
39	Velani-“D.Marevcit”	Pastr.-Plan.	Dardania		4.720,00	E realizuar
40	“Vushtrria”	K.atm.asfal k.kabllovik- ndriçim-pub	Unicom	740	366.335,57	Në realizim
41	“M.Bajraktari”	Kubza	Euro-Gardën	270	54.517,50	Në realizim
42	“Lekë Dukagjini”	Asfalt	Agro-Llapi	120	9.935,20	E realizuar
43	Largimi I bores -12- 2003,Idhe II 2004		Zahiri		11.198,20	E realizuar
44	“Marevci”	Asfalt	Eng-Pan Al	333,24	87.885,72	Në realizim
45	Segmenti rrugor “Shkodra”- “N.Gafurri”- “H.Mosi”	Asfalt	Alko-Impex	450	65.329,00	Në realizim
46	Pastr. I Rrug- Trotuar	Mars-Prill	Zahiri		19.869,20	E realizuar
47	M. Kosova	Sanim- zhavor	Mala	550	9.861,25	E realizuar
48	Kan. Fekal Përroi i Zatriqit	Sanim	Hidroteknika	60	4.522,22	E realizuar
49	“E. Miftari”	Asfalt	Snab	250	16.836,34	E realizuar
50	Rrugë lidhëse me rr.”Isa Kastrati”	Asfalt	Çlirimi	60	3.456,00	E realizuar
51	Segm.Rr. “Çajupi”	Asfalt	Agro-Llapi	100	9.921,85	E realizuar
52	Përroi në lagje Spitalit dhe Vellushë	Pastrimi	Hidroteknika		36.248,00	E realizuar

Në vitin 2004 janë punuar – **asfaltuar 11.529,45 metra gjatësi të rrugëve.**

Gjatë vitit 2004 janë **duke u punuar (në realizim) me asfalt 8315,99 metra gjatësi të rrugëve.**

Në vitin 2004 janë **punuar –ndërtuar 2088 metra gjatësi me kubëza.**

Gjatë vitit 2004 janë **duke u punuar më betonim dhe sanim me kubëza 1746 metra gjatësi.**

Gjatë vitit 2004 janë **shtruar dhe sanuar rrugët me zhavor 6035 metra.**

Projektet e bartura nga viti 2003-2004 me zotim të mjeteve (kontrata e nënshkruar) në vitin 2003.

Rr.,Muharrem Fejza” – K.i kombinuar, ujësjellës dhe asfaltim. 229.916,20 €

Rruga te varrezat e reja të qytetit asfaltim, trotuar me kubze të betonit. 268.893,76 €.

SEKTORI I TRANSPORTIT DHE I MBROJTJES SË AMBIENTIT

1. Transporti publik i udhëtarëve:

a) Organizimi i trafikut

Janë kryer këto punë dhe detyra:

- është realizuar trafiku linjor i udhëtarëve, kryesisht sipas rregullores në fuqi,
- është bërë incizimi i të gjitha linjave të transportit publik urban dhe urban-periferik, ku është bërë matja e distancës dhe caktimi i stacioneve të autobusëve,
- është bërë shpallja e konkursit për transportin linjor të udhëtarëve duke përfshirë edhe përgatitjet për konkurs,
- është bërë shqyrtimi i dokumentacionit të aplikuesëve për ushtrimin e veprimtarisë së transportit publik të udhëtarëve,
- është bërë përpilimi i orarit për transportin publik,
- është realizuar transporti jashtëligjor (kryesisht auto-taksi) pa probleme të mëdha dhe konform rregullores ekzistuese.

b) Parkingjet

Nuk janë krijuar parkingje të reja por është bërë vetëm mirëmbajtja e tyre. Ekzistojnë rreth 1500 parkingje publike buzë rrugëve. Është i domosdoshëm menaxhimi i tyre, sidomos i parkingjeve buzë rrugëve dhe aplikimi i pagesës për shfrytëzim.

Në shiritin e ndarë për parkim janë dhënë në shfrytëzim disa vendparkime me pagesë, në vlerë prej **10970 €** kurse pa pagesë u janë dhënë disa institucioneve vendore dhe zyrave diplomatike.

c) Siguria në rrugë dhe përparimet në funksionimin e trafikut

Riparimi dhe rindërtimi i rrugëve të qytetit, gjithnjë e më tepër po ndikon në rritjen e sigurisë së komunikacionit në përgjithësi, Plotësimi i rrugëve me sinjalizim horizontal dhe vertikal, gjithashtu po ndikon në rritjen e sigurisë në komunikacion.

1. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal

a) Punët e realizuara në sinjalizim

Me sinjalizim horizontal dhe vertikal janë pajisur 74 rrugë të qytetit. Përparësi u është dhënë udhëkryqeve, rrugëve kryesore dhe atyre që gjenden në afërsi të shkollave etj.

Sinjalizimi horizontal:

- vijë e ndërprerë janë sinjalizuar 3684.5 m gjatësi,
- vijë e pandërprerë - 3523.5 m gjatësi,
- vendkalime të këmbësoreve 6208.3 m gjatësi,
- shigjeta njëshe dhe dyshe në udhëkryqe janë punuar 80 copë,
- vijë zig-zage në stacione të autobusëve 360 m gjatësi,
- katrorë 50x50 113 copë .

Sinjalizimi vertikal:

- panele trekëndëshe janë vendosur 77 copë,
- panele rrethore - // - 236 copë,
- panele katrore - // - 169 copë,
- tabela plotësuese - // - 66 copë,
- shtylla antiparking - // - 128 copë .

b) Punët e përealizuara në sinjalizim vertikal :

- rreshtimet nëpër udhëkryqe,
- shtrirjet e rrugëve me përparësi kalimi.

Gjatë vitit 2004 kemi pranuar gjithsej 195 lëndë për shqyrtim, të gjitha janë shqyrtuar.

Shërbimi i Ambientit

Shërbimi i mbrojtjes së ambientit, gjatë kësaj periudhe kohore ka organizuar punën dhe është përkujdesur për realizimin e detyrave, të cilat janë pjesë e përditshmërisë së këtij Shërbimi. Në vazhdimësi shërbimi ka **realizuar** disa projekte.

Zonat të cilat trajtohen sipas tenderit:

- **Zona I** përfshinë sipërfaqet e gjelbëruara të Tauk-Bahçes, me sipërfaqe prej 60.000 m².
- **Zona II** përfshinë Parkun e qytetit dhe “Përmendoren e Dëshmoreve”, me sipërfaqe prej 85.000 m².
- **Zona III** përfshinë sipërfaqet e gjelbëruara në Ulpianë, me sipërfaqe prej 65.000 m².
- **Zona IV** përfshinë lagjen “Dardania”, me sipërfaqe prej 60.000 m² dhe
- **Zona V** fillon nga rr.”Nazim Gafurri”, ” KK i Prishtinës”, sheshi “Adem Jashari”, rr. “Agim Ramadani”, rr. “Fehmi Lladrovci”, deri te rrethi pranë “Kosova - Petrolit”, pastaj Qendra e qytetit”, sheshi ”Nëna Terezë”,rr.”Luan Haradinaj”, rr.”Rexhep Luci”, vazhdon në rrugën “Tirana”, deri te rr.”Bil Clinton”, me sipërfaqe 101.436 m².

Sipërfaqja që trajtohet, gjithsej **371.436 m²**.

Nr	Projekti	Punëkryesi	Vlera
1.	Mbikëqyrja permanente e mirëmbajtjes së sipërfaqeve gjelbëruese në 5 (pesë) zonat e qytetit.	Labi	38. 939,00
2.	Projekti i gjelbërimit të Kisha Katolike.	Labi	15.829,75
3.	Projekti i rehabilitimit të Parkut të qytetit .	Hortikultura	21. 039,25
4.	Projekti i gjelbërimit të oazave prej depove të “Ramiz Sadiku”, deri te ndërtesa e OSBE-së.	Labi	6.200,57
5.	Projekti i gjelbërimit të oazave përgjatë rr. “Xheladin Rrekaliu” dhe rr.“Enver Maloku”, e deri te posta në Kodrën e Diellit (në realizim e sipër)	Labi	15.792,08
6.	Projekti “Ndërtimi i trotuareve” si dhe platosë te pllaka përkujtimore “Enver Maloku” (ne realizim e sipër)	Las Palmas	19.222,56
7.	Projekti i gjelbërimit të hapësirës në Kodrën Diellit, Blloku I (i parë) (në realizim e sipër)	Labi	18.833,10
8.	Projekti për heqjen e trungjeve të thara dhe mbjelljen e fidaneve të reja përgjatë rrugës “Nene Tereza” dhe “Bulevardi i Dëshmorëve”.	Hortikultura	2.862,35
9.	Projekti për sipërfaqen gjelbëruese në rrugën Mitrovicë-Prishtinë, dhe rrugës pranë Termokosit	Labi	24.244,44
		Gjithsejtë:	162.963,16

Këto projekte janë realizuar sipas planit vjetor për vitin 2004, por tri prej këtyre projekteve (4,5,7), për shkak të kushteve atmosferike janë ndërprerë, për të vazhduar në vitin 2005.

Gjatë vitit 2004, Shërbimi i ambientit ka shqyrtuar kërkesa të ndryshme, nga të cilat, gjatë punës në terren ka realizuar **40 lëndë**. Bashkëpunëtorët profesionalë të këtij shërbimi, gjatë realizimit të projekteve kanë bërë përcjelljen e realizimit të punëve në mënyrë permanente.

SEKTORI PËR TOKË NDËRTIMORE

Gjatë periudhës njëvjeçare i kemi pasur këto aktivitete:

I. Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtimin e këtyre rrugëve :

Rrugët: “Kuvendi i Bujanit”, “Ymeri Lutfi Paçarizi”, “Rexhep Shema”, “Rasim Kijina”, “Rrustem Hyseni”, “Emin Duraku”, “Xhelal Mitrovica”, “Ali Hadri”, “Zenel Salihu”, “Afrim Loxha”, “Idriz Gjilani”, “Shkodra”, “Mehmet Akif Ersoj”, “A – B” dhe “Hil Mosi”.

Përgatitja e dokumentacionit teknik të kërkesave të bashkësive lokale për rregullimin e infrastrukturës.

II. Përgatitja e të dhënave për detyrën projektuese për këto rrugë:

Rrugët: “Kuksi”, “Malush Kosova”, “Ibrahim Kelmendi”, “Niket Dardani”, “Agron Rrahmani”, “Rasim Kijina”, “Rexhep Shema”, “Sheshi i Arbrit”, “Dëshmorët ë Marevcit”, “Muharrem Fejza” (vazhdim), “Pal Palucaj”, “Sali Nivica”, “Maliq Pashë Gjinolli”, “Mbreti Bardhyl”, “Zenel Bajraktari”, “Aleksandër Mojsiu” dhe “Rahman Murati”.

III. Përgatitja e të dhënave për vërtetimin e pronësisë dhe shënimet e kërkuara nga ana e avokatit publik.

DREJTORATI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS

Objektivat kryesore të punës së Drejtoratit të Arsim dhe të Shkencës gjatë vitit 2004 :

- angazhimi për realizimin e projekteve të ndryshme të ndërtimit, rindërtimit dhe meremetimit të objekteve të ndryshme shkollore të komunës së Prishtinës,
- përgatitjet dhe sigurimi i kushteve sa më të mira për zbatimin e reformës në arsimin e Kosovës, sidomos me fillimin e klasës I, II, VI, VII, X dhe XI,
- mbikëqyrja e gjithë sistemit arsimor komunal, që përbëhet nga institucionet parashkollore, shkollat fillore, shkollat e mesme dhe shk. speciale,
- sigurimi dhe plotësimin i kuadrit mësimor dhe mbështetës për vitin shkollor 2003/2004, në bazë të nevojave dhe të kërkesave nga drejtoritë e institucioneve arsimore,
- mbështetja për trajnimin e kuadrit udhëheqës dhe atij arsimor të institucioneve arsimore nga MASHT-i,
- realizimi i aksionit tradicional “Garat e diturisë” në nivel komunal,
- mbështetja dhe realizimi i “Garave të recitatorëve” në nivel komunal,
- organizimi dhe mbajtja e manifestimit “Maturiada e Prishtinës 2004”,
- mbështetja dhe bashkëpunimi me të gjitha OQ-të dhe OJQ-të për realizimin e projekteve të tyre trajnuese nëpër shkolla,
- sigurimi i lëndëve djegëse, me anë të tenderëve të shpallur për drurë, qymyr dhe naftë, për nxehjen e objekteve shkollore gjatë sezonit dimëror,
- punë të tjera të zakonshme të këtij Drejtorati.

Realizimi i këtyre objektivave është bërë nga tri shërbime të veçanta, që veprojnë në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, dhe nga stafi menaxhues i Drejtoratit.

Shërbimi i punëve të përgjithshme menaxhuese, në të cilin janë angazhuar: drejtori, asistentja administrative, bashkëpunëtorja për analizë dhe plan zhvillimor të arsimit, bashkëpunëtorja për minoritetin boshnjak dhe bashkëpunëtorja për minoritetin turk.

Në Sektorin e arsimit parashkollor dhe fillor janë të angazhuar: shefi i Sektorit të arsimit parashkollor dhe fillor, një zyrtar i arsimit parashkollor dhe parafillor dhe tre zyrtarë të arsimit fillor.

Në Sektorin e arsimit të mesëm janë të angazhuar: shefi i Sektorit të mesëm, katër zyrtarë të arsimit të mesëm të ulët dhe tre zyrtarë të arsimit të mesëm të lartë.

Në Shërbimin e përgjithshëm administrativ janë të angazhuar: një zyrtar i lartë i administratës, një zyrtar për paga të punëtorëve të institucionet edukativo-arsimore (shkolla) dhe një kompjuteriste.

Në Shërbimin financiar për mallra dhe shërbime janë të angazhuar: një zyrtar i lartë financiar dhe një asistente për çështje financiare.

Në Shërbimin për mirëmbajtjen e objekteve shkollore janë të angazhuar: një zyrtar për logjistikë dhe furnizim me mjete mësimore dhe të punës dhe dy zyrtarë për mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe sigurimin e pasurisë.

Ndërtimet dhe meremetimet

Gjatë vitit 2004, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës është angazhuar që t'i përmbushë objektivat, të cilat i ka përcaktuar me prioritet në planin operacional. Përveç punëve rutinore të Drejtoratit, janë realizuar dhe proceduar edhe këto kërkesa emergjente:

- ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Ballaban - 80.000€ MLIF3, 40.000 €DKA,
- ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Hajkobillë - 115.000 €DKA,
- ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Mat - 249.000€MASHT,
- ndërtimi i objektit të ri i shkollës fillore "Xhemajl Mustafa" në lagjen "Dardania", donator ishte Banka e Bashkuar Islamike, me shumën prej 1.100.000 Eurosh. Inaugurimi është bërë në fillim të vitit të ri shkollor 2004/2005.
- vënia e gurthemelit të shkollës fillore në lagjen "Kodra e Trimave", në qershor të v. 2004 dhe vazhdimi i ndërtimit të saj. Investitues është MASHT-i,
- furnizimi i shkollave me lëndë djegëse (naftë, dru dhe thëngjill), për shkollat e mesme dhe fillore,
- ngjyrosja e disa objekteve shkollore -13.000€DKA,
- furnizimi dhe vendosja e fasadës në muret e brendshme të korridoreve në shkollën fillore "Ismail Qemail",
- ndërtimi dhe renovimi i kulmeve në disa shkolla - 68.000€DKA,
- ndërtimi i depove për lëndë djegëse në disa shkolla në pjesën rurale. Në 21 shkolla, në pjesën rurale, është bërë intervenimi, si dhe ndërtimi i disa gropave skeptike, 72.000 € DKA.
- renovimi i nyjave sanitare dhe ndërtimi i disa anekseve në shkollat e fshatrave dhe të qytetit. Në 13 shkolla janë kryer punët e parapara - 103.000 €DKA,
- ndërtimi i dritareve të disa objekteve shkollore dhe dyerve të nyjave sanitare - 185.000 € DKA,
- renovimi i ngrohjes qendrore në 6 objekte shkollore, të shkollave fillore dhe të mesme - 88.000 €DKA,
- ndërtimi i rrethojës së shkollës fillore "Xhemajl Mustafa",

- furnizimi i çerdheve me artikuj ushqimorë, në bazë të tenderit të shpallur më 02 maj 2003, që është në fazën e përmbartimit, apo të realizimit.
- tenderi për furnizimin e shkollave me inventar shkollor,
- tenderi për ndërtimin e depove për lëndë djegëse nëpër fshatra,
- renovime urgjente në bazë të kërkesave të shkollave dhe të çerdheve,
- eliminimi i defekteve të ndryshme në kanalizime, si dhe renovime të tjera të domosdoshme.

- shqyrtimi i kërkesave për kushtet urbanistike, si dhe për përgatitjet e projekteve për ndërtimin e objekteve të reja shkollore në këto lokacione.

Bartës të këtyre projekteve janë Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, së bashku me Drejtoratin e Planifikim, të Urbanizimit dhe të Ndërtimitarisë dhe Zyrën e prokurimit.

- është bërë kërkesa për gjetjen e lokacioneve për ndërtimin e objekteve të reja shkollore në këto lagje të Prishtinës:

- në Lagjen e Spitalit,
- në lagjen “Arbëria”,
- në lagjen “Hajvala e Re”,
- në lagjen “Sofalia”.

- është bërë pranimi dhe dorëzimi i formularëve të ndryshëm në listat e pagave të arsimtarëve.

Pranimi dhe dorëzimi i listave të pagave është bërë për 12 muaj.

Janë bërë takime pune me përfaqësuesit e komunitetit serb të Graçanicës, bashkë me UNMIK-un, lidhur me reduktimin e punëtorëve si tepricë ekonomike.

I kemi sistemuar edhe nevojat të tjera për pajisjen e shkollave me kompjuterë.

Shuma e paraparë nga buxheti komunal nuk do të mjaftojë për realizimin e të gjitha këtyre kërkesave nga shkollat.

Edhe për këtë periudhë kohore është siguruar transporti i nxënësve të klasës IX dhe i arsimtarëve.

Zbatimi i reformës arsimore me klasën I, II, VI, VII, X dhe XI

Meqenëse në këtë vit shkollor është filluar edhe më klasat I, II, VI, VII, X dhe XI, në kuadër të Drejtoratit është vazhduar edhe më tej me punët për realizimin e reformës në arsim, duke i mbështetur dhe përkrahur nismat për reformat edhe në fushën e arsimit nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të arsimtarëve të gjitha niveleve të arsimit. Në trajnime kanë marrë pjesë gjithnjë edhe një numër i zyrtarëve të arsimit të gjitha niveleve.

Për sigurimin e kushteve sa më të mira për klasën I, II, VI, VII, X dhe XI, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, në bashkëpunim me MASHT-in, është angazhuar edhe për furnizimin e këtyre shkollave me inventar dhe mjete mësimore të konkretizimit, për pasurimin e kabineteve.

Në bashkëpunim me MASHT-in janë siguruar me kohë planprogramet mësimore për klasën e dytë (II) dhe për klasën e shtatë (VII).

Mbikëqyrja e tërë sistemit arsimor komunal

Gjatë vitit kalendarik 2004 është bërë mbikëqyrja e zhvillimit të tërë sistemit arsimor komunal, në të gjitha nivelet, duke filluar nga drejtori me personelin e vet, Shërbimi për punë të përgjithshme administrative dhe Shërbimi i zyrtarëve arsimorë.

Sistemin arsimor të Komunës së Prishtinës e përbëjnë:

- institucionet parashkollore, të cilat janë të organizuara në pesë drejtori, me njëmbëdhjetë objekte, duke përfshirë këtu edhe kuzhinën qendrore, me 2026 fëmijë dhe 269 punëtorë administrativë dhe edukativë,

- niveli I i arsimit në komunën e Prishtinës, i cili është i organizuar në 40 shkolla të pavarura, ku përfshinë edhe 23 paralele të ndara në vendet rurale, me 17.719 nxënës,
- niveli II i arsimit në komunën e Prishtinës, icili është organizuar në 40 shkolla të pavarura, ku janë të përfshira edhe 9 paralele të ndara në vendet rurale, me 16.027 nxënës,
Në nivelin I dhe II të arsimit në komunën e Prishtinës janë të angazhuar 2067 punëtorë edukativo-arsimor dhe edukativë.

- niveli III i arsimit në komunës së Prishtinës është i organizuar në 19 shkolla të mesme, me 11.712 nxënës dhe me rreth 1000 punëtorë arsimorë dhe administrativë, në shkolla speciale 87 nxënës dhe 12 punëtorë arsimorë dhe administrativë.

Në kuadër të këtij sistemi arsimor është siguruar shkollimi fillor dhe i mesëm për minoritetin turk dhe boshnjak.

Gjatë vitit 2004 janë mbajtur 14 mbledhje me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, në të cilat janë trajtuar çështje të ndryshme për mbarëvajtjen menaxhuese të punës edukativo-arsimore, në të gjitha nivelet e punës edukativo-arsimore, dhe janë dhënë udhëzime të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe obligimeve konkrete, në harmoni me trendin zhvillimor të arsimit në komunës së Prishtinës.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2004, nga drejtori i Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës dhe shefat e sektorëve janë bërë rreth 87 vizita me karakter pune në të gjitha institucionet shkollore të komunës së Prishtinës, të nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Shërbimi i zyrtarëve arsimor

Zyrtarët e arsimit të Komunës së Prishtinës, gjatë vitit 2004 kanë bërë vizita të rregullta, speciale dhe kontrolluese në tri drejtoritë e institucionit parashkollor (tri drejtoritë edukativo – arsimore, që numërohen gjatë këtij viti), në 37 shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe, bashkë me 23 paralele të ndara të tyre, në një shkollë speciale, si edhe në 13 shkolla të mesme.

Vizitat kanë qenë të fokusuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke kontrolluar në tërësi punën edukativo-arsimore me nxënës, vlerësimin e tyre, vijimin e mësimin, masat edukative, procedurën e pranimit të kuadrit mësimor, disiplinën në punë, realizimin e planit dhe programit mësimor etj.. Kujdes i veçantë i është kushtuar aplikimit të klasave I, II, VI, VII, X dhe XI dhe mënyrës së organizimit të procesit mësimor me këto klasa.

Përveç 132 vizitave të rregullta, zyrtarët arsimorë kanë bërë edhe 27 kontrollime speciale, 23 vizita kontrolluese dhe 54 kontrollime në bazë të ankesave të nxënësve, arsimtarëve, punëtorëve dhe të tjerëve.

Pos punëve të tjera, zyrtarët arsimorë janë angazhuar edhe në punët me palë, duke dhënë udhëzime për realizimin e kërkesave të tyre.

Gjatë vitit 2004 janë bërë edhe 17 vizita informative në shkollat fillore, 12 vizita informative në shkollat e mesme dhe tri vizita informative në katër drejtoritë e institucionit parashkollor. Në këtë periudhë, nga zyrtarët arsimorë, janë përcjellë punëtoritë dhe seminarët e organizuara nga MASHT-i dhe nga organizatat të tjera qeveritare dhe joqeveritare, për aftësimin e kuadrit dhe për realizimin e reformës shkollore.

Gjatë këtij gjashtëmujori janë kryer edhe punë të tjera, me kërkesë të drejtorit të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të institucioneve tjera arsimore.

Shërbimi i përgjithshëm administrativ

Gjatë vitit 2004, Shërbimi i përgjithshëm administrativ ka kryer këto detyra dhe shërbime:

- ka bërë shpërndarjen e listave të pagave për të gjitha institucionet edukativo-arsimore: parashkollore, fillore dhe të mesme,
- ka bërë pranimin, plotësimin dhe shpërndarjen e formularëve të ndryshëm për pagat e arsimtarëve dhe të punëtorëve të tjerë arsimorë,
- ka bërë pranimin e faturave të ndryshme për shpenzime materiale dhe pagesa të tyre,

- ka bërë takime pune me zyrtarët e UNMIK-ut lidhur me nevojat e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse, për sezonin dimëror.
- ka bërë përpilimin e planit financiar afatmesëm për vitin shkollor 2003/2005, për të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës, shpërndarjen dhe pranimin e aplikacioneve për vendet e lira të punës, në bazë të kërkesave nga Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës,
- ka bërë përpilimin e shkresave të ndryshme,
- ka bërë shtypjen e materialeve të ndryshme,
- ka kryer punët me palë, etj. .

Në bashkëpunim me MASHT-in është përcjellë puna edukativo-arsimore në shkollën speciale “Përparimi”, për fëmijë me aftësi të kufizuara.

Shërbimi financiar për mallra dhe shërbime

Nga ky shërbim u kryen këto punë dhe detyra:

- është përpiluar raporti financiar për të gjitha nivelet e institucioneve shkollore dhe parashkollore të komunës së Prishtinës dhe i njëjti raport i është ofruar të gjitha drejtorive të shkollave,

- është menaxhuar me buxhetin e Arsimit të Prishtinës.
- janë mbajtur shënime dhe janë përcjellë të gjitha faturat për shpenzimet (përveç atyre kapitale) e mjeteve financiare për të gjitha shkollat dhe për institucionin parashkollor,
- janë mbajtur shënime për të hyrat vetanake të shkollave dhe të institucionit parashkollor.

- është bërë zotimi i mjeteve financiare dhe është nxjerrë gjendja e buxhetit të Arsimit. Organet kompetente komunale dhe të MEF-it, me kohë janë njoftuar me shkrim për problemet me të cilat po ballafaqohet Arsimi i Prishtinës. Me organet e lartshënuara janë mbajtur takime, me qëllim të zgjidhjes së këtyre vështirësive.

- është përpiluar propozimplani për buxhetin e Arsimit për vitin 2005,
- është përcjellë buxheti për paga të punëtorëve të Arsimit,
- janë marrë masa për largimin nga lista e pagave për të gjithë punëtorët e Arsimit (punëtorët e Arsimit të minoritetit serb), të cilët kanë realizuar të ardhura në kundërshtim me ligjin,
- është sistemuar i tërë dokumentacioni i nevojshëm, dhe i njëjti është evidencuar edhe në kompjuter,
- janë përpiluar dhe janë plotësuar tabelat për analizën mujore të shpenzimeve,
- është organizuar transporti për arsimtarë dhe nxënës të klasave të nënta, nga qendrat lokal në Prishtinë dhe anasjelltas,
- është bashkëpunuar me kontrollin financiar të MEF-in,
- kemi marrë pjesë në kontrollin financiar në disa shkolla dhe në institucione parashkollore.
- është proceduar për tenderim në Zyrën e prokurimit, për furnizimin e shkollave me material higjienik, material për ujë, material elektrik, material didaktik, rekuizita sportive etj. .

Mënyrën e inkasimit të mjeteve vetanake të institucionit parashkollor dhe të shkollave që realizojnë mjete nga qiraja, janë nën mbikëqyrje financiare të Sektorit të shërbimit financiar.

- janë vizituar dhe është biseduar me njerëzit kompetent të ndërmarrjeve, të cilët i kryejnë shërbimet komunale, me qëllim që, eventualisht, një pjesë e borxheve të vjetra të shlyhen, ose që pagesa e tyre të bëhet me këste,

- janë kryer edhe shumë punë të tjera, për çka vlen të theksohet se bashkëpunimi me organet kompetente financiare të Komunës dhe me ato të MEF-it është në nivel.

Sigurimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës

Në bashkëpunim me MASHT-in dhe me drejtoritë e shkollave, pos me konkurse të rregullta, kuadrin edukativo-mësimor dhe mbështetës, për të gjitha nivelet e arsimit në komunën e Prishtinës, e kemi siguruar edhe përmes pranimit me zëvendësime.

Problemet me të cilat është ballafaquar ky Sektor ishin: mungesa e kuadrit të kualifikuar në shkollat fillore për lëndët mësimore: gjuhë angleze dhe kulturë muzikore, si edhe mungesa e kuadrit arsimor për shkollat e mesme për lëndën e matematikës dhe për lëndët profesionale, si inxhinierë të profileve të ndryshme, etj.

Gjendja më e vështirë me kuadër të kualifikuar është në shkollat e fshatrave, sidomos të atyre të largëta në Malësinë e Gollakut, ku është dashur të angazhohjmë personel të vendit, me përgatitje profesionale të pakualifikuar.

Tani, kur kemi siguruar transportimin e nxënësve nga pothuajse të gjitha vendbanimet rurale, është krijuar mundësia për transportimin e arsimtarëve nga Prishtina në shkollat në pjesën rurale, me çka shpresojmë se do të përmirësohet struktura kualifikuese e kuadrit arsimor.

Probleme të veçanta na paraqiten me rastin e zëvendësimit të punëtorëve, që shkojnë në pushim mjekësor të shkurtër, p.sh. për një ose dy javë, ngase punëtorët e pranuar arsimorë nuk tregojnë interesim për t'u angazhuar për kohë të shkurtër. Një gjë e tillë krijon vështirësi edhe për futjen e punëtorëve të tillë në sistemin e pagesave. Këto janë reflektuar drejtpërdrejt në çrregullimin e procesit normal edukativo-arsimor.

Mbështetja e trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor

Gjatë vitit 2004, kujdes të veçantë i është kushtuar edhe trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor, i cili është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, në frymën e reformave arsimore që po bëhen në Kosovë. Në periudhën prill-maj-qershor, por edhe gjatë sezonit veror, duke vazhduar deri në fund të vitit, janë mbajtur seminare për trajnim të arsimtarëve dhe të stafit udhëheqës të shkollave, të udhëhequra nga MASHT-i, e të mbështetura nga Drejtorati i Arsimit, në realizim të KEDP-së dhe të KEC-it.

Seminare për trajnimin e arsimtarëve ka organizuar edhe Shoqata finlandeze për punë me fëmijë me nevojë të veçanta.

Realizimi i “Garave të recitatorëve” dhe “Garave të diturisë” në nivel komunal dhe “Maturiada e Prishtinës – 2004”

Në kuadër të planit të punës që ka bërë Drejtorati, janë realizuar edhe këto aktivitete:

- garat e recitatorëve,
- garat e diturisë (në tetë lëndë mësimore) në 35 shkollave fillore,
- zgjedhja e nxënësit, paraleles, mësuesit, arsimtarit, profesorit dhe e edukatores më të mirë të të gjitha niveleve edukativo-arsimore komunale,
- garat e recitatorëve janë mbajtur më 05.06.2004, kurse garat e diturisë janë mbajtur më 07 mars – “Ditën e Mësuesit”,
- manifestimi “ Maturiada e Prishtinës 2004” është mbajtur më 25 qershor 2004,

Shpallja e rezultateve, ndarja e diplomave, e mirënjohjeve dhe e dhuratave modeste është bërë më 11 qershor, me rastin Ditës së Prishtinës.

Gjatë muajve maj-qershor 2004, nga Drejtorati është bërë organizimi dhe realizimi i ekskursionit me maurantët e shkollave të mesme në Shqipëri, si dhe organizimi i ekskursioneve të shkollave fillore dhe të mesme nëpër Kosovë.

Përveç kësaj, Drejtorati ka mbështetur bashkëpunimin në mes të disa shkollave fillore dhe të mesme, të binjakëzuar me shkollat simotra të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera evropiane.

Bashkëpunim me OQ-të dhe OJQ-të për realizimin e projekteve të tyre nëpër shkolla

Drejtorati ka bashkëpunuar me organizatat qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e projekteve të ndryshme për parandalimin e dukurive negative të nxënësve, si me Departamentin e të Drejtave të Njeriut, me Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës, me Sektorin për të drejtat e fëmijëve, me klubin për të drejtat e njeriut “Fëmijët për të Drejtat e Tyre”, me Teatrin e të Rinjve të Prishtinës, me Qendrën e Pionierëve etj..

Sigurimi i lëndëve djegëse për sezonin e dimrit

Janë përgatitur kërkesat për shpalljen e tenderëve për lëndë djegëse, njëri prej të cilëve është shpallur (për naftë), kurse për dru dhe thëngjill, pritet të shpallen në të ardhmen.

Organizimi, përvoja dhe perspektiva

Është bërë organizimi i brendshëm profesional dhe kadrovik në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës.

Pas miratimit të Ligjit mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë më të qartësuara, ndonëse ka vend për koment lidhur me atë se çka është ekskluzivisht kompetencë dhe përgjegjësi e Komunes, e çka e MASHT-it. Disa çështje, që nuk janë përkufizuar krejtësisht me ligj, rregullohen me udhëzime administrative nga MASHT-i.

Kompetencat dhe përgjegjësitë lidhur me menaxhimin financiar dhe kadrovik të personelit administrativ dhe ndihmës, janë transferuar nga MASHT- i në Komunë, nga janari i vitit 2002, ndërsa për menaxhimin e personelit arsimor, nga janari i v. 2003.

Duhet theksuar, veçanërisht parregullsitë e trashëguara nga ish-DASH-i në sistemin e pagesave të punëtorëve administrativë dhe arsimorë, në gati të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës .

Problem në vete ishte edhe mungesa e rregulloreve, të cilat do të kishin përkufizuar të drejtat, detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe të nxënësve në institucionet arsimore, e sidomos rregullorja mbi disiplinën dhe masat disiplinore ndaj punëtorëve arsimorë, administrativë, si dhe rregullorja për masat disiplinore ndaj nxënësve. Shumë prej këtyre rregulloreve janë përpiluar dhe janë vënë në zbatim.

Kërkohej, që në të ardhmen, të shtohet angazhimi dhe efikasiteti në procesin e prokurimit për çështje të ngutshme të intervenimeve në sanimin e avarive të ndryshme të sistemit të ngrohjes, të sanitarisë, të kanalizimit etj. .

Një problem që po manifestohet në praktikë është mospërkufizimi institucional i përgjegjësive të drejtorëve të shkollave, meqë sipas Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga MASHT-i, kurse pagat merren nga Komuna, së bashku me të gjithë punëtorët tjerë arsimorë, kështuqë ka neglizhim në kryerjen e detyrave dhe obligimeve, të përcaktuara me ligj. Prandaj, është me interes që të përcaktohet me mirë me amendamente ligjore statusi i drejtorëve të shkollave.

DREJTORATI I EKONOMISË

Drejtorati i Ekonomisë punën e ka filluar duke u bazuar në strategjinë e saj të përgatitur për të kompletuar infrastrukturën rregullative, në mënyrë që projektet të kenë sukses.

Strategjia e punës ka të bëjë me arritjen e sukseseve, si punë ekipore, duke mos anashkaluar edhe ngritjen e nivelit profesional të të punësuarve në këtë Drejtorat.

Bashkëpunimi me drejtoratet tjera ka qenë i kënaqshëm, duke lënë hapësirë që ky bashkëpunim, në të ardhmen të jetë më komplementar, me qëllim të rritjes së efektshmërisë si qeveri komunale.

Në këtë vit është nxjerrë Rregullorja, e plotësuar, mbi tarifa dhe ngarkesa komunale, duke kaluar në fazën e diskutimit publik dhe duke krijuar lehtësira shtesë për komunitetin e biznesit.

Drejtorati ka përpiluar Rregulloren për krijimin e lehtësirave për investimet e jashtme si dhe ndërrmarjet fillestare vendore dhe e njëjta është aprovuar në Kuvend, duke bërë një promovim të fuqishëm për mundësitë që u ofron Komuna bizneseve fillestare si dhe investuesve potencialë të jashtëm, duke u bërë komuna e parë që aprovon një Rregullore të tillë.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë përpjekje të vazhdueshme që të rritet numri i aplikuesëve për leje pune. Njëherit kemi punuar rreth përfilljes së rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

Në aspektin e përmbushjes së objektivave financiare, në të gjitha këto projekte për vitin fiskal 2004 janë inkasuar 407.153,53 € Për moskryerje të suksesshme të këtij projekti në tërësi, kanë ndikuar ngjarjet e marsit, ku për shkak të pasigurisë dhe rënies drastike të kërkesës, komuniteti i biznesit ka heziturar në kryerjen e këtyre obligimeve.

Kjo efektshmëri është përmirësuar në bashkëpunim me drejtoraret tjera, si me atë të Inspeksionit, të Shërbimeve Publike si dhe me Zyrën e prokurimit.

Në lëmin e transportit rrugor janë bërë përmirësime kualitative në aspektin e gjetjes së modaliteteve për dhënien e lejeve të punës për auto-taxi, ku tani kemi një kualitet të ri duke eliminuar çdo mundësi keqpërdorimi dhe duke aplikuar ID-të e sofistikuara si dhe numrat identifikues për çdo përfitues.

Edhe konkursi për transportin linjor është bërë me qëllim që të eliminohen dukuritë negative në këtë segment. Në bashkëpunim me Bordin e drejtorëve është përcaktuar edhe Komisioni i veçanët profesional për përfituesit e këtyre lejeve, në përputhshmëri me Rregulloren. Projekti ka të bëjë me futjen e autobusëve në linjat e mundshme, si dhe reduktimin gradual të kombibusëve në trafikun e qytetit, duke iu ofruar qytetarëve shërbime më cilësore në lëmin e transportit.

Bashkëpunimi me ministrinë ka qenë në nivel të duhur. Me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë janë mbajtur takime konsultative lidhur me Ligjin për NMV-të.

Është mbajtur takim edhe me Bordin e AGEF – DAVIDAK-së gjermane, si dhe një takim me komunitetin e biznesit, ku përveç të arriturave, është bërë një bashkëbisedim me të pranishmit, me ç'rast, ne, si përfaqësues të Komunës, jemi përgjigjur në pyetjet e parashtruara.

Në bashkëpunim me institutin "Riinvest" janë mbajtur disa "work-shope" (takime pune) lidhur me projektin "Delta II", me grupin punues të përbërë nga katër Drejtorate: të Ekonomisë, të Financave, të Planifikimit dhe të Urbanizimit, si dhe Drejtoratin e Bujqësisë, në mënyrë që ky grup, në të ardhmen, të punojë në metodologjitë e bërjes së planeve zhvillimore strategjike, si dhe atyre operacionale.

Drejtorati ka marrë pjesë në përpilimin dhe në debatet publike gjatë prezantimit të Planit strategjik Prishtina 2004-2020+ lidhur me strategjinë zhvillimore, ku së bashku me Drejtoratin e Planifikimit dhe të Urbanizimit, kanë bërë një paraqitje të shkëlqyeshme para auditoriumit.

Prezantim tjetër i përbashkët është mbajtur edhe në Konferencën ndërkombëtare, të organizuar nga institutet për hulumtime dhe zhvillim, me temën „Ndërrmarja moderne: menaxhimi, inxhinieringu, teknologjia informative e "Day"; Gratë në biznes dhe teknologji".

Një prezantim tjetër i përbashkët me Drejtoratin e Planifikimit dhe të Urbanizimit është bërë në Konferencën Ndërkombëtare për Investimet e Huaja, e organizuar nga Oda Ekonomike amerikane dhe USAID-i në Prishtinë, ku është bërë një promovim i shkëlqyer.

Drejtorati do të punojë edhe në projekte tjera strategjike në nivel të Kosovës, siç është edhe përpilimi i planit strategjik të zhvillimit afatmesëm në nivel të Kosovës.

Gjatë vitit raportues kemi realizuar projektin e parë investiv për komunitetin e biznesit, ku Komuna, respektivisht Drejtorati për Ekonomi, në bashkëpunim me KFORI-në finlandez dhe Ministrinë e Jashtme të Finlandës, me këtë projekt të përbashkët janë investuar 30.000,00 € në kompanitë dhe individët që merren me prodhimtari në arealin e komunës tonë. E veçanta e këtij projekti domethënës është pjesëmarrja e komuniteteve në të, si dhe përfitimet e realizuara nga ky projekt si pjesë e përmbushjes së standardeve që kanë komunat.

Përfaqësuesi i Drejtorarit tonë, si profesionist, merr pjesë në Grupin konsultativ qeveritar (në kuadër të MTI-së) lidhur me shumë projekte zhvillimore.

Bashkëpunimi i tillë, në vitin vijues, do të thellohet edhe me ministrinë tjera, Odën Ekonomike, agjencitë e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që merren me projeksione dhe strategji zhvillimore, në mënyrë që kryeqendra e Kosovës, Prishtina, të bëhet një qendër e respektuar në aspektin zhvillimor dhe me një perspektivë të qartë për të ardhmen.

Drejtori i Drejtoratit, në cilësinë e anëtarit të jurisë profesionale, të emëruar nga ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, ka marrë pjesë në përzgjedhjen e 10 (dhjetë) kompanive më të suksesshme, si dhe të asaj më të mirë në Kosovë për vitin 2004.

Drejtorati ka kryer edhe punë të tjera në kuadër të të drejtave dhe kompetencave legjitime.

DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Drejtorati i Inspeksionit i Komunës së Prishtinës, kryesisht merret me punët e kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës në këta lëmenj:

- të tregtisë,
- të ndërtimtarisë,
- të bujqësisë dhe veterinarisë,
- të sanitarisë,
- të veprimtarive komunale dhe të komunikacionit, si dhe një varg punësh të tjera konform Statutit dhe rregulloreve të Komunës.

Për kryerjen e këtyre veprimtarive, si dhe të punëve të tjera në kuadër të kompetencave të këtij Drejtorati, ekziston mënyra e organizimit nëpër sektorët përkatës:

- Sektori i inspektoratit të tregut,
- Sektori i inspektoratit të ndërtimit,
- Sektori i inspektoratit të bujqësisë, pylltarisë dhe të mbrojtjes së ambientit,
- Sektori i inspektoratit të bujqësisë dhe veterinar,
- Sektori i inspektoratit komunal dhe i komunikacionit.

Punët e të gjithë këtyre sektorëve në kuadër të Drejtoratit të Inspeksionit, janë bazuar dhe koordinuar në bazë të planprogramit për vitin fiskal 2004, gjegjësisht për periudhën raportuese, janar- dhjetor 2004, si dhe të punëve tjera të paraqitura kohë pas kohe në bazë të urdhëresave nga organet kompetente komunale, kërkesave të qytetarëve, organizatave komunale shërbyese, të policisë e të tjera.

Në kuadër të Drejtoratit, për punë të inspektimit, për periudhën raportuese, kanë qenë të angazhuar gjithsej 64 punëtorë.

Në vazhdim do të jepet një përshkrim i detajizuar i specifikave dhe detyrave për çdo sektor, veç e veç, bazuar në planprogramet e punës për vitin fiskal 2004, ku në mënyrë tabelare ky aktivitet shihet kështu:

Punët e kryera	Spektori i Inspeks. të Tregut	Spektori i Inspeksionit Sanitar-Vet.	Spektori i Inspek.Komunal Komunikacionit	Spektori i Inspek. Ndërtimit	Spektori Bujq. Mbroj.	Gjithësejt
Kontrollime	9.686	3.577	17.457	2.618	1.335	34.676
Procesverbale	4.620	1.421	8.953	757	1.049	16.800
Aktvendime	199	456	649	204	176	1.684
Fletëparaqitje	317	228	1.775	/	38	2.369
a)Gjykatës për Kundërvajtje	313	228	1.773	/	24	2.338
b).Gjykatës Ekonomike	02	/	02	/	07	11
Lëndë të vendosura	71	/	826	/	24	921
Lëndë të refuzuara	09	/	/	/	/	09
Lëndë në proced.gjyqësor	242	/	997	/	07	1.246
Vlera e denim.nga Gjyk.për Kundër.	8.370 .€	10.500.€	53.007 .€	120.066.€	/	191.943. €
Pëlqime për kushte minimale teknike	Komisioni i përbashkët me sektorin e tregut, sanitar, komunal			/	/	1.713.lënd
Mjetet e inkasuara nga pëlqimet tekniko –sanitare	Komisioni i përbashkët			/	/	141,159.€
Mjetet të pa inkasuara nga pëlqimet tekniko –sanitare	Për lëndët që nuk i kanë marrë palët			/	/	28.706,€
Gjithësej mjete të paralogaritura nga pëlqimet sanitare	Komisioni i përbashkët.			/	/	169.865. €
Largime të garazheve pa leje	/	/	/	49	/	49
Largim të qoshqeve pa leje	/	/	42	/	/	42
Largim kiosqesh pa leje	/	/	42	/	/	42
Largim reklamash pa leje	/	/	360	/	/	360
Largim të pengesave tjera	/	/	37	/	/	37
Kontrollime teknike të automjeteve	/	/	639	/	/	639
Rekomandime sanitare	/	1683	/	/	/	1.683

Mostra të ushqimit		177				177
Mostra të ujit	/	372	/	/	/	372
Mallra të asgjësuar dhe të konfiskuara	6.063.€	644.410.€	/	/	26.860.€	677.333 .€
Urdhërndalesa	837	/	/	/	/	837
Mbyllje te objekteve afarist	03	/	/	/	/	03
Ankesa te qytetarëve	13	/	/	/	/	13
Largime të shitësve ambulatorë nga rruga	1.870	/	/	/	/	1.870
Mostrat e kripës		58				58
Strisha nga sipërfaqet e punuës		253				253

I. Sektori i inspektoratit të tregut

Në kuadër të këtij Sektori kanë qenë të angazhuar shefi i Sektorit dhe 8 inspektorë. Gjatë periudhës raportuese Sektori i inspektoratit të tregut është angazhuar për realizimin e punëve dhe detyrave të planifikuara sipas planit vjetor të punës , dhe atë në:

- mbikëqyrjen inspektuese të subjekteve afariste – bizneseve , lidhur me regjistrimin e tyre , marrjen e pëlqimeve nga Inspektorati për plotësimin e kushteve minimale: teknike, sanitare, higjienike, të mbrojtjes në punë dhe të mbrojtjes së ambientit dhe posedimin e lejeve të punës,
- kontrollimin e shitjes së palejuar nga subjektet afariste dhe qytetarët , nëpër rrugë, sheshe publike dhe gjelbëruese, trotuare e gjetiu, pa lejen e punës nga organi kompetent i Komunës,
- ekspozimin e mallrave para shitoreve pa leje të organit kompetent,
- respektimin e orarit për fillimin dhe mbarimin e punës nga lëmi i tregtisë, hotelierisë, zejtarisë dhe i shërbimeve të tjera në territorin e komunës së Prishtinës,
- pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të qytetarëve,
- kryerjen e detyrave sipas urdhrit të drejtorit të Drejtoratit nga kompetencat e këtij shërbimi-Sektorit.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ky Sektor ka zbatuar: Ligjin mbi inspeksionin e tregut, Ligjin mbi qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, Ligjin mbi hotelierinë dhe turizmin, rregulloret komunale mbi tarifën dhe ngastrat komunale, Rregulloren mbi mbarimin e orarit të punës në të gjithë lëmejt, udhëzimet komunale mbi regjistrimin e bizneseve, Rregulloren mbi kushtet minimale tekniko sanitare.

Ky Sektor për periudhën raportuese ka kryer kontrollime inspektuese të veprimtarive të ndryshme ekonomike, siç janë të paraqitura në mënyrë tabelore dhe nga secili punëtor.

inspektori	Kontrollime	procesverbale	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Delikte ekonomike	Aktvendime	Pëlqime për kushte sanitare	Urdhëresa me shkrim	Largim shitesve nga rruga	Ankesa qytetarëve	Vlera e mallit të konfiskuar	Mjete te përlogaritura nga pranimi i lokaleve	
											Të Inkasuara	Të pa inkasuara
<u>Ahmet Frangu</u>	<u>401</u>	<u>293</u>	<u>22</u>	<u>/</u>	<u>23</u>	<u>237</u>	<u>12</u>	<u>39</u>	<u>/</u>	<u>1000 .€uro.</u>	<u>36.955 €uro</u>	<u>2.246.€uro</u>
<u>Ali Shala</u>	<u>1.000</u>	<u>789</u>	<u>81</u>	<u>/</u>	<u>75</u>	<u>177</u>	<u>64</u>	<u>69</u>	<u>/</u>	<u>158.€uro</u>	<u>9.851.€uro</u>	<u>2.144.€uro</u>
<u>Merima Kastrati</u>	<u>1.031</u>	<u>692</u>	<u>16</u>	<u>01</u>	<u>24</u>	<u>501</u>	<u>71</u>	<u>271</u>	<u>01</u>	<u>158.€uro</u>	<u>28.010.€uro</u>	<u>8.644.€uro</u>
<u>Shpresa Zhuja</u>	<u>1.018</u>	<u>474</u>	<u>30</u>	<u>/</u>	<u>14</u>	<u>61</u>	<u>/</u>	<u>83</u>	<u>/</u>	<u>2.058.€uro</u>	<u>6.764.€uro</u>	<u>2.345.€uro.</u>
<u>Sefer Dragusha</u>	<u>1.703</u>	<u>529</u>	<u>48</u>	<u>01</u>	<u>04</u>	<u>163</u>	<u>243</u>	<u>402</u>	<u>06</u>	<u>948.€uro</u>	<u>7.614.€uro</u>	<u>2.654.€uro</u>
<u>Haki Shala</u>	<u>195</u>	<u>539</u>	<u>34</u>	<u>/</u>	<u>06</u>	<u>127</u>	<u>165</u>	<u>288</u>	<u>05</u>	<u>483.€uro</u>	<u>13.126.€uro</u>	<u>5.729.€uro</u>
<u>Shemsi Haliti</u>	<u>1.175</u>	<u>481</u>	<u>04</u>	<u>/</u>	<u>08</u>	<u>56</u>	<u>259</u>	<u>443</u>	<u>01</u>	<u>/</u>	<u>4.250.€uro</u>	<u>370.€uro.</u>
<u>Zymer Hoti</u>	<u>1.466</u>	<u>873</u>	<u>08</u>	<u>/</u>	<u>45</u>	<u>391</u>	<u>23</u>	<u>275</u>	<u>/</u>	<u>1.258.€uro</u>	<u>34.589.€uro</u>	<u>4.475. €uro.</u>
<u>Gjithsej</u>	<u>9.689</u>	<u>4.620</u>	<u>315</u>	<u>02</u>	<u>199</u>	<u>1.758</u>	<u>837</u>	<u>1.870</u>	<u>13</u>	<u>6.063.€uro</u>	<u>141.159.€uro</u>	<u>28.607 .€uro.</u>

II. Sektori i inspektoratit sanitar dhe veterinar

Në këtë Sektor kanë qenë të angazhuar shefi i Sektorit dhe 6 inspektorë.

a). Sektori i inspektoratit sanitar

Detyrat e punës së këtij Sektori përfshijnë:

- kontrollimin e artikujve jetësor dhe mjeteve të përdorimit të përgjithshëm,
- kontrollimin e ujit të pijshëm,
- kontrollimin sipas kërkesave të palëve–detyrë e përhershme,
- kontrollimet higjieno-sanitare të objekteve publike (hoteleve, marketeve, shitoreve, restoranteve, bufeve etj, me destinim të njëjtë),
- kontrollimin e objekteve shkollore (kushtet higjien- sanitare),
- kontrollimin e objekteve publike që merren me prodhimet dhe qarkullimin e artikujve jetësor, marrjen e masave për verifikim të rregullsisë së tyre,
- kontrollimin e qoshqeve (hamburger-qebaptore, ëmbëltore), për kushtet higjieno-sanitare dhe marrjen e masave për verifikimin e prodhimeve të tyre,
- kontrollimin e farmacive dhe prodhimeve farmaceutike në territorin e komunës së Prishtinës.

b). Sektori i inspektoratit të veterinarisë

Detyrat e punës së këtij Sektori përfshijnë:

- përgatitjen e planprogramit për vaksinimin e bagëtive dhe qenve në territorin e komunës së Prishtinës,
- mbikëqyrjen e përhershme të mishtoreve, N T P-ve, D P T-ve, restoranteve, hoteleve, etj .ku tregtohen gjërat ushqimore me prejardhje shtazore,
- kontrollimin e përhershëm të qumështoreve dhe të prodhimeve të tyre,
- bën kontrollimin higjieno-veterinar të kafshëve, para, gjatë dhe pas therjes në thertore, bënë shikimin veterinar të mishit dhe vulosjen e tij me vulën e Inspektoratit sanitar.
- kontrollon barnatore veterinarë,
- mbikëqyrë dhe inspekton gjërat ushqimore me origjinë shtazore gjatë prodhimit dhe qarkullimit.

Punët e kryera gjatë periudhës janar – dhjetor 2004, në Sektorin sanitar–veterinar, në mënyrë tabelare do të dukeshin kështu:

Inspektori	Kontroll.	Procesver.	Aktvend.	Rek.sanitare	Mostra të ujit	Mostra të ushqimit	Strisha nga sipërfaqe të punës
<u>Sali Zogiani</u>	715	284	91	33			
<u>Xhemajl Islami</u>	715	284	91	33			
<u>Fadil Salihu</u>	715	284	91	33	177	372	
<u>Idriz Blaku</u>	715	284	91	33			
<u>Arian Brovina</u>	715	284	91	33			
<u>Rexhep Sejdiu</u>	384	72	<u>Fletëparaqitje për kundërvajtje-28</u>		<u>Kontrollimin e prerjes – 211 vica dhe dema dhe 26 qengja.</u>		
<u>Bahdir Gashi</u>	364						

III. Sektori i inspeksionit komunal dhe i komunikacionit

Në kuadër të këtij Sektori, gjatë periudhës raportuese kanë qenë të angazhuar një shef i Sektorit, 7 inspektorë dhe 10 referentë të terrenit.

Detyrat e punës të këtij Sektori janë bazuar kryesisht në këto veprimtari:

- kontrollimi i rrugëve dhe trotuareve për pastrim nga bora dhe nga hedhurinat e ndryshme, largimi i shitësve ambulantë nga trotualet dhe sipërfaqet tjera publike, në bashkëpunim me inspektorët e tregut, Shërbimin Policor të Kosovës dhe të UNMIK-un.
- mbikëqyrja dhe zbatimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës ,mbi kontrollimin e trafikut urban e publik, largimin e autotransportuesve dhe kamionëve me material ndërtimor (me rërë) nga rrugët dhe sipërfaqet publike,
- kontrollimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve publike të gjelbëruara, si p.sh. parku i Gërmisë, parqet tjera të qytetit, kontrollimi i autoparkingjeve, si dhe bashkëpunimi me N P K “Hortikultura”,
- kontrollimi i ndërmarrjeve publike, siç janë “Higjiena- teknika”, “Batllava” etj ,mbi mënyrën e kryerjes së shërbimeve të tyre ndaj qytetarëve,
- kontrollimi i objekteve publike, siç janë: stacionet, sheshet, objektet e përkohshme lëvizëse, panotë, reklamat, firmat ndriçuese, mbishkrimet e objekteve afariste dhe zeytare etj.
- kontrollimi i vendosjes së tavolinave e karrigeve para objekteve hoteliere, ekspozimi i mallrave para lokaleve tregtare, në bashkëpunim me Drejtoratin e Pronës,
- kontrollimi për zbatimin e Rregullores mbi kufizimin e përdorimit të ujit të pijshëm, në mënyrë të padestinuar, si dhe Rregullores për zhurmë,
- kontrollimi i ndërmarrjeve publike shërbyese, si stacionin e autobusëve (për orarin e nisjes dhe arritjes së autobusëve në linjat urbane e ndërurbane),
- kontrollimi i rregullt i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për ujërat fekale dhe atmosferike.
- përgjigjja në kërkesat e palëve rreth paraqitjes së prishjeve të ndryshme të objekteve të infrastrukturës,
- kontrollimi i qoshqeve rreth marrjes së masave ndaj vendosjes së tyre pa leje nga organi kompetent komunal,
- aksionet e përbashkëta me inspektorët e tregut, ata sanitarë etj, në eliminimin e dukurive negative të paraqitura në qytet e rrethinë.

Bazuar në detyrat e parapara me planin e punës për periudhën janar –dhjetor 2004, ky Sektor ka kryer këto punë:

Gjithsej lëndë të pranuar	3.144
Kontrollime	17,457
Procesverbale	8.935
Aktvendime	705

Fletëparaqitje në Gjyk. për Kundërvajtje	1.773
a).Fletëparaqitje të refuzuara nga gjykata	89
b).Fletëparaqitje të vendosura nga gjykata	826
c).Fletëparaqitje në procedurë	927
<u>Gjithësej</u>	<u>1.792.</u>

Dënime nga Gjykata për Kundërvajtje në vlerë prej	53.007 €
----------------------------------------------------------	-----------------

Dënime me qortim nga gjykata	52
Gjoha mandatore nga inspektorët	/

Kontrollime teknike të automjeteve	597
Largim i qoshqeve pa leje	105
Largim reklamash pa leje	360
Largim i objekteve tjera	130
Aksionet e përbashkëta me sektorët tjerë për largimin e tregtarëve ambulatorë nga rruga dhe hapësira publike.	61
Evidencimi i reklamave pa leje	458
Njoftim me përgjigje palëve	406
Kërkesa të palëve të pranuar	2.008
Fletëthirrje palëve	726
Vërejtje gojore	6.556
Shuma e vlerës për vendosjen e tavolinave	23.693.€
Shuma e vlerës për vendosjen e reklamave	5.029.€

IV. Sektori i inspektoratit të ndërtimit .

Në këtë Sektor janë të angazhuar shefi i Sektorit, 2 inspektorë dhe 14 referentë të terrenit.

Sektori i inspektoratit të ndërtimit, në bazë të planit të punës dhe kompetencave të tij, gjatë periudhës janar –dhjetor 2004, i është qasur problematikës së ndërtimit me të gjitha mjete e duhura për të bërë ndalimin apo ndërprerjen e ndërtimeve pa leje. Në këtë periudhë inspektorët e ndërtimit, gjatë kontrollimit të terreneve të tyre, kanë vërejtur një mori ndërtimesh, për të cilat kanë evidencuar dhe konstatuar :

Kontrollime	2.618
Evidencime të objekteve pa leje të ndërtimit	738
Procesverbale	740
Urdhërndalesa	142
Vlera e urdhërndalesave komunale me gjobë	121.600,49.€
Aktvendime për rrënim	204
Aktvendime të ekzekutuara	123
Aktvendime të pa ekzekutuara	81
Janë ekzekutua objekte të ndryshme gjithsej	314
Mbindërtime	13
Themele	11
Tarraca	02
Rrënim kulmesh	03
Rrënim katesh	03
Lokale afariste	15
Shtojca	114
Objekte banimi	06
Garazhe	76
Rrethoja	08
Mure	14
Konstruksione druri	03
Gropime terreni	07
Shtylla në kate	08
Shkallë	09
Pllaka	03

V. Sektori i inspektoratit të bujqësisë , mbrojtjes së ambientit

Në kuadër të këtij Sektori, në periudhën raportuese, kanë punuar shefi i Sektorit dhe 4 inspektorë.

a). Sektori i inspektoratit të mbrojtjes së ambientit jetësor, me punën e tij bën:

- kontrollin e menaxhimit të deponive për hedhjen e mbeturinave,
- kontrollon e mbrojtjes së ambientit nga dëmtimet e ndryshme, qoftë nga personat e përgjegjshëm, apo nga bota shtazore.

b). Sektori i inspektoratit të bujqësisë kryen këto detyra dhe obligime:

- përcjell dhe mbikëqyr ndërmarrjet (kooperativat bujqësore, masat agroteknike),
- bën kontrollimet e jashtëzakonshme, sipas kërkesave të palëve, lidhur me ankesat dhe parashtrirat e tyre,
- kontrollon përqindjen e pijeve alkoolike dhe joalkoolike në qarkullim (nëpër lokalet që merren me shitjen e tyre,
- mbikëqyrë artikujt ushqimor me prejardhje bimore, prodhimin, qarkullimin dhe afatin e përdorimit.

- kontrollon tregjet ku shiten fidanet e pemëve, farërat e ndryshme etj.,
- kontrollon barnatoret bujqësore,
- kontrollon masat agroteknike, lëvrimin dhe kushtet e kërkuara për të,
- bën kontrollimin rreth mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore, si dhe kontrollon, korrje-shirjet gjatë sezonës.

Ky Sektor gjatë periudhës raportuese ka kryer:

Kontrollime	1.335
Procesverbale	1.049
Aktvendime	170
Fletëparaqitje	31
Vlera e artikujve ushqimore që janë qitur jashtë qarkullimi	26.860. €
Sasia në kg	12.908.kg
Sasia në lit.	9.741.Lit

Në aktivitetin e përgjithshëm të Drejtoratit, përveç punëve të parapara me planprogram, janë përfshirë edhe një varg aktivitetesh tjera me rëndësi për këtë Drejtorat, të cilat do t'i japim paksa më të detajizuara në kuadër të të gjithë sektorëve .

- Sistemi i veprimit pothuajse është organizuar në grupe të përbëra nga sektorët, duket përshtatur veprimtaritë dhe ngjashmëritë e punëve, gjë që edhe është vepruar me mjaft sukses, me rezultate mjaft inkurajuese dhe me një shkallë mjaft të lartë si të efikasitetit, ashtu edhe të angazhimit, por edhe të marrjes së masave administrative ndaj të gjithë atyre që nuk respektojnë ligjin dhe rregulloret në fuqi, çka shihet edhe nga raporti, ku për 6 muaj pothuajse kemi arritur shkallën e barabartë me atë të vitit të kaluar fiskal.
- Aktiviteti në përgjithësi, por edhe në kuadër të sektorëve, është shtrirë gjatë gjithë periudhave, ku për çdo muaj do të përshkruhet aktiviteti i përafërt.
- Intensifikimi i aktivitetit dhe marrja e të gjitha masave të mundshme për largimin e ekspozimit të mallrave jashtë lokaleve dhe objekteve shitëse, për të gjitha bizneset, janë formuar grupe të përbashkëta në nivel të sektorëve dhe kryesisht këtu janë angazhuar Sektori komunal, Sektori i tregut dhe Sektori sanitar dhe i ambientit.
- Në bazë të angazhimeve dhe kontrollimeve të kryera por edhe vetë gjendjes që është krijuar me angazhimet permanente, bile edhe ditëve të vikendit dhe festave, e shpeshherë edhe gjatë orëve të vona të natës, tani kemi një gjendje mjaft të relativizuar dhe me shkallë të përmirësimit gradual. Në këtë drejtim duhet cekur edhe bashkëpunimin me SHPK-në, veçmas gjatë aksioneve të ndërmarra gjatë natës.
- Angazhimi dhe puna mjaft e shtuar në kontrollimin e të gjitha bizneseve dhe subjekteve rreth respektimit të orarit të punës dhe marrja e masave konform Rregullores në fuqi. Puna është kryer në grupe nga sektorët gjegjës, ku kryesisht atakohet ky lëmë dhe me një intensitet shumë më të shtuar ditëve të vikendit, por shpesh edhe natën. Puna kryhet përmes ekipeve kujdestare të cilat janë të obliguara dhe në bazë të urdhëresës së Drejtorit, që të shtunave të kujdestarojnë edhe pas orës 23.
- Rezultatet janë mjaft të mira dhe besojmë se kemi arritur që të mbulojmë terrenin diku rreth 85-90% dhe poashtu, me të njëjtën përqindje dhe efektshmëri . Puna është organizuar në grupe, ku kryesisht janë të angazhuar sektori komunal, i tregut, sanitar, e sipas nevojës edhe sektorët tjerë.
- Shtimi i aktivitetit për kontrollimin e bizneseve rreth pajisjes me dokumente gjegjëse, leje pune për aktivitete ekonomike e të tjera, si dhe rreth lejeve për reklama, për shfrytëzim të hapësirave publike, e të ngjashme. Në këtë drejtim janë angazhuar

inspektorët e tregut, si dhe në një aksion të përbashkët edhe personeli nga Drejtorati i Ekonomisë.

- Nga ana e Sektorit sanitar, përpos punëve të përhershme, me theks të veçantë është intensifikuar kontrolli i të gjitha objekteve ushqimore që gravitojnë në afërsi të mensës së studentëve. Ky kontroll i shtuar u bë si rezultat i asaj se mensa nuk ka punuar për një kohë të konsiderueshme, dhe u bë kryesisht në objektet përreth mensës, si dhe në të gjitha objektet e dislokuara në afërsi të fakulteteve.
- Me një kujdes të veçantë janë kontrolluar të gjitha objektet e mëdha hoteliere dhe depot ushqimore. Me të njëjtin aksion janë kontrolluar edhe të gjitha pikat e karburanteve dhe pompave të benzinës, si në kontrollimin e lejeve të punës, ashtu edhe çështjeve të tjera përkatëse, varësisht nga lloji i kontrollit.
- Rëndësi e veçantë i është kushtuar kontrollit të të gjitha furrave të bukës, si në aspektin higjienik dhe teknik, ashtu edhe rreth kualitetit dhe peshës së bukës, ku edhe kemi pranuar kërkesa të veçanta në këtë drejtim. Gjendja, në përgjithësi tregon se një numër i caktuar i tyre nuk janë në gjendje të mirë, për çka do të ndërmerren masa adekuate ligjore.
- Kontrollimi i terrenit nga ana e Sektorit për ndërtim, në lëmin e mbikëqyrjes së ndërtimit, edhe pse është bërë me mjaft angazhime, rezultati nuk është ashtu si është pritur. Nëse krahasojmë me periudhat paraprake, ku trendi i ndërtimit ka rënë në shkallë të madhe (duke mos i llogaritur “bosët e mëdhenj”), si rezultat i angazhimeve tona dhe të sezonit dimëror, që është i papërshtatshëm për punë ndërtimore. Në këtë periudhë kemi bërë largimin e të gjitha garazheve metalike dhe montuese, aksion ky i filluar qysh në nëntorin e kaluar, e që u tregua shumë i suksesshëm, ku u larguan 325 sosh, ose 98%, kurse vetëm gjatë këtij viti janë larguar 49.
- Largimi i të gjitha pengesave në rrugë (në formë parkingjesh e të ngjashme) si dhe shtyllave të vendosura në trotuare dhe në hapësira të tjera nga persona fizikë pothuaj në të gjitha rrugët. Është dashtë të intervenohet dy e tri herë radhazi, pasi që shpesh, edhe pas largimit, përsëri na paraqitet gjendje e njëjtë, veçmas në rr.”Bill Klintoni“, rr.“Agim Ramadani“, Qendra, deri te Rrethi, rr.“Nazim Gafurri”, rr.“Luan Haradinaj”, lagjet: “Ulpiana”, “Dardania”, “Lakrishta”, e në rrugë të tjera.
- Punë e suksesshme është treguar edhe në aksionin lidhur me largimin e të gjitha shtesave metalike dhe tendave metalike, llojesh të ndryshme, nga objektet tregtare dhe hoteliere, qoshqet etj. , e deri te ato të banimit. Aksioni ka filluar në rr.”Bulevardi i Dëshmorëve“-pjesa te Rrethi, me vazhdimin në tërësi të lagjes “Ulpiana”, lagjja “Dardania”, rr.” Bill Klintoni“, e deri në përfundim të tërësishëm në të gjitha pjesët e qytetit. Megjithë kundërshtimet e mëdha dhe lloj-lloj paraqitjesh të ndryshme, aksioni po vazhdon me ritmin e paraparë, ku rreth 60 % e terrenit kryesisht është pastruar. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe ka qenë një angazhim i madh për largimin e qoshqeve pa leje, që ishin të vendosura në hapësira publike pa kurrfarë dokumentacioni, Aksioni është vazhdimësi nga viti i kaluar. Vlen të theksohet se ky aksion, edhe pse është në vazhdim e sipër, për shkak të mungesës së Vendimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës për anulimin e lejeve të përkohshme, të lëshuara nga Qeveria e mëhershme dhe mosmarrja e një Vendimi për lëshimin e lejeve në bazë të Planit urbanistik të qytetit, ky aksion vazhdimisht has në vështirësi.
- Një punë dhe angazhim mjaft i mirë është bërë në evidencimin dhe largimin e reklamave pa leje dhe të vendosura jashtë çdo kriteri. Aksioni është në vazhdim e sipër. Deri në përfundim të periudhës raportuese, janë larguar 360 reklama, të vendosura pa leje, dhe është bërë evidencimi i 458 sosh, ku një numër i konsiderueshëm prej tyre kanë siguruar leje për vendosje.
- Nga ana e Sektorit sanitar, me kërkesë të Drejtorisë gjegjëse, është bërë kontrollimi i gjendjes në të gjitha objektet shkollore dhe objektet shëndetësore, si në qytet, ashtu edhe në pjesët rurale.
- Puna në terren rreth mirëmbajtjes së rrugëve, si nga bora, ashtu edhe në aspektin tjetër, kontrollimet në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, si dhe bashkëpunimi

mjaft i mirë me të gjitha kompanitë gjegjëse, ku edhe falë angazhimit tonë, pothuajse për çdo avari dhe problem, brenda një kohe shumë të shkurtë, është vepruar, ku si rezultat i gjithë kësaj kemi arritur ta mbajmë një gjendje stabile.

- Në bashkëpunimin me ShPK-në është bërë një punë e mirë në largimin e kombibusëve dhe autotaksive që veprojnë pa leje pune. Veçmas kujdes iu është kushtuar vijës 3 dhe 4, duke mos lënë anash edhe pjesët tjera. Rezultati, për momentin ka qenë i mira, por për fat të keq, menjëherë pas aksioneve gjegjëse dhe largimit tonë, gjendja pothuaj përsëritet. Prandaj, këtu edhe kërkohen alternativa të reja, sepse edhe përkundër mjaftë fletëparaqitjeve të bëra, gjendja nuk është përmirësuar, andaj duhet një qasje e përbashkët edhe me policinë .
- Angazhimi për largimin e shitësve ambulantë nga rrugët, veçmas në rr.“Nënë Tereza”, rr.“Garibaldi”, rr.“Ulpiana”, rr.”Tirana”, dhe nga pjesët afër tregjeve, ku në bashkëpunimin me ShPK-në janë ndërmarrë aksione të përbashkëta, për çka, një kohë të gjatë kemi angazhuar personelin e WDG-së, veçmas në Ulpianë dhe te Tregu i gjelbër. Edhe përkundër gjithë këtyre angazhimeve, rezultatet nuk janë të kënaqshme, sepse me largimin tonë, gjendja po përsëritet.
- Me kujdes të veçantë punohet rreth kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.
- Angazhimi i përhershëm i komisionit për dhënien e pëlqimeve tekniko–sanitare dhe kushteve për punë subjekteve afariste dhe subjekteve tjera shoqërore, ku puna është e organizuar në grupe dhe në përbërje mikste nga sektorët e ndryshëm, si ai i tregut, komunal dhe sanitar, efektet janë mjaftë inkurajuese. Kërkesat e arritura, brenda 48 orësh marrin përgjigje, për çka mund të thuhet se edhe në këtë drejtim, kemi arritur një efikasitet. Me përgjegjësi mund të thuhet se çdo kërkesë e arritur në Drejtoratin tonë, brenda afatit të paraparë shqyrtohet dhe merr përgjigjen e merituar.
- Kujdes të veçantë i kemi kushtuar kontrollimit të mishtoreve dhe furnizimit të tyre, si dhe mënyrës së ruajtjes dhe hedhjes së mbeturinave. Për këtë e kemi paraparë shpërndarjen e rekomandimeve për mbikëqyrjen e mbeturinave të mishtoreve dhe mënyrën e hedhjes së tyre .
- Gjatë periudhës së fundit, kujdes i veçantë i është kushtuar kontrollit të ujit të pijshëm dhe kontrollit të depove të mëdha të gjërave ushqimore, me pretekst të veçantë kontrollimin e mallrave me afat të skaduar dhe mënjanimin e tyre. Gjatë periudhës raportuese kemi larguar dhe hedhur mallra në vlerë 644.410 €uro.
- Inspektorati i tregut, gjatë kësaj periudhe ka shtuar kontrollin e lejeve të punës, si dhe të rregullshmërisë së dokumentacionit dhe librave afariste në ndërmarrjet që merren me shitjen e materialit ndërtimor.
- Puna ka vazhduar me ritmin e njëjtë lidhur me largimin e qoshqeve, reklamave , garazheve, e në mënyrë të veçantë, kujdes dhe rëndësi i është kushtuar largimit të shtesave metalike nga objektet. Ky aksion, me mjaft sukses po shkon drejt përmbylljes .
- Gjatë periudhës raportuese është vazhduar me kontrollimin e ndërmarrjeve dhe shoqërive aksionare, si dhe vazhdimi i kontrollit rreth regjistrimit të ambulancave dhe enteve private shëndetësore, posedimit të lejeve të punës dhe dokumentacioneve përkatëse, gjithashtu edhe i subjekteve të tjera ekonomike .
- Sektori sanitar ka vazhduar me kontrollimin e objekteve të shitjes me shumicë për skadim të afatit të mallrave, e në veçanti me vazhdimin e kontrollimit të objekteve hoteliere.
- Së bashku me ShPK-në kemi vazhduar largimin e objekteve shitëse dhe shtesave të ndryshme, si në rr.“Luan Haradinaj “, rr.” Nënë Tereza”, rr.“ Edit Durham “ te selia e UNMIK-ut, ku me kërkesën e tyre është bërë ky aksion. Është punuar edhe rreth largimit të e shitësve ambulantë, pikërisht nga ajo pjesë , dhe aksioni ka qenë mjaft i suksesshëm, për çka edhe administrata e UNMIK-ut në Komunë ka dhënë një vlerësim mjaftë të mirë për këtë aksion .
- Në bashkëpunim me ShPK-në dhe me Ministrinë e Transportit, kemi organizuar aksione për largimin e kombibusëve, autotaxive, dhe autobusëve që veprojnë pa

leje dhe jashtë linjave përkatëse, por, për fat të keq, pas çdo aksioni gjendja sikur përsëritet .

- Largimi i qoshqeve , reklamave, dhe shtesave të ndryshme, ka vazhduar sipas ritmit të paraparë . Në vazhdimësi i është dhënë prioritet kërkesave të palëve, dhe kjo është praktikuar në punën e të gjithë sektorëve.
- Kemi shtuar angazhimet edhe në Sektorin e ndërtimit, për çka, me keqardhje konstatoj se në këtë lëmë ende nuk kemi gjetur alternativë për ndaljen e ndërtimeve. Këtë e pamundësojnë edhe veprimet tjera, siç është dukuria e mosdhënies së lejeve ndërtimore, për çka, qytetarët pa kurrfarë kriteri i qasen ndërtimit, pastaj mosgjetja e mundësisë së legalizimit të objekteve që mundë të legalizohen, si dhe pajisja shumë e dobët e këtij Sektori me mjete për punë normale. Duhet ta pranojë publikisht se në këtë, padyshim ndikon edhe padëgjueshmëria totale e qytetarëve, si dhe kërcënimet e pareshtura, para të cilave ne mbesim pa kurrfarë mbrojtje, nga asnjë subjekt.
- Këtë Sektor e ka ngatërruar mosdhënia e lejeve ndërtimore, kurse aty ku nuk duhej dhënë leje dhe ku me të vërtetë kishim krijuar një kontroll (e kam fjalën të mbindërtimit), tani, së fundi janë dhënë pesë leje për mbikulme. Tani kjo do të jetë mjaftë vështirë të kontrollohet, për çka nuk dimë se ku do të bijnë pasojat.
- Punë mjaft e mirë është bërë edhe me largimin e objekteve shitëse nga oborret e shkollave , ku sipas kërkesës së Drejtoratit të Arsimit iu kemi qasur kësaj pune dhe suksesi ka qenë inkurajues, veçmas te Shkolla e Medicinës, Shkolla Ekonomike, si dhe te disa shkollave të tjera.
- Puna në grupe, edhe gjatë kësaj periudhe ka funksionuar si më parë. Veçmas kemi rezultate të mira në planin e të hyrave, që sillemi në kufijtë e planifikimit, si dhe në dhënieve të pëlqimeve tekniko-sanitare, ku nga 1.713 lëndë të pranuar për periudhën janar-dhjetor 2004, të gjitha kanë marrë përgjigje me kohë.
- Gjatë kësaj periudhe rëndësi i është kushtuar kontrollit të ujit të pijshëm në viset rurale, ku deri në përfundim të dhjetorit do të punohet në këtë drejtim dhe në kontrollimin e objekteve shkollorë dhe shëndetësore, në aspektin sanitar.
- Vazhdimi i kryerjes së detyrave, sipas sektorëve, bëhet sipas planit të paraparë. Gjatë këtij fundmuaji kujdes i kemi kushtuar takimeve që kemi pasur me ndërmarrjet shërbyese dhe publike lidhur me kualitetin e kryerjes së shërbimeve dhe qasjes së bashkëpunimit të ndërsjellë.
- Vëmendje e posaçme i është kushtuar edhe punës në terren për kontrollimin e lejeve të punës për subjekte, si dhe ekspozimin e mallrave të ndryshme.
- Në bashkëpunim me SHPK-në shumë herë janë bërë aksione të përbashkëta në tregjet e qytetit dhe në rrugët përreth tyre, për largimin e shitësve ambulantë, të cilat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen në Tregun e gjelbër.
- Janë organizuar aksione të përbashkëta me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Pronës për regjistrimin dhe pagimin për vendosjen e tavolinave në hapësira publike dhe reklamave të ndryshme pa leje, sipas rregulloreve në fuqi dhe vendimeve përkatëse. Gjatë këtij aksioni janë grumbulluar mjete në shumë prej 23.693 €uro.
- Gjatë tërë vitit është organizuar kujdestari e rregullt, duke llogaritur këtu edhe ditët e vikendit dhe kjo ka dhënë rezultate. Shpeshherë, së bashku me SHPK-në, janë kontrolluar objektet e ndryshme dhe janë eliminuar shumë dukuri negative.
- Ka edhe shumë aktivitete, të cilat për arsye procedurale nuk mund të përfshihen në mënyrë analitike për kontrole të veçanta. Kujdes i veçantë i kushtohet bashkëpunimit, që nënkupton daljes në ndihmë të gjitha drejtorateve tjera, për çka mund të konstatohet se ky Drejtoritë shpesh është i angazhuar edhe jashtë mundësive reale.
- Mendojmë se për periudha të caktuara kohore do të kemi një stabilizim total dhe do të përqendrohemi në punë profesionale dhe në perfeksionimin e rregulloreve që në përgjithësi, për shumë lëme mungojnë. Në veçanti punën tonë e vështirësojnë së tepërmi mungesa e mjeteve teknike dhe e materialeve për punë .

- Duke u bazuar në kontrollimin e bërë të terrenit , raportin e punës, analizat që bëhen çdo javë në kuadër të Drejtoratit , marrjen e masav, si dhe në përkushtimin për vazhdimin e ngritjes së shkallës në punë, edhe përkundër problemeve të mëdha që na përcjellin (si objektive, ashtu edhe subjektive), veçmas ballafaqimi me lloj-lloj palësh , me një gjendje shumë të dobët teknike e materiale, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në azhuritetin e punëve tona, prapë se prapë, me angazhimin tonë maksimal kemi rezultate mjaft të mira. Në anën tjetër, punën tonë e pengojnë edhe një varg ligjesh të paharmonizuara dhe rregulloret përkatëse, si në shërbime publike, ashtu edhe në lëmin e ndërtimit. Edhe përkundër këtyre mangësive, përkushtimi për një punë më efikase nuk do të mungojë dhe presim bashkëpunim dhe rezultate edhe më të mira .
- Që nga dt. 03.05.2004, janë formuar grupet e përbashkëta të sektorëve për fillimin e kontrollimeve sipas rajoneve të caktuara . Gjithashtu, është formuar komisioni i veçantë për dhënien e pëlqimeve tekniko-sanitare të kushteve për punë.
- Bashkë me ShPK-në, nga dt. 04. deri 08.05.2004, është bërë aksioni i përbashkët me inspektorët e komunikacionit për largimin e traktorëve dhe kamionëve në Rr.”Vushtrria“dhe rr.“Lidhja e Prizrenit“. Me Stacionin e ShPK-së “Veriu” nga dt. 05. deri më 15.05.2004 është bërë kontrollimi dhe largimi i shitësve ambulantë para Tregut të gjelbër dhe rrugëve përreth.
- Kontrollimet kryesisht janë orientuar në lejet e punës të subjekteve afariste dhe në ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve. Rezultatet janë të dukshme, por me kalimin e kohës kjo dukuri sikur po ngjallet .
- Në aspektin sanitar janë bërë kontrollime kryesisht në ëmbëltove dhe në objekte hoteliere, për arsye të konsumit të gjerë të artikujve dhe frekuentimit të lartë të qytetarëve në këto objekte, duke mos lënë anash edhe kontrollimin e subjekteve tjera.
- Sektori i ndërtimit, edhe pse po ballafaqohet me probleme natyrash të ndryshme, ka zhvilluar aktivitetet në parandalimin e ndërtimeve, ku hovi i tyre, tani në këtë sezon është më i madh.
- Ky Sektor ka vazhduar me largimin e objekteve montazhe në qytet dhe shtesave në objekte të ndryshme.
- Është mbajtur kontiunitet i duhur me ndërmarrjet shërbyese dhe bashkëpunimi me Drejtoratet. Nga dt.30.05.2004, e deri në përfundim të punës së përbashkët, do të regjistrohen dhe do të paguhen shfrytëzuesit e reklamave dhe të hapësirave publike pranë objekteve hoteliere. Në përgjithësi aksioni do të jetë i përbashkët, në mes të: Drejtoratit të Pronës, Drejtoratit të Inspeksioni dhe të Drejtoratit të Shërbimeve Publike.
- Me SHPK-në (duke përfshirë të gjitha stacionet policore dhe policinë regjionale) kemi pasur vazhdimisht aksionet të përbashkëta për eliminimin e dukurive negative, siç janë: largimi i shitësve ambulantë nga vendet e ndaluara për shitje dhe të veprimtarive të tjera.
- Në Sektorin sanitar dhe të bujqësisë, kujdes të veçantë iu është kushtuar kontrollimit të depove, kuzhinave, ëmbëltoveve dhe objekteve të tjera që përgatisin gjëra ushqimore.
- Sektori i ambientit, sipas udhëzimeve është marrë me evidencimin e deponive dhe mbeturinave në pjesë të ndryshme, ku me Higjiena - teknikën i kanë larguar në masë të madhe, bashkë me shumë automjeteve të shkatërruara . Në këtë drejtim kemi pasur një lehtësi nga persona të ndryshëm, të cilët po bëjnë grumbullimin e mbeturinave metalike.
- Sektori i tregut, përpos angazhimeve në komisione të ndryshme dhe aksione të përbashkëta me SHPK-në dhe sektorë të tjerë, rëndësi të veçantë i ka kushtuar kontrollimit të subjekteve për leje pune, ku në këtë aspekt, për periudhën raportuese, nga 1 janari e deri më tani, kemi pranuar 1.713 lëndë për aplikim, që tregon për një angazhim mjaft të madh .
- Kujdes i veçantë i është kushtuar kontrollit të mirëmbajtjes së pjesëve gjelbëruese dhe rrugëve, ku, në veçanti janë konstatuar parregullsi te pronarët e ndryshëm që

pengojnë trotuaret me materiale të ndryshme ndërtimore (rërë, blloka etj). Sa i përket mirëmbajtjeve së rrugëve, nuk kemi konstatuar parregullsi .

- Sektorët tjerë, krahas kërkesave dhe rasteve në terren, kanë vepruar në bazë të specifikave përkatëse dhe rregullativave ligjore.

Ky Drejtorat, gjatë aktivitetit për mirëmbajtjen e procesit të punës, ka zhvilluar kontakte dhe bashkëpunim të mirë me të gjitha subjektet; si me drejtoratet brenda Komunës së Prishtinës, po ashtu edhe me drejtoratet e inspeksioneve të komunave të tjera të Kosovës, me Administratën e UNMIK-ut, Policinë e UNMIK-ut, Shërbimin Policor të Kosovës, ndërmarrjet publike shërbyese, mediat elektronike dhe të shkruara, e në veçanti bashkëpunim të mire ka pasur me bashkësitë lokale dhe me qytetarët në territorin e Prishtinës.

DREJTORATI I KADASTRIT DHE I GJEODEZISË

Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë është organ i administratës së Komunës së Prishtinës, i cili ka si fushëveprim të rregullt mirëmbajtjen e operatit kadastral.

Gjatë periudhës raportuese, ky organ ka qenë i angazhuar rreth kërkesave të personave juridikë, siç janë ndërmarrjet shoqërore dhe ato publike, dhe personave fizikë. Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, për përgatitjen e dokumentacionit rreth privatizimit, nga Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë kërkon informacione plotësuese rreth pronësisë dhe identifikimit. Gjithashtu, ky Drejtorët, gjatë kësaj periudhe është kyçur drejtpërdrejt ose tërthorazi rreth rregullimit, incizimit për përgatitjes së dokumentacionit për rregullimin e rrugëve në qytet dhe në pjesën rurale, sepse të gjithë tenderët e shpallur për rregullimin e infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, nga ky Drejtorat kërkojnë që t'u lëshohet dokumentacioni mbi pronësinë.

Ky organ, për nevojat e Asamblesë Komunale ka punuar të gjitha kërkesat që janë në interes për Kuvendin e Komunës së Prishtinës, sidomos për nevojat e infrastrukturës, planifikimit dhe shërbimit pronësor.

Krahas këtyre punëve të cilat u cekën më lart, ky Drejtorat ka një obligim ndaj qytetarëve të kësaj komune, mbi kërkesat e paraqitura këtij Drejtorati nga personat fizikë, edhe pse na mungon i tërë elaborati kadastral, si ai juridik, ashtu edhe ai teknik (origjinal). Gjatë kryerjes së punëve sipas kërkesave të parashtruara, si nga personat fizikë, ashtu edhe nga ata juridikë, hasim në vështirësi për realizimin e kërkesave në mungesë të elaboratit, por falë angazhimit maksimal të stafit udhëheqës dhe punëtorëve, ky organ i ka kryer me kohë obligimet ndaj qytetarëve, ndërmarrjeve dhe institucioneve të tjera.

Gjatë periudhës raportuese, këtij organi dhe nga ky organ janë lëshuar dhe pranuar ky numër i lëndëve:

- fletë poseduese-----	5203	copë,
- kopje plani-----	4663	copë,
- certifikata të ndryshme-----	4843	copë,
- ndërrimet dhe bartjet në operat----	1623	copë,
- lëndë të kryera të terrenit -----	520	copë,
- lëndë të terrenit, në procedurë-----	80	copë,
- kërkesa të ndryshme, të kryera-----	200	copë.

Është me interes të veçantë të theksohet se shënimet pronësore-numerike, dhe atë në raport me vendimet juridike, në shumicën e rasteve nuk korrespondojnë njëra me tjetrën, për arsye se të dhënat grafike janë të periudhës 1964 - 1979, ndërsa të dhënat numerike diku në vitin 1997.

Një numër i veçantë i vendimeve juridike nuk përputhen me gjendjen me të cilën posedon Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, dhe për këtë arsye paraqiten vështirësi tekniko-juridike në zbatimin e tyre.

Gjatë periudhës mars – prill, të gjithë ekspertët e lëmit të gjeodezisë që punojnë për shërbimet e Komunës së Prishtinës, kanë qenë të angazhuar për rilevimin aerofotogrametrik " Prishtina 2004".

Ky projekt i rëndësishëm është organizuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, Agjencioni Kadastral i Kosovës dhe Komuna e Prishtinës. Në këtë detyrë kanë qenë të angazhuara të gjitha strukturat e bashkësive lokale të Komunës së Prishtinës dhe qytetarët.

Kontribut të veçantë në këtë projekt kanë dhënë edhe qytetarët si dhe mbështetja financiare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Sipas projektit të lartcekur janë kryer të gjitha fazat e punës nga ana e Komunës së Prishtinës dhe barra më e rëndë i ka mbetur Agjencionit Kadastral të Kosovës. Nga ky projekt priten rezultate konkrete.

Gjatë periudhës raportuese janë kryer edhe këto punë:

- incizimi i situacionit për rrugën “Tirana”, në gjatësi prej 680 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Abdyl Rama”, në gjatësi prej 383 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Ahmet Krasniqi”, në gjatësi prej 1886 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Eduard Liri”, në gjatësi prej 816 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Lidhja e Prizerenit”, në gjatësi prej 884 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Muharrem Fejza”, në gjatësi prej 2008 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Sheshi I Arbrit”, në gjatësi prej 694 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Sali Nivica”, në gjatësi prej 403 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Malush Kosova”, në gjatësi prej 489 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Agron Rrahmani”, në gjatësi prej 421 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Dëshmorët e Marecit”, në gjatësi prej 562 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Çeta e Llapit”, në gjatësi prej 450 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Gazmend Zajmi”, “Rrahim Beqiri”, “Xheladin Hana”, në gjatësi prej 2050 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Haxhi Zeka”, në gjatësi prej 1900 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Nuhi Berisha”, në gjatësi prej 600 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Mark Isaku”, në gjatësi prej 378 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Rexhep Krasniqi”, në gjatësi prej 1200 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Adrian Krasniqi”, në gjatësi prej 303 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Andrea Gropa”, në gjatësi prej 1080 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Shkupi”, në gjatësi prej 750 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Bedri Begolli”, në gjatësi prej 550 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Zagrebi”, në gjatësi prej 970 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “27 Nëntori”, në gjatësi prej 955 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Agron Rrahmani”, në gjatësi prej 423 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Vushtrria”, në gjatësi prej 756 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Isa Kastrati”, në gjatësi prej 958 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Drenica IV”, në gjatësi prej 333 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Mentor Ratkoceri”, në gjatësi prej 206 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Naser Hajziri”, në gjatësi prej 210m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Niket Dardani”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Maliq P.Gjinolli”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Mbreti Bardhyl”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Idriz Gjilani” ,
- incizimi i situacionit për rrugën “Bedri Gjini”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Sylejman Vokshi”,
- incizimi i situacionit për rrugën “2 Korriku”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Lidhja e Lezhës”, në gjatësi prej 620 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Pjetër Bogdani”, në gjatësi prej 240 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Feriz Blakqori”, në gjatësi prej 140m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Mbretëresha Teuta”, në gjatësi prej 420 m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Nuhi Berisha”, në gjatësi prej 600m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Gjergj Balsha”, në gjatësi prej 620m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Holger Pedersen”, në gjatësi prej 620m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Kukësit”, në gjatësi prej 600 m,

- incizimi i situacionit për rrugën “Shaban Shala”, në gjatësi prej 1270m,
- incizimi i situacionit për rrugën “Sylejman Jashari”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Rifat Krasniqi”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Afrim Krasniqi”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Onufri”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Bedri Pejani”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Te Bahollët”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Mic Sokoli”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Behar Begolli”,
- incizimi i situacionit për rrugën “Pas Doganës”.

Për nevojat e drejtorateve dhe të institucioneve tjera janë kryer këto punë:

- incqizimi i situacionit të terrenit në tri dimensione për nevoja të tregut, lokacioni te Amortizatorët, në sipërfaqe prej S=12.90.66 ha,
- incizimi i situacionit për rregullimin e shtratit të përroit të Matit, në Lagjen e Spitalit, në gjatësi prej 778 m,
- incizimi i situacionit për rregullimin e shtratit të përroit të Matit, në lagjen “Kalabria”, në gjatësi prej 470 m,
- kthimi i kufirit të rrugës për ngastrën kadastrale nr.80, zona kadastrale Matiçan, gjatësia prej 300 m,
- kthimi i kufirit të rrugës për ngastrën kadastrale nr.123/19, zona kadastrale Matiçan, gjatësia prej 350 m,
- kthimi i kufirit të rrugës (udhëkryqi për Gjilan), z.kadastrale Çaglalvicë, për ngastrën kadastrale nr.303,
- kthimi i kufirit të ngastrës kadastrale nr.699/8 dhe 699/6, zona kadastrale Sofali.
- identifikimi i pronave për nevoja të “Hortikulturës”,
- indentifikimi dhe rilevimi i sipërfaqes së gjendjes faktike te kompleksi ish-“Kino Rinia”, në sipërfaqe prej S=1.75.25 ha,
- identifikimi dhe rilevimi i sipërfaqes së gjendjes faktike për Shkollën e re në lagjen “Dardania”, në sipërfaqe prej S=9.76.30 ha,
- indentifikimi dhe rilevimi i sipërfaqes së gjendjes faktike për lokacionin te ish-Fakulteti Teknik (i vjetëri), në sipërfaqe prej S=2.32.05 ha,
- indentifikimi dhe rilevimi i sipërfaqes së gjendjes faktike në Zonën industriale, në sipërfaqe prej S=6.80.30 ha,
- incizimi i objektit “Motrat e Nderit”,
- lokacioni i Qerdhës së fëmijëve në Ulpianë,
- lokacioni i Ambulancës në Mat,
- lokacionin për laborator të barnave në QKU,
- incizimi i objektit të ish-“Bankosit”,
- incizimi i objektit të Doganës në Prishtinë,
- rikthimi i kufirit të një pjese të lokacionit për nevojat e KFOR-it në lagjen “Arbëria”,
- incizimi i rrugës për nevojat e KFOR-it në lagjen “Arbëria”,
- kthimi i kufirit të lokacionit të Shkollës së Mësuesisë,
- ripërtëritja e kufijve të rrugëve në fshatin Bërrnicë e Epërme,
- ripërtëritja e kufijve të disa rrugëve në Hajvali,
- ripërtëritja e kufijve të disa ngastrave përreth komandës së KFOR-it në Prishtinë,
- rilevimi i gjendjes faktike të Deponis së qytetit, me sipërfaqe prej 14.08.05 ha,
- kthimi i kufirit të rrugës, parcela nr.1408, zona kadastrale Matiçan,
- rilevimi i gjendjes faktike të QKU-së, me sipërfaqe prej 56.62.00 ha,
- rilevimi dhe përpunimi i situacionit për nevojat e gjimnazit ”Xhevdet Doda” dhe për ndërtimin e Shkollës për Aftësi Profesionale ,
- rilevimi dhe përpunimi i situacionit për nevojat e “Hortikulturës”,te “Freskia”
- kthimi i kufirit, rilevimi dhe përpunimi i situacionit për nevojat e “Hortikulturës” në lagjen “Arbëria”, në sipërfaqe prej 13.30.31ha,

- për nevojat e përgjithshme, është bërë konstatimi i uzurpimeve në rrugën "Caraleva" dhe në rr. "Haxhi Zeka",
- incizimi i situacionit për nevojat e "Institutit të Historisë",
- ripërtëritja e kufijve të rrugëve në lagjen "Kalabria",
- incizimi i situacionit për nevojat e "Hortikulturës" në Zllatar.

DREJTORATI I RINISË DHE I SPORTIT

Në bazë të programit të punës të Drejtoratit të Rinisë dhe të Sportit dhe të politikave programoreve të sektorëve të Drejtoratit, gjatë vitit 2004 janë realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet dhe përkrahjet e parapara për klubet sportive dhe organizatat rinore.

Në bashkëpunim me Komitetin për Kulturë, Rini, Sport dhe Gjini janë përkrahur 64 projekte të sportit dhe të rinisë. Gjatë periudhës gjashtëmujore kemi funksionuar së bashku me Drejtoratin e Kulturës dhe të Gjinisë, ndërsa prej muajit korrik 2004 në mënyrë të pavarur.

Për klubet sportive dhe grupet, apo individët, të cilët janë në aktivitete sportive, vazhdimisht kemi ndarë mjete financiare sipas kriterëve të organizimit të turneve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe funksionimin e klubeve të cilat nuk kanë mundësi materiale për të marrë pjesë në ligat kombëtare. Këtu duhet të theksojmë kujdesin tonë të vazhdueshëm për sportet më pak atraktive dhe sportin e femrave.

Nga klubet të cilat ne i kemi ndihmuar, mund të përmendim rezultatet kulminante të klubit të ping-pongut "Art- foto" – kampion dhe fitues i Kupës, KF "Kosova" – fitues i Kupës së Kosovës, KSH "Prishtina" – fitues i kampionatit ekipor dhe i Kupës së Kosovës, si dhe vendi i 19-të në Kupën evropiane në Turqi, që konsiderohet si rezultat i cili do të ndihmojë në masë të konsiderueshme në ndërkombëtarizimin e shahut dhe sportit në përgjithësi.

Gjithashtu, vlen të përmenden edhe rezultatet e mira të klubeve të atletikës, karatesë, basketbollit, e të notit. Ne kemi qenë bashkëorganizatorë dhe kemi ndihmuar materialisht turneun multietnik të futbollit për të rinj, turneun tradicional të futbollit "Adem Jashari", turneun tradicional në hendboll për femra për nder të "Ditës së Gruas", turneun në karate tradicionale, maratonën "Vrapojmë së bashku– 6 km", turneun në ping-pong, Turneun ndërkombëtar të karatesë, manifestimet sportive për nder të "Ditës së Prishtinës" dhe shumë turne të tjera.

Posaçërisht jemi angazhuar në organizimin e dy turneve tradicionale të boksit "Adem Jashari" dhe turneut tradicional të shahut "Memoriali Hyzri Talla 2004", të cilat janë nën patronatin e Kuvendit Komunal të Prishtinës. Vështirësi të theksuara financiare dhe organizative kemi pasur në organizimin e turneut të boksit, për shkak të raporteve jo të mira të punës në mes të Federatës së Boksit të Kosovës dhe klubit të boksit "Prishtina".

Sa i përket turneut të shahut, çdo gjë ka qenë në rregull dhe sipas raporteve vlerësuese të asociacioneve sportive të cilat merren me këtë degë të sportit, ky ka qenë turneu më i suksesshëm dhe masovik për vitin 2004.

Në fund të vitit, bazuar në rezultatet e arritura të sportistëve dhe ekipeve të kryeqytetit, kemi bërë përzgjedhjen e dhjetë sportistëve më të mirë, shpresave të sportit të Prishtinës dhe zgjedhjen e trajnerit, pedagogut, gazetarit dhe klubit më të mirë.

Sipas të gjitha komenteve dhe raporteve në mjetet e informimit, puna dhe aktiviteti i mirë i Drejtoratit të Rinisë dhe të Sportit. Gjatë kësaj periudhe kemi ndihmuar rreth 46 klube sportive dhe shkolla të sportit, botimin e literaturës sportive, renovimin e katër fushave të vogla sportive në viset rurale dhe urbane, trajnime për kuadro sportive të komunës tonë etj.

Në Sektorin e rinisë janë përkrahur materialisht OJQ-të dhe grupet rinore, të cilat kanë implementuar projektet e bazuara në politikat tona lokale rinore. Për të rinjtë të cilët janë treguar vullnetarë të mirë, sportistë të mirë dhe të rinj, të cilët kanë treguar rezultate të mira në fushat e veprimtarisë së tyre në rrafshin e kulturës, kemi bërë ndarjen e 40 bursave, nga 50 € në muaj, për dhjetë muaj.

Janë përkrahur financiarisht shënimi i "Ditës së të Dashuruarve", festivali i vallëzimit modern "Global Motion", festivali i muzikës për të rinj "Rock për rock", grupet e të rinjve, të cilët promovojnë vlerat e kulturës urbane "Hip – hop" dhe pjesëmarrje në shumë seminare dhe tryeza në të cilat është diskutuar Ligji për rini.

Për herë të parë është formuar Asambleja komunale e Fëmijëve dhe është siguruar pjesëmarrja në festivalin botëror të tërinjve.

Aktiviteti më i rëndësishëm për Sektorin e Rinisë në vitin 2004 ka qenë pjesëmarrja dhe realizimi i projektit “Muaji i Rinisë 2004” me moto: “Për ne, asgjë pa ne”. Ky projekt është “koncipuar” nga Departamenti i Rinisë në MKRS dhe ka paraparë aktivitete një mujore në të gjitha komunat e Kosovës. Projekti ka pasur karakter garues dhe në të njëjtën kohë ka qenë edhe mënyrë e promovimit të vlerave rinore të individëve, grupeve të të rinjve, OJQ-ve rinore dhe të organizatave qeveritare. Shtyllë e përbashkët e këtij projekti ka qenë realizimi i dy projekteve: “Standardet për Kosovën– 8 debate” dhe “Grumbullimi i veshmbathjeve dhe lodrave për fëmijë skamnor dhe bonjak”.

Pas përfundimit të aktiviteteve një mujore në 30 komuna të Kosovës, Komisioni profesional i Departamentit të Rinisë ka shpallur fituese Komunën e Prishtinës dhe i ka ndarë çmimin “Komuna e Rinisë për vitin 2004”. Kjo do të thotë se aktivitetet në qytetin tonë kanë qenë më të mirat dhe janë veçuar dukshëm me cilësi të prezantimeve të pjesëmarrësve. Nga ky çmim, komuna jonë ka përfituar 5 bursa për studentët vullnetarë të OJQ-ve rinore të cilat kanë participuar në programin fitues.

Komuna jonë për vitin 2004 është bartëse e shpërblimit tradicional “Flamuri Kalimtar për Komunën e Rinisë”. Për të gjitha këto aktivitete, gjatë vitit 2004 janë shpenzuar 171079.60 € Në fund duhet të themi se kemi ngecje të theksuar në rrumbullakësimin e tërësishëm financiar të disa projekteve tona të rëndësishme, për shkak të ndryshimit të procedurës së pagesave nga ana e Ministrisë së Financave. Shpresojmë se me bashkëpunim konstruktiv me Drejtoratin e Financave dhe të Pronës do të tejkalohen këto probleme me rastin e pagesave për partneret - implementues të projekteve tona.

Drejtorati i Rinisë dhe i Sportit gjatë vitit 2004 ka pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me drejtoratet tjera të Komunës dhe me udhëheqjen politike dhe ekzekutive komunale.

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA GJATË VITI 2004

Nr rend	Projekti	Sektori	Shuma në Euro	realizimi	Vërejtje
1	Libri “Atletika “ Hysen Rakovica		1490€		
2	Turneu i futbollit të vogël (të rinjtë e KK)		500€		
3	URKU “Harroni brengat- dashurohuni”		4500€		
4	KF “Flamurtari” Prishtinë – kotizim për gara		1900€		
€	KF “Minatori” Kizhnicë – renovim i stadiumit		4430€		
6	KH “Prishtina”- femrat /gara për 8 mars 2004		1350€		
7	OJQ “Vullneti Rinor” – debat		300€		
8	KH”Prishtina” – meshkujt – kotizimi dhe pajisje sportive		4040€		
9	KSH “Prishtina” Prishtinë		4500€		
10	Shkolla e Basketbollit për të rinj		1500€		
11	Bursat kreative për studentë		20000€		
12	Klubi i Çiklizmit “Prishtina”		3000€		
13	Klubi i shenjëtarisë “Dardania”		2500€		
14	Turneu i karat. “Memoriali Besim Mala 2004”		700€		
15	Klubi i futbollit “Kosova” femrat – turne		2000€		
16	Klubi i pingpongut “Art- Foto” Prishtinë		2000€		
17	Shkolla fillore “Filip Shiroka” - Slivovë		1150€		
18	Klubi i karatesë “Ipon” – turne ndërkomb.		2000€		
19	Klubi i karatesë “Iliria” – rekuizita		1000€		
20	“YMCA” – kartela evropiane		3500€		
21	Lidhja e shenjëtarisë e Prishtinës		3500€		
22	KF “Minatori” Kizhnicë – kotizim		2190€		
23	Aeroklubi “Prishtina”		4000€		
24	Klubi i notit “Scan – Color” Prishtinë		500€		
25	Klubi i tenisit “Prishtina” – turne memorial		1000€		
26	KF “Kosova” Prishtinë		4000€		
27	KF “Rilindja” Prishtinë		1250€		
28	SHB “Prishtina” Prishtinë		2500€		
29	Federata e Karatesë Tradicionale –B. Fazliu		1000€		
30	Turneu ndërkombëtarë i shahut – Kampionati individual i Evropës 800 €				
31	Turneu tradicional i futbollit” Adem Jashari”		680€		
32	Klubi i skitarisë “Universiteti” Prishtinë		2000€		
33	KSH “Kosova” Prishtinë		1270€		
34	Shkolla fill. në Prapashticë- terreni sportiv		5593,60€		
35	Turneu multietnik i fëmijëve në futboll		313€		
36	Klubi i pingpongut “Prishtina” Prishtinë		2500€		
37	Klubi i bodibildingut “Arnoldi”		2000€		

Nr rend	Projekti	Sektori	Shuma në Euro	realizimi	Vërejtje
38	Festivali botëror i të rinjve "Barcelona"		625€		
39	KF "2 Korriku" Prishtinë		1093€		
40	KF "Rilindja" Prishtinë		5000€		
41	Lidhja komunale e hendbollit "11 Qershori"		1200€		
42	Lidhja ndërkomb. e futbollit "11 Qershori"		2200€		
43	Klubi i hendbollit "Prishtina"-femrat, garat për "Play off"		1200€		
44	Shoqata e peshkatarëve "Krapit" Prishtinë		1000€		
45	KH "Prishtina" – gara, liga e parë		2000€		
46	"Tekëando-Litera", profesionale Nuhi Gashi		1200€		
47	Klubi i basketbollit "Universiteti"		3220€		
48	"Muaji i Rinisë -2004"		11355€		
49	KF "Shkëndija" Llukar		2500€		
50	Turneu i volejbollit në rërë –Gërmi		1500€		
51	OJQ "Vullneti Rinor"- aktivitete rinore		1500€		
52	KSH "Prishtina"-Kupa Evropiane në Turqi		2500€		
53	Kupa Evropiane në shah – udhëtim zyrtar		1400€		
54	Karate – Kaltrina Krasniqi – Tokio		1230€		
55	Klubi i atletikës "Prishtina"		4000€		
56	Boks – ndeshje ndërkombëtare Pr- Anel		2000€		
57	Projekti i aktorit Plumb Emini		1000€		
58	Projekti "Global Motion"		600€		
59	Klubi i hendbollit "Prishtina" (meshkujt)		5000€		
60	Punimi i afisheve dhe mirënjohjeve		1000€		
61	Turneu tradicional i shahut "Memoriali Hyzri Talla 2004"		4500€		
62	Shpallja e sportistëve të vitit 2004		6300€		
63	Turneu tradicional i boksit "Adem Jashari"		8000€		
64	Shoqata e bjeshkatarisë "Prishtina"		2500€		
	Gjithsej		171079.60 €		

DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SOCIALE

Me të filluar punën në vitin kalendarik 2004, kemi pasur takimin e parë me punëtorët e Drejtoratit tonë, me ç'rast kemi analizuar punën e vitit të kaluar. Poashtu, në këtë takim kemi biseduar në përgjithësi për përgatitjet dhe punën që na pret në vitin 2004. Drejtorati ynë në vitin e kaluar kalendarik ka pasur katër sektorë ndërsa me propozimin e Bordit të drejtorëve, në dhjetor të vitit 2003 u vendos që ky Drejtorat të ketë tre sektorë. Tani kemi: Sektorin e Shëndetësisë Parësore, Sektorin e Shëndetësisë Publike dhe Sektorin e Mirëqenies Sociale, në kuadër të të cilit bën pjesë edhe Shërbimi për strehim social. Drejtorati ynë numëron gjithsej 14 të punësuar, ku punët kryhen me kohë dhe si duhet.

Meqë në vitin paraprak ishte shpallur konkursi për drejtor të Shtëpisë së Shëndetit dhe të Entit për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore, më 09/01/2004, Paneli intervistues ka bërë intervistimin e kandidatëve. Pas përfundimit të procedurës në tërësi, janë zgjedhur dy drejtorët e rinj. Drejtor i Shtëpisë së Shëndetit u zgjodh dr. Nexhmedin Hoti, specialist epidemiolog, me përvojë profesionale mbi 20 vjeçare dhe dr. Haki Dragusha, specialist i ndihmës së shpejtë mjekësore, gjithashtu me përvojë të gjatë profesionale mbi 20 vjeçare.

Në fillim të janarit kemi shqyrtuar buxhetin sektorial dhe buxhetin komunal për shëndetësi. Nga shuma e përgjithshme e buxhetit sektorial janë ndarë 2.088.956,00 € për paga të punëtorëve sipas rekomandimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Kosovës, pjesa tjetër prej 684.464,00 € janë ndarë në mënyrë racionale për dymbëdhjetë muajt e vitit 2004, në pozicione të veçanta, siç janë: rryma 40.000 € uji 25.000 € hedhurinat

40.000 € telefoni 25.000 € ngrohja qendrore 30.000 € karburante për autoambulanca 100.000 € karburante për gjeneratorë 50.000 € barna, reagensa, filma të rëntgenit 120.000 € material stomatologjik 50.000 € material zyrtar 50.000 € material higjienik 50.000 € “pety-cash” 42.000 € qiraja për ambulance 6.000 € mirëmbajtja e autoambulancave 20.000 € shpenzimet tjera të paplanifikuara 36.464 € pra gjithsej 684.464 € Buxheti komunal ka realizuar këto projektet: “Dezinsektimi hapësinor i Prishtinës”, 100.000 € “Deratizimi i kanalizimit të Prishtinës”, 50.000 € “Ndërtimi i QMF-së në Kalabri”, 340.000, € për raste të rënda sociale”, 50.000 € renovimi i Ambulancës shëndetësore në Bardhosh, d.m.th. gjithsej 560.000 €

Gjatë janarit 2004, në takim me përfaqësuesit e Shtëpisë së Shëndetit, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Bankës Botërore, u vendos që të instalohet sistemi informativ shëndetësor në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Për këtë arsye janë blerë 20 kompjuterë, të cilët janë shpërndarë nëpër të gjitha QMF-të në komunën tonë, me çka realizohet në përpikëri projekti i sistemit informative në mjekësinë parësore në komunën tonë. Gjatë muajve janar-shkurt kemi bërë furnizimin me barna, material tjetër sanitar, me karburante, si edhe nevoja tjera për mirëvajtjen e punëve të përditshme.

Projektet: Gjatë muajve të parë të këtij viti kanë vazhduar punët përfundimtare në ndërtimit e Entit për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore dhe pastaj është pajisur me inventar të duhur dhe më 13.05.2004 është bërë përrurimi i këtij objekti, me vlerë prej 750.000,00 € mjete këto vetanake, të ndara nga Kuvendi i Komunës. Poashtu, gjatë muajve të parë të këtij viti është vazhduar puna rreth renovimit të ndërtesës së Stomatologjisë, e cila në fund të muajit qershor ka përfunduar dhe tani jemi duke bërë përgatitjet për furnizim me aparaturë shëndetësore përkatëse, e cila pritet të arrijë së shpejti dhe të montohet. Vlera e këtij renovimi mbërrin shumë më 220.000,00 € Këto mjete financiare janë siguruar nga mjetet vetanake të Kuvendit Komunal, ndërsa mjetet financiare në vlerë 125.000,00 € për blerjen e aparaturës stomatologjike i ka siguruar Ministria e Shëndetësisë e Kosovës. Në muajin shkurt është përgatitur projekti për renovimin e QMF III në Prishtinë. Me të përfunduar procedura e prokurimit, në prill kanë filluar punët dhe më 11.06.2004 është bërë përrurimi i kësaj qendre. Vlera financiare arrinë shumë më 100.000,00 € mjete këto të siguruara nga buxheti sektorial për vitin 2003. Në muajin korrik janë kryer punët në ndërtimin e QMF në Mat. Vlera financiare arrinë shumë më 180.000,00 € ku 90.000€ janë siguruar nga CDF-ja dhe 90.000 € nga mjetet vetanake të buxhetit komunal. Së shpejti do të kryhen punët rreth rregullimit të oborrit me rrethojë edhe do të përrurohet objekti. Gjatë muajve mars, prill dhe maj të këtij viti, është bërë renovimi i Dispanserit për sëmundjet e mushkërive, ku u investuan 140.000 € mjete këto të siguruara nga Ministria e Shëndetësisë e Kosovës. Përrurimi i këtij objekti u bë në qershor.

Në muajin maj është përgatitur projekti për renovimin e QMF -V në Dardani, për të cilin ka përfunduar edhe procedura e prokurimit. Kompania fituese ka filluar punën me kohë dhe së shpejti pritet të përfundojnë punët edhe të fillojë së funksionuari kjo QMF. Vlera financiare arrinë shumë më 200.000,00 € mjete financiare të siguruara nga buxheti sektorial për vitin 2003. Në muajt tetor dhe nëntor është përgatitur projekti për ndërtimin e QMF në Kalabri. Tenderi ka përfunduar dhe pritet që së shpejti të fillojë puna në realizimin e këtij projekti, në vlerë prej 340.000,00 € Gjatë muajve maj dhe qershor është përgatitur projekti për dezinfektimin hapësinor të Prishtinës, i cili do të fillojë të realizohet më 02.07.2004. Vlera e këtij projekti mbërrin shumë më 99.767,00 € mjete financiare të siguruara nga mjetet vetanake të Kuvendit të Komunës për vitin 2004. Tenderin për implementimin e këtij projekti e ka fituar kompania e mirënjohur “Ekologjia” e Ferizajt, e cila është e specializuar edhe e licencuar për këtë veprimtari. Realizimi i këtij projekti ka filluar sipas afatit të paraparë me projekt më 02.07.2004 dhe ka përfunduar me sukses më 22.08.2004. Implementimi i këtij projekti është kryer në tri faza dhe me dinamikë të paraparë sipas projektit. Gjatë muajit qershor është punuar në përgatitjen e projekteve tjera, të cilat duhen të realizohen gjatë këtij viti. Po ashtu, gjatë muajit qershor është përgatitur orari i pushimeve vjetore për vitin 2004. Nga ana e Drejtoratit tonë është përgatitur projekti i quajtur “Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të qytetit të Prishtinës”. Pas procedurës së prokurimit, tenderin për implementimin e këtij projekti e ka fituar kompania e licencuar dhe e

specializuar “Doktor Exterminator“ me seli në Prishtinë. Implementimi i këtij projekti ka filluar me kohë, sipas parashikimit me projektin e përgatitur nga Drejtorati. Ai ka filluar me 11.10.2004 dhe ka përfunduar me sukses, më 22.10.2004. Realizimi i këtij projekti ka kushtuar 47.437,50 € mjete këto të siguruara nga buxheti i Kuvendit të Komunës së Prishtinës. Është përgatitur projekti për renovimin e Ambulancës shëndetësore në Barilevë, në vlerë prej 9.200,00 € i cili është realizuar në fund të muajit nëntor. Pastaj, është përgatitur edhe projekti tjetër për renovimi e QMF-së I në Prishtinë dhe pajisjen me aparaturë stomatologjike, e cila është kryer në fillim të muajit dhjetor, në shumë prej 19.250,00 € Në gjysmën e dytë të muajit dhjetor janë blerë edhe tri autoambulanca moderne për Mjekësinë parësore, në vlerë prej 126.500,00 € dhe në mënyrë solemne u janë dorëzuar institucioneve tona të Mjekësisë parësore. Këto mjete financiare janë siguruar nga buxheti i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për çka u jemi shumë mirënjohës. Gjatë vitit 2004 kanë specializuar edhe 32 mjekë të mjekësisë familjare, të cilëve u janë ofruar vendet e tyre përkatëse dhe pagat e duhura, sipas nomenklaturës kosovare për shëndetësi. Janë blerë aparatura të përsosura për diagnostifikim, me çka kemi përmirësuar mjaft mirë shërbimet mjekësore të Mjekësisë parësore në Prishtinë, në aspektin profesional dhe atë teknik. Në muajin dhjetor, të drejtën për specializimin e kanë fituar dymbëdhjetë mjekë të praktikës së përgjithshme dhe tetë mjekë stomatologë, të cilët do të fillojnë specializimin më 01.02.2005. Pra, Drejtorati ynë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të Kosovës kujdes të veçantë i kushton edhe ngritjes profesionale të kuadrove tona në mjekësinë parësore. Ky Drejtorat udhëheq Mjekësinë parësore të komunës sonë, ku përfshin dhjetë qendra të mjekësisë familjare dhe gjashtëmbëdhjetë ambulanca shëndetësore në viset rurale. Tri nga këto ambulanca shëndetësore punojnë në objekte private, çka do të thotë se duhet investuar edhe më shumë në infrastrukturën shëndetësore parësore.

Në Mjekësinë parësore të komunës tonë ka të punësuar gjithsej 875 punëtorë, duke përfshirë: mjekë, stomatologë, mjekë specialistë, kuadër i mesëm i profileve të ndryshme shëndetësore, kuadër administrativ dhe punëtorë të tjerë ndihmës.

Spektori i mirëqenies sociale, me punën e tij të vazhdueshme ka bërë:

- pranimin, seleksionimin, shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave të palëve, gjithsej 268 kërkesa,
- pranimin e palëve dhe ofrimin e ndihmës së nevojshme profesionale dhe juridike,
- hartimin e formularëve dhe instruksione për realizimin sa më efikas të të drejtave të palëve që i drejtohen këtij Spektori,
- verifikimin e gjendjes së përgjithshme sociale të fëmijëve në varfëri të skajshme dhe të rrezikuar, 162 familje ,
- raportin javor të drejtorit të Drejtoratit mbi aktivitet e zhvilluara të Spektorit,
- kontaktet dhe takimet me shoqata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare,
- përpilimin e projekteve dhe realizimin e tyre, siç janë:
 - projekti për ndihmë familjeve në varfëri të skajshme për festën e Bajramit (250 familje me nga 40, 00 €),
 - projekti për ndihmë të përkohshme për raste të rënda emergjente, (56 raste, me shumën e përgjithshme 26.063,00 €),
 - projekti për ndihmë fëmijëve jetim financiar nga organizata shoqërore “Makbulja“, me nga 20,00 € në muaj, gjithsej 194 fëmijë jetim,
 - projekti për sigurimin e dhuratave për fëmijë jetim për Vitin e Ri 2005 (258 fëmijëve nga një dhuratë për Vitin e Ri, dhënë nga kompania “Buçaj”, së bashku me Kuvendin e Komunës së Prishtinës),
 - projekti: “Programi dimëror 2004/2005”, (1800 familje me nga 50,00 € i cili pritet të realizohet së shpejti.

Në **Shërbimin e strehimit social** kryhen punë të shumta që kanë të bëjnë me strehimin e nevojtarëve. Aty bëhet pranimi i kërkesave, seleksionimi i tyre, klasifikimi dhe njoftimi i palëve. Gjatë vitit 2004, gjithsej janë parashtruar 158 kërkesa, prej tyre 20 kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive të shkatërruara nga lufta, ndërsa 138 lidhur me strehim

social. Të gjithë këtyre personave që kanë bërë kërkesa ju kanë kthyer përgjigjet, sipas mundësive ekzistuese. Janë lëshuar 50 rekomandime për “Habitat”-in për shtyrjen e afatit të ekzekutimit për dëbimit të qytetarëve nga banesat e uzurpuara. Në koordinim me organizatën irlandeze “Gol”, në lagjen “Dodona” në Prishtinë, gjatë këtij vitit janë rindërtuar 18 shtëpi për minoritetin rom dhe 2 shtëpi për banorë të tjerë. Është bërë mbikëqyrja e vazhdueshme e kryerjes së punëve rreth vendosjes së kontejnerëve për strehim të përkohshëm të nevojtarëve, ku së shpejti pritet vendosja e disa familjeve.

DREJTORATI I MBROJTJES CIVILE DHE I EMERGJENCËS

Raporti i punës së Drejtoratit të Mbrojtjes Civile dhe të Emergjencës për vitin 2004 përfshinë aktivitetet e programuara dhe ato të realizuara të njëjësive organizative (Sektorin e mbrojtjes civile dhe Sektorin e emergjencës), bashkëpunimin e drejtpërdrejt të Drejtoratit me drejtoratet tjera komunale, Departamentin e Menaxhimit Emergjent në Ministrinë e Shërbimeve Publike, SHPK-në, TMK-në, UNMIK-un, KFOR-in dhe subjektet tjera gjegjëse.

Bazë themelore për punë të suksesshme gjatë vitit 2004, Drejtorati i ynë ka pasur:

- Statutin e Kuvendit të Komunës,
- Rregulloren mbi sistematizimin e punëtorëve, me të cilën përfshihet fushëveprimi i Drejtoratit,
- Planin vjetor të punës,
- programet mujore të sektorëve dhe analiza e realizimit të tyre,
- inspektimet dhe vizitat në BL dhe ndërmarrje publike,
- trajnimet e organizuara nga stafi vendor dhe ai ndërkombëtar, si dhe detyrat e dala nga rastet emergjente.

Detyrë e rregullt e Drejtoratit tonë, gjithnjë ka qenë realizimi i detyrave dhe i obligimeve që kanë dalë nga takimet e rregullta të Bordit të drejtorëve dhe të Kuvendit të Komunës.

Gjatë vitit 2004, një vend meritor kanë zënë ushtrimet, seminarët, trajnimet, kurset e organizuara nga lëmi i mbrojtjes civile dhe i emergjencës, të cilat janë organizuar nga niveli komunal dhe ai qendror, por në raste të veçanta edhe këshillime të ndryshme e simpoziume që janë organizuar nga vendorët, e në raste të rralla edhe nga ndërkombëtarët.

Është me rëndësi të theksohet se në periudhën kohore janar – dhjetor 2004, rëndësi të posaçme i është kushtuar formimit të shtabeve të mbrojtjes civile dhe emergjente në ato bashkësi lokale ku, deri në këtë kohë, nuk ishin formuar, pastaj aftësimi të Shtabit Komunal të Mbrojtjes Civile dhe Emergjente, që më me sukses ta kryej misionin e tij në raste emergjente. Për këtë çështje, në fillim të vitit është organizuar një ushtrim teorik me eprorët e SHMC-së, me temën: “Roli i SHMC-së në raste emergjente”. Pjesa praktike e këtij ushtrimi është realizuar në pjesën e dytë të vitit 2004, me sukses të shkëlqyeshëm. Sektorit të emergjencës, në këtë vit iu është kushtuar kujdes i veçantë, sidomos rreth plotësimit të Brigadës së zjarrfikës me kuadro të nevojshme dhe pajisje të ndryshme profesionale për punë të suksesshme. Duhet theksuar se gjatë këtij viti, kjo Brigadë ka intervenuar shumë herë. Intervenimet, kryesisht kishin të bënin me shuarjen e zjarreve, por kishte edhe intervenime lidhur me avaritë e ndryshme teknike. Intervenimet ishin mjaftë të shpejta, profesionalisht mirë të organizuara, çka do të thotë se dukshëm i kanë zvogëluar dëmet materiale. Për fat të mirë, gjatë këtyre intervenimeve nga ana e zjarrfikësve, viktima nuk ka pasur, po as lëndime serioze.

Qendra komunale për informim, alarmim dhe koordinim në këtë Drejtorat, gjithashtu zë një vend mjaft të rëndësishëm dhe meritor, e cila ka kontribuar në realizimin e detyrave dhe objektivave të Drejtoratit. Kjo është njëra nga qendrat më të kompletuara në nivel vendi, e cila ka pajisje të nevojshme dhe mban radio-lidhjet me bashkësitë lokale. Kjo Qendër dhe subjektet tjera, gjatë punës së vet në këtë periudhë, ka dhënë një mori informatash për intervenime të ndryshme në kuadër të komunës e më gjerë, për nevojat e intervenimit dhe

sanimit të pasojave nga zjarri, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, dëbora etj. Këtë vit, Qendra është pajisur me mjete moderne bashkëkohore për punë të suksesshme.

Aftësimet profesionale dhe trajnimet e personelit të Drejtoratit në tërësi dhe subjekteve në Komunë, veçmas bashkësitë lokale dhe ndërmarrjet publike komunale kanë pasur një pozicion të çartë dhe mjaftë pozitiv gjatë punës në vitin 2004. Është vlerësimi ynë se mbajtja e rregullt e mbledhjeve të kolegjiut dhe pastaj mbledhjet e sektorëve, ku kryesisht debatohet për detyrat e realizuara dhe atyre që duhet realizuar, ka dhënë rezultate të lakmueshme. Është rregull në këtë Drejtorat që të gjithë punëtorët ta kenë planin ditor të punës. Kjo, si përvojë, është treguar mjaft pozitive, çka do të thotë se këtë praktikë duhet përkrahur edhe gjatë vitit 2005. Pastaj, informimi dhe raportimet me kohë dhe në mënyrë adekuate mbi të gjitha rezultatet dhe lëshimet eventuale, kanë qenë mënyra më e mirë dhe më adekuate e përcjelljes dhe informimit mbi ngjarjet aktuale të ne dhe më gjerë. Mendojmë dhe propozojmë që këto metoda duhet aplikuar, zhvilluar dhe thelluar edhe më tej gjatë punës në vitin 2005.

Gjatë vitit 2004, inspektorët e Mbrojtjes Civile dhe ata të preventivës dhe hulumtimit të zjarreve kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në realizimin e programit të punës, duke vizituar (inspektuar) mbi 300 subjekte të ndryshme në komunë dhe më gjerë. Qëllimi i këtyre vizitave ishte verifikimi i drejtpërdrejt në terren lidhur me mënyrën e organizimit të mbrojtjes civile dhe emergjencës në këto subjekte dhe preventiva (parandalimi i zjarreve dhe avarive të ndryshme).

Drejtorati ynë në përgjithësi dhe një pjesë e Shtabit të Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës në nivel të komunës, gjatë ngjarjeve të 17 dhe 18 marsit kanë qenë të mobilizuar dhe kanë dhënë një kontribut të veçantë me angazhimin e tyre në terren. Gjatë asaj kohe edhe Qendra Komunale për Informim, Alarmim dhe Koordinim ka qenë tërë kohën e mobilizuar dhe ka ofruar informata të shumta dhe të sakta për udhëheqjen komunale gjatë këtyre ngjarjeve. Njëherit, ka mbajtur lidhje të rregullta me bashkëpunëtorët e Drejtoratit që ishin në terren duke u mundësuar që sa më lehtë të kryhen obligimet e tyre. Për këtë angazhim dhe për ngjarjet (në tërësi) të 17 dhe 18 marsit, Drejtorati ynë ka përgatitur raport me shkrim, të cilin ia ka dorëzuar, personalisht, kryetarit të Kuvendit të Komunës, i cili njëherit është edhe kryetar i Shtabit për Gatishmëri Emergjente.

Vlen të theksohet se në periudhën raportuese njëvjeçare, në bazë të programit të rregullt të punës, Drejtorati ynë ka vizituar Drejtoratet e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës në Komunën e Prizrenit dhe atë të Dragashit. Vizitat kishin karakter pune dhe këto vizita i vlerësojmë si mjaftë të dobishme dhe të suksesshme, çka do të thotë se vizita të tilla duhet të organizohen edhe gjatë vitit 2005 edhe në komunat tjera të Kosovës, në mënyrë që të shkëmbehen përvoja në mes drejtorateve. Varësisht nga mundësitë financiare, do të ishte mirë që t'i bëhet një vizitë edhe ndonjë Komune në Shqipëri, përkatësisht Drejtoratit të Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës.

Një kontribut të veçantë në punën raportuese ka dhënë edhe komisioni prej tre anëtarësh, në nivel të Drejtoratit, i caktuar nga Komisioni Parlamentar për Gatishmëri Emergjente i Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë punuar bashkërisht në përgatitjen e Ligjit të MC-së dhe të GE-së me sukses dhe Ligji i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës në procedurë të mëtejme.

II. SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

Sektori i mbrojtjes civile kryesisht është angazhuar në vënien e bazës organizative dhe operacionale të mbrojtjes civile dhe emergjencës nëpër Bashkësi lokale dhe ndërmarrjeve komunale në territorin e komunës së Prishtinës. Qëllimi themelor i Sektorit të MC-së dhe të E-së ka qenë ngritja sa më në nivel të përgatitjes –organizimit dhe veprimit në raste emergjente në mbarë territorin e komunës. Në nivel të Sektorit kemi konstatuar se analizat tona në nivel të Drejtoratit, objektivat dhe synimet që i kemi parashtruar në fillim të vitit në programet tona janë arritur në tërësi dhe është ngre niveli profesional i bashkëpunëtorëve të Sektorit në arritjen e qëllimeve të parashtruara. Edhe në këtë vit, sikur edhe viteve të kaluara, një kujdes të veçantë i kemi kushtuar punës ekipore në terren lidhur me përgatitjen dhe

formimin e shtabeve të mbrojtjes civile dhe emergjencë, gjithherë në baza vullnetare, në ato bashkësi lokale që deri më tani nuk janë formuar. Për këtë punë, në terren është përgatitur raport me shkrim, me të cilin janë njoftuar organet përkatëse komunale.

Për t'i realizuar detyrat dhe objektivat tona, në fillim të vitit kemi hartuar kornizën orientuese të prioriteteve mbi organizimin e mbrojtjes civile dhe emergjencës nëpër bashkësitë lokale.

Me rastin e vizitave dhe bisedave, të organizuara nëpër këto subjekte, janë marrë shënimet konkrete dhe janë evidencuar kuadrot për përfshirjen e tyre nëpër shtabe dhe njësitë e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës. Me kohë janë hartuar listat konkrete me emrat e njerëzve dhe kemi vazhduar me konstituimin e shtabeve, gjithherë në baza vullnetare, në Bashkësinë V, VII, VII₁, IX, IX₁, XI, XII₂ lokale, në Koliç, Prugovc, Bardhosh, dhe në Slivovë. Në Planin vjetor të punës ka qenë e paraparë që të formohen Shtabet e MC-së dhe E-së në të gjitha BL-të, por për arsye të pakujdesisë së udhëheqjes në BL-të, siç janë Bashkësia VII₂, XIII dhe e XV lokale, nuk kemi arritur t'i formojmë Shtabet e MC-së dhe E-së. Duhet cekur se janë bërë edhe disa përpjekje për formimin e këtyreshtabeve edhe në BL të Graçanicë dhe të Llapla Sellë, por, deri më tani, ata nuk kanë treguar vullnet të mirë në këtë drejtim. Është planifikuar që në vitin 2005 të bëhet një bashkëpunim edhe më intensiv në BL të Llaple Sellës dhe të Graçanicës.

Duhet theksuar se në formimet e shtabeve të mbrojtjes civile dhe emergjencës, kryesisht kanë marrë pjesë komandanti dhe kryeshefi i Shtabit të MC-së dhe E-së në nivel të Komunës me bashkëpunëtorë, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre profesional dhe i kanë pajisur – kompletuar me dokumentacion përkatës.

Synimi i punës ka qenë i përqendruar në vazhdimin e aktivitetit mbikëqyrës dhe inspektues nëpër subjektet e përcaktuara me prioritet në territorin e komunës së Prishtinës. Me këtë rast, rëndësi të veçantë i është dhënë subjekteve ekonomike, shkencore, arsimore dhe kulturore. Janë evidencuar dhe inspektuar rreth 100 bartës të përgatitjeve për MC dhe E. Nëpër të gjitha subjektet e inspektuar janë hartuar procesverbalet dhe janë propozuar mbi 500 masa për punë dhe aktivitete të mëtejme.

Programet e hartuara janë realizuar në tërësi dhe me mjaft sukses. Nuk ka pas probleme të theksuara dhe me të gjithë bartësit është arritur pajtueshmëri e plotë dhe e dyanshme.

Me Programin e vizitave inspektuese janë inspektuar shumica e fakulteteve, disa institucione shkencore dhe historike, informative, si dhe të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.

Nëpër disa fakultete (Ekonomik dhe Juridik) ka shumë pak aktivitete të ndërmarrë në mbrojtjen dhe ruajtjen e jetës dhe pasurisë. Nuk ka mjete për zjarrfikje dhe nuk janë ndërmarrë masat dhe aktivitetet për tejkalimin e situatave emergjente.

Në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme ekzistojnë aparatet e zjarrfikjes dhe aty-këtu edhe pikat e hidranteve, në të shumtën e rasteve të servisuara dhe të aftësuar për përdorim, por pa përcjellje adekuate me ekipe gjegjëse për përdorimin e tyre.

Dokumentet e Planit të MC-së dhe E-së mungojnë nëpër të gjitha subjektet e vizituara. Aty ku ka pasur tentativa për hartimin e tyre, ato nuk përcillen me masa, angazhime dhe veprime konkrete me mjete dhe forca adekuate. Masat dhe veprimet konkrete të angazhimit të potencialit njerëzor në parandalimin e zjarrit dhe fatkeqësive të tjera nuk janë definuar dhe konkretizuar, gati të të gjitha subjektet e inspektuara gjatë vitit 2004.

Masat e mbrojtjes kundër zjarrit, përveç aparateve të siguruara të zjarrfikjes dhe disa pikave të hidranteve, në asnjë shkollë dhe fakultet nuk janë hartuar dhe konkretizuar ose përcjellë me ekipe dhe mjete për tejkalimin e gjendjes emergjente. Nuk janë aftësuar kuadrot ekzistuese dhe nuk janë caktuar ekipet për intervenimin emergjent.

Edhe masa e evakuimit emergjent nuk është përpunuar gati në asnjë subjekt të vizituar.

Vlerësimi i rrezikshmërisë, si pjesë e Planit të GE, nuk është hartuar në asnjë subjekt, meqë ai është bazë për hartimin e mbarë dokumentacionit të Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës.

Në mungesë të këtyre dokumenteve, ekipi inspektues gjithkund ka shpjeguar dhe me procesverbale ka këshilluar mënyrën e hartimit të tyre, me ç'rast kemi insistuar në profesionalizëm dhe kolektivitet gjatë hartimit të dokumenteve të Planit të MC-së dhe E-së. Gjithëashtu, që nga viti 2002, në mënyrë të vazhdueshme kemi dërguar materiale gjegjëse për mënyrën e hartimit të Planit të MC-së dhe E-së.

Në bazë të të dhënave të lartcekura në këtë Raport, mund të konstatohet se niveli i përgatitjeve të subjekteve të vizituara është fillestar dhe nën nivelin e duhur. Por, ajo që gëzon është fakti se gjithkund kemi hasur në gatishmëri që këto përgatitje të jenë më me përgjegjësi dhe në nivel të duhur profesional.

I udhëhequr nga Sektori i mbrojtjes civile dhe në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e emergjencës, në pjesën e parë të vitit 2004, me mjaft sukses është organizuar ushtrimi teorik me Shtabin e mbrojtjes civile komunale, që ishte një trajnim i eprorëve të Shtabit, dhe më vonë është formuar grupi i punës për përgatitjen e Planit për ushtrimin praktik, që është organizuar në pjesën e dytë të vitit, të emëruar "Zjarri- 2004". Ushtrimi ishte metodik, praktiko-tregues. Ky ushtrim është organizuar dhe zhvilluar në dy faza. Në fazën e parë është realizuar përgatitja teorike e ushtrimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe bartësit e subjekteve gjegjëse, të cilët do të angazhoheshin praktikisht në ushtrim.

Faza e dytë e ushtrimit është zhvilluar në vendin ku do të shkactohej zjarri – incidenti, më konkretisht në lagjen "Dardania", në të cilin territor kanë vepruar konkretisht Shtabi i gatishmërisë emergjente, Shtabi komunal i MC-së dhe E-së, Shtabi i MC-së dhe E-së i Bashkësisë III lokale, BZP-së, SHPK-së, TMK, Enti i Ndihmës së Shpejtë Mjekësore, Kryqi i Kuq komunal, KEK-u, Distribucioni Prishtinë, ujësjellësi rajonal "Prishtina" etj..

Qëllimi i këtij ushtrimi ishte përfshirja dhe trajnimi i të gjitha strukturave gjegjëse dhe Shërbimeve Komunale, me qëllim koordinimi të aktiviteteve, në veçanti nga ky lëmë:

- vlerësimi i punës së SHGE-së lidhur me zbatimin e Planit për GE në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, si dhe angazhimin e subjekteve gjegjëse për reagim emergjent për ndihmë dhe vetndihmë,
- ndarja e përgjegjësive e të gjitha subjekteve të përfshira në ushtrimin metodik, praktiko-tregues "ZJARRI 2004",
- organizimi i punës kolektive të subjekteve gjegjëse, me qëllim koordinimi dhe aftësimi për veprim efikas në raste emergjente.

Ky ushtrim është organizuar edhe për t'ju treguar pjesëmarrësve dhe vëzhguesve se si duhet të veprohet praktikisht në intervenim gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Për të qenë ky ushtrim sa më i suksesshëm dhe efikas, Drejtorati i Mbrojtjes Civile dhe i Emergjencës, me kohë ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, duke filluar nga përpilimi i planit dhe skenarit, si dhe paralajmërimin me kohë të SHGE-së dhe të të gjitha subjekteve komunale, qeveritare dhe jo qeveritare për mënyrën dhe kohën e zhvillimit të këtij ushtrimi.

Në analizën përfundimtare, të cilën e ka udhëheqë vet kryetari i Kuvendit të Komunës, njëherit edhe kryetari i SHGE-së, unanimisht u vlerësuan si mjaftë i suksesshëm dhe ushtrime të tilla duhet organizuar edhe gjatë vitit 2005. Një kopje ia kemi dorëzuar kryetarit të SHGE-së.

Sektori i mbrojtjes civile (bashkëpunëtori për planifikim) në nivel të Drejtoratit, rregullisht përgatit raportin me shkrim lidhur me realizimin e detyrave javore dhe për çdo të hënë ia dorëzon zëvendëskryeshefit të Ekzekutivit. I njëjti rregullisht përgatit programet mujore të punës, i cili shkoqitet nga programi vjetor i punës. Afati i dorëzimit të Programit të punës për muajt paraprak është deri më dt.02, të muajit vijues.

Çdo punëtor, në nivel të Drejtoratit është i obliguar që rregullisht të mbajë planin ditor dhe javor të punës mbi realizimin e detyrave që i merr nga shefi i Sektorit. Është me rëndësi të theksohet në këtë Raport se pjesa dërmuese e punëtorëve të Drejtoratit janë përfshirë në trajnime të ndryshme, e sidomos për përdorimin e intranetit, të cilën e ka organizuar Kuvendi i Komunës, dhe e kanë mbajtur ekspertë të këtij lëmi. Përpos këtij trajnimi për punëtorët tanë, është organizuar trajnim i tillë edhe në Qendrën komunale për informim, alarmim dhe koordinim, të cilin trajnim e kanë mbajtur operatorët e Qendrës me sukses të plotë. Trajnimi në intranet, që e organizoi Komuna, ka zgjatur dy javë dhe ishte mjaftë i suksesshëm. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë kuadrot më të nevojshme në Drejtorat.

Edhe gjatë këtij viti, kujdes i posaçëm i është kushtuar strehimoreve kolektive publike në aftësimin dhe përgatitjen e tyre për paracaktimin që e kanë. Në nivel të Drejtoratit është formuar një komision prej tre anëtarësh, i cili ka dalë disa herë në terren dhe ka bërë incizimin e tyre, ku kanë konstatuar se, për momentin, nuk janë të përdorshme për destinimin që e kanë. Në disa prej tyre zhvillohet biznes privat, edhe përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve, duhet ndërmarr masa për aftësimin e tyre. Edhe pse kemi bërë përpjekje mjaft të mëdha, nuk kemi arritur ta kryejmë me sukses këtë detyrë, prandaj kjo detyrë do të planifikohet për vitin 2005, si detyrë mjaftë e rëndësishme dhe me prioritet.

Në fund mund të konstatojmë se gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2004, janë realizuar edhe shumë detyra dhe aktivitete nga fushëveprimi i Sektorit të mbrojtjes civile, të cilat nuk do të përmenden në këtë raport. Me përgjegjësi konstatojmë se në këtë Sektor ka pas një bashkëpunim të mirë në mes të bashkëpunëtorëve, ku detyrat janë kryer kryesisht në mënyrë ekipore dhe janë realizuar me sukses të lakmueshëm.

III. SEKTORI I EMERGJENCËS

Detyrat dhe aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2004 për Sektorin e emergjencës, i cili numëron 143 punëtorë, janë realizuar përmes bashkëpunëtorëve profesional të lëmejeve të ndryshëm në Shërbimin e emergjencës, inspektorëve të preventivës, Qendrës për informim, alarmim dhe koordinim (në vazhdim QIAK) dhe Brigadës zjarrfikëse (në vazhdim BZP).

Në kuadër të realizimit të aktiviteteve të planifikuara, Sektori i emergjencës ka bashkëpunuar në mënyrë sistematike me Sektorin e sigurisë civile dhe subjektet tjera gjegjëse në komunë dhe jashtë saj, me qëllim të kryerjes sa më efikas të detyrave të parashtruara, në marrjen me kohë të masave preventive dhe ka arritur rezultate të mira në zvogëlimin e dëmeve materiale dhe teknike, të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme gjatë vitit.

Në kuadër të fushëveprimit të Sektorit vepron QIAK-u, e cila aktivitetin e vetë e zhvillon 24 orë pandërprerë, përmes operatorëve, e cila është e pajisur me mjete adekuate për informim, lajmërim dhe (vëzhgim të hyrje-daljes së shërbyesve civil të Komunës dhe të të gjitha palëve, si dhe mban evidencë të saktë për të gjitha lëvizjet në objektin e Komunës). Qendra ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në komunikim të ndërsjellë me subjektet gjegjëse nga ky lëmë, si dhe mban kontakte të përhershme përmes radio lidhjeve me BL-të që gjenden në pjesën rurale të komunës. Gjithashtu, shkëmben informata me SHPK-në, TMK-në, QMF-në, Entin e Mjekësisë Urgjente, Entin Sizmologjik, BZP-në etj.. Roli i QIAK-ut ka qenë shumë pozitiv gjatë ushtrimit teorik të organizuar nga Shtabi komunal i MCE-së, si dhe gjatë zhvillimit të ushtrimit metodik, praktik-tregues “Zjarri 2004”, që është mbajtur nën patronatin e Komitetit për GE të Komunës, i organizuar dhe i udhëhequr nga DMCE-ja dhe SHKMCE-ja. Vlen të ceket se për nevojat e QIAK-së, për të kryer me sukses detyrat nga fushëveprimi i saj, është vendosur repetitori i radiolidhjeve në Golesh, i cili mundëson dëgjueshmëri solide dhe komunikim efikas përmes radiolidhjeve me subjektet gjegjëse.

Gjatë vitit që lamë pas, prioritet për Sektorin e emergjencës ka qenë vlerësimi i rrezikut për komunën tonë, që është punuar pas marrjes së të dhënave të domosdoshme nga drejtoratet tjera komunale dhe subjektet tjera që veprojnë në territorin e komunës, i cili i është ofruar Komitetit për GE, Komitetit për Politik dhe Financa, si dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe pas vërejtjeve – sugjerimeve që i kanë dhënë subjektet e

lartpërmendura, kemi hartuar dokumentin bazë për vlerësim të rrezikut, i cili është miratuar për herë të parë pas lufte, në njërën nga seancat e Kuvendit Komunal, në pjesën e parë të vitit 2004.

Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me Planin për gatishmëri emergjente.

Vlen të theksohet se dokumenti për vlerësim të rrezikut dhe Plani për GE, janë punuar në bazë të të dhënave të konfirmuara nga organet përkatëse dhe mund të konstatojmë se besueshmëria e tyre kalon shkallën e 90%. Është obligim i yni që këto dokumente t'i azhurnojmë, gjithnjë në bazë të të dhënave të reja me të cilat disponojmë.

Njëra prej aktiviteteve të domosdoshme, me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive për zvogëlimin e dëmeve eventuale në raste të fatkeqësive natyrore, apo fatkeqësive tjera, ka qenë edhe koordinimi dhe bashkëpunimi me subjektet gjegjëse, siç janë: TMK-ja, SHPK-ja, UNMIK-un, QMF-ja, Enti i Ndihmës së Shpejtë Emergjente, Kryqi i Kuq, KEK-u, ujësjellësi rajonal "Prishtina" si dhe ndërmarrjet tjera publike. Ky kordinim është kryer përmes kontakteve të drejtpërdrejta të koordinatorit me personat përgjegjës të subjekteve të lartpërmendura, me qëllim të informimit, evidencimit, identifikimit, vlerësimit të nevojave dhe mundësive të MMT-së dhe përpunimit të rasteve eventuale emergjente, që të intervenohet në mënyrë të organizuar për të evituar pasojat e dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e dheut në lagjen "Arbëria", pastrimin e rrugëve në pjesët rurale të komunës nga ortekët e borës, fikjen e zjarreve të shkaktuara në territorin e komunës tonë, si dhe në ato të Fushë Kosovës, Obiliqit, Podujevës, Drenasit etj..

Bashkëpunëtorët e Sektorit të emergjencës kanë qenë bartës të organizimit të ushtrimit metodik, praktikotregues "ZJARRI 2004", që është organizuar dhe mbajtur në muajin shtator, në bashkëpunim me BZP-në, TMK-në, SHPK-në, KEK-un, ujësjellësin rajonal "Prishtina", Kryqin e Kuq, Entin e Ndihmës së Shpejtë Emergjent dhe me Bashkësinë III lokale, që është vlerësuar me notë të lartë nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, të cilët e kanë përcjellë ushtrimin.

Në kuadër të Sektorit të Emergjencës veprojnë edhe inspektorët e preventivës dhe hulumtimit të zjarrit, të cilët, gjatë vitit janë angazhuar në kontrollimin – inspektimin e ndërmarrjeve publike dhe atyre private, të cilave u kanë propozuar masat dhe afatet për mënjanimin e dobësive dhe pajisjen e tyre me mjete adekuate për intervenim në raste të shpërthimit të zjarreve, duke hartuar procesverbalet dhe dërguar subjekteve të kontrolluara. Përqendrimi kryesor i aktivitetit të tyre është bazuar dhe motivuar nga shkalla e rrezikshmërisë prej zjarri.

Gjatë vitit 2004 janë kryer inspektime të rregullta në 244 objekte dhe janë propozuar 1215 masa preventive, dhe ato, të kategorisë së parë 233, të kategorisë së dytë 514, të tretës 340, dhe të katërtës 108 masa.

Gjatë kësaj periudhe janë përpiluar 1234 aktvendime për ndërmarrjen e masave dhe atë, në kategorinë e parë 203, në të dytën 473, në tretën 424, dhe në të katërtën 134 aktvendime.

Janë ndërmarrë 18 veprime për hulumtimin e zjarrit.

Në kuadër të Sektorit është aplikuar kujdestaria 24 orësh për inspektorët e preventivës.

BZP-ja është pjesë përbërëse e Sektorit të emergjencës, e cila është e specializuara dhe e aftësuar për ndërmarrjen e aktiviteteve për lokalizimin dhe fikjen e zjarreve, shpëtimin e njerëzve dhe të të mirave materiale, në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, siç janë: vërshimet, përmytjet nga uji, tërmetet, shembja e dheut dhe fatkeqësitë tjera. BZP-ja, aktivitetin e vetë e zhvillon në tri objekte dhe atë:

1. Baza e BZP-së është në objektin e ujësjellësit rajonal "Prishtina" i cili nuk i plotëson kushtet për punë normale (ngase, pos tjerash na mungojnë edhe garazhet adekuate).

2. Puncti nr. 1, në Kodrën e Trimave, i emërtuar "Prishtina 2".

3. Puncti nr.3, në fshatin Llapla Sellë.

Duhet vepruar që sa më shpejt të ndërtohet objekti i BZP-së në lokacionin e destinuar për këtë qëllim.

Në kuadër të BZP-së janë të punësuar 128 punëtorë, ku, në krahasim me teknikën e vjetruar që ka BZP-ja, deri diku i plotëson nevojat, por kjo nuk do të thotë se në kuadër të

BZP-së nuk ekziston nevoja për të punësuar ende zjarrfikës, e sidomos plotësimin e saj me automjete adekuate për intervenim, duke marrë parasysh numrin e banorëve të kryeqytetit të Kosovës, si dhe numrin e madh të objekteve, që dita ditës shtohet. Me teknikën që posedon BZP-ja, nuk mund të realizojë detyrat e parashtruara në raste të intervenimit, prandaj është e domosdoshme pajisja e saj me mjete adekuate, në mënyrë që t'u dilet në ndihmë qytetarëve në raste rreziku nga fatkeqësitë e ndryshme.

Përkundër vështirësive të cekura më lart, BZP-ja gjithnjë ka qenë në gjendje gatishmërie dhe ka intervenuar, sa herë që ka pas nevojë dhe ka arritur rezultate të lakmueshme në lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve, si dhe evakuimin e qytetarëve të rrezikuar nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera.

Gjatë vitit raportues, pjesëtarët e BZP-së kanë bërë këto intervenime:

- intervenimet për fikjen e zjarrit..... 581,
- intervenimet teknike 140,
- intervenime të rrejshme..... 6,
- numri i zjarrfikësve që kanë marrë pjesë në intervenime4042,
- numri i automjeteve në intervenime1246.

Gjatë intervenimeve të Brigadës së zjarrfikësve në vitin 2004, lëndime serioze ka pasur vetëm te një zjarrfikës, kurse qytetarë të lënduar kanë qenë 51, kurse të vdekur nga qytetarët kanë qenë 5 vetë.

Pasqyra e intervenimeve në Prishtinë dhe komunat tjera fqinje.

- Prishtinë 573,
- Obiliq 27,
- Fushë Kosovë 105,
- Drenas 11,
- Podujevë 10,
- Ferizaj 1.

Gjithsej: 727 intervenime

Vlen të cekët se në periudhën raportuese ka filluar punën punkti "Prishtina 2" në Kodrën e Trimave, që është plotësuar me kuadro adekuate. Për këtë qëllim janë punësuar edhe 11 zjarrfikës dhe dy zëvendëskomandantë të BZP-së.

Edhe përkuadër gatishmërisë e cila ekziston te punëtorët e BZP-së, është evidente mungesa e automjeteve adekuate për intervenime në raste emergjente, prandaj është e domosdoshme sigurimi i tyre gjatë vitit 2005, në mënyrë që të shtohet efikasiteti në punë.

Gjatë vitit 2004, për DMCE janë planifikuar 492.180,00 euro për realizim.

Nga buxheti i planifikuar për DMCE janë realizuar 108.951.53 euro.

Nga shuma e aprovuar për:

- BZP janë aprovuar 250.000,00 euro,
- DMC pa BZP 242.180,00 euro.
- GJITHSEJ: 492.180,00 euro

Nga mjetet e planifikuara gjerë më 1.11.2004 janë realizuar 108.951,53 euro, ose 22.13%.

Vërejtje: Në tremujorin e fundit të këtij viti janë kontraktuar një automjet komandues, dy automjete sulmuese, si dhe veshmbathje për zjarrfikës, në shumë prej 135.275 Euro. Marrë në tërësi, gjatë vitit raportues janë realizuar 244.226.53 euro, ose 49.62%.

Krejt në fund mund të konstatojmë se programi i rregullt i punës së Drejtoratit për vitin 2004 është realizuar me sukses të plotë, duke i marrë parasysh vërejtjet të cilat janë cekur në Raportin e punës.

DREJTORATI I ZHVILLIMIT RURAL

Drejtorati i zhvillim rural, planprogramin për vitin 2004 e ka dorëzuar për aprovim në Komitet për zhvillim rural dhe në Asamblenë komunale. Me ndarjen e mjeteve për Drejtoratin e Zhvillimit Rural, Sektorit për zhvillim rural iu kanë ndarë 640 000,00 €, ndërsa Sektorit për bujqësi 47 162,00 €

Në harmoni me mjetet e ndara për Drejtorat, ju kemi dhënë prioritet projekteve më të rëndësishme. Prioritetet janë dhënë në harmoni me Komitetin për zhvillim rural.

Në periudhën njëvjeçare kemi qenë shumë të angazhuar rreth projekteve, shpalljeve për ofertim të projekteve dhe, varësisht prej kushteve atmosferike, kemi filluar dhe përfunduar me realizimin e projekteve.

SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL

I. Projektet e realizuara:

- Meremetim i rrugës Stallovë-Koliq dhe Grashiticë-Mramor- 2.5 km	24 725,00 €
- Meremetimi i rrugës para Shtëpisë së shëndetit në Bardhosh- 70m	1 200,00
- Asfaltimi i rrugës Suteskë-Mramor - 1.1 km	72 014,00 €
- Meremetimi i rrugës në Lagjen e Spahinjve- 2 000m	23 345,00 €
- Kanalizimi në f. Milevc- 1 664 m	28 484,14 €
- Ujësjiellësi në Tenezhdoll- 2 600m	18 846,80 €
- Riparimi i ujësjiellësit në Shashkovc- 1 140m	9 565,00 €
- Meremetim rruge –Lagjja e Cubollëve – Prapashticë- 600m	5 313,00 €
- Rruga Vidime – Mudri- Potok në fshatin Marevc- 5 900m	126 574,00 €
- Meremetimi i rrugës në Shkabaj- 2 000 m	42 846,00 €
- Kanalizimi fekal dhe ai atmosferik në Hajvali- 5 700m(2700+3000)	350 000,00 €
- Ujësjiellësi në Prugovc- 5 560m	42 051,64 €
- Ura në lagjen e Vërbovcëve –fshati Barilevë- 17m	40 628,00 €
- Ura në fshatin Ballaban- 11m	12 761,21 €
- Rruga Podaj – Dyz- 2 000m	19 745,50 €
- Rruga Ballaban-Orllan (investitor:KFOR-i Suedez dhe KK, Prishtinë)	23 700,00 €
- Ujësjiellësi në fshatin Llukar- 4 900m	68 607,00 €
- Ujësjiellësi në fshatin Prugovc- 5 560m	42 051,64 €
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Barilevë, Lagjja e Llumnicëve- 1 600 m	100 533,00 €
- Sanimi i rrugës Barilevë-Drenovc	9 568,00 €
- Meremetimi i rrugës Kolovicë-Butovc- 6 500 m	27 094,00 €
- Sanimi i rrugës Slivovë-Mukatë	9 200,00 €
- Kanalizimi në fshatin Hajvali- pjesa e dytë	151 031,40 €
- Sanimi i rrugës në fshatin Vranidoll- 400 m	6 693,00 €
- Sanimi i rrugës në fshatin Tenezhdoll- 1 200 m	7 084,00 €
- Mbushja e rrugës para dhe mbas urës në Lagjen e Verbovcëve	8 874,50 €
- Renovimi i rrugës Slivovë-Busi	9 487,50 €
- Ndërtimi i rrugës në Hajvali	9 953,25 €
- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale	17 051,00 €

Gjithsej: 1 272 461,58 €

II. Projektet në procedurë:

- Kanalizimi në fshatin Trudë 48 979,00 €
- Kanalizimi në fshatin Besi 43 055,25 €

III. Projektet të cilat janë dhënë me prioritet nga Ministria e Transportit:

- asfaltimi i rrugës Grashticë- Mramor –investues është Ministria e Transportit,
- asfaltimi i rrugës Sharban- Halabak – investue është Ministria e Transportit,
- asfaltimi i rrugës Besi-Rimanishtë-investues janë KK i Prishtinës, Ministria e Transportit dhe komuniteti.

SEKTORI I BUJQËSISË

Gjatë periudhës raportuese në këtë Sektor janë realizuar këto veprimtari:

- fushat eksperimentale në perimtari ,
- këshillime profesionale dhe fushore,
- projekti emergjent –social, serrat dhe trajnimet,
- ndihma emergjente në farëra të misrit dhe plehra,
- planprogrami për mbjelljet pranverore 2004,
- raporti mbi realizimin e planprogramit për mbjelljet pranverore 2004,
- raporti përfundimtar për dëmet e shkaktuara nga të reshurat,
- raporti përfundimtar për dëmet e shkaktuara nga temperaturat e ulëta,
- rrjedhat e punës në parkun regjional “ Gërmia”,
- kryerja e revizionit të jashtëzakonshëm për dëmet e shkaktuara në parkun regjional “ Gërmia”,
- përcjellja e projektit për mirëmbajtjen e gjelbërimit të qytetit për vitin 2004,
- përcjellja e punëve në procesin e korrje-shirjeve,
- ndihma emergjente me farë gruri dhe plehra minerale,
- planprogrami i mbjelljeve vjeshtore 2004,
- realizimi i projektit për ripyllëzim në Mat,
- përcjellja e fushave eksperimentale me farë gruri dhe misri,
- ndërtimi i stallës për gjedhe në fshatin Stallovë,
- projekti i veterinës mobile.

1. Fushatë eksperimentale në perimtari - 23 508,30 €

Projekti i shpërndarjes së serrave në fshatrat rurale: Besi, Tenezhdoll, Vranidoll, Shkabaj, Bardhosh, Trudë, Bërnice e Ulët, Marevc, Mramor, Thanishtë, Kukaj, Mirak, Barilevë, Drenovc dhe Prugovc.

Shpërndarja është bërë me ndihmën e kryetarëve të fshatrave , komisionit për fshatra, komisionit nga Sektori i bujqësisë dhe Komitetit i zhvillim rural .

Arsyeshmëria e projektit

Arsyeshmëria për realizimin e këtij projekti bazohet në mundësinë e punësimit në kuadër të ekonomive familjare, prodhimtarinë e përhershme të perimeve dhe qarkullimin bujqësor, si masë e një bujqësie intensive.

2. Këshillime profesionale dhe fushore

Me kërkesë të shoqatës së perimtarëve “ Biofruti “ me seli në Besi dhe në bazë të planprogramit të Sektorit të bujqësisë, Sektori i bujqësisë ka organizuar këshillime profesionale dhe fushore në BAC- Besi .

Këto këshillime kanë rrjedhë sipas planprogramit të paraparë.

4. Ndhurma emergjente në farëra të misrit dhe plehra - 4 959,38 €

Projekti i shpërndarjes së farës së misrit dhe plehut artificial në fshatrat rurale: Barilevë, Prugovc, Besi, Tenezhdoll, Vranidoll, Sharban dhe Ballaban, ka përfshi gjithsej 100 familje me nga 10 kg farë misri dhe nga 100 kg plehëra minerale.

Shpërndarja ka përfunduar më datë 18.04.2004.

Shpërndarja është bërë me ndihmën e kryetarëve të B.L.dhe komisionit të formuar nga Drejtorati për Zhvillim Rural.

5. Planprogrami për mbjelljet pranverore 2004

Bazuar në programin e të mbjellurave pranverore 2004, në territorin e komunës së Prishtinës janë planifikuar të mbillen gjithsej 6.455 hektarë me kulltura pranverore, prej të cilave 250 ha në sektorin shtetërorë, ose 3.87% dhe 6.205 ha, ose 96.13% në sektorin privat.

Këto të dhëna janë të marra nga kooperativat bujqësore, organizatat bujqësore, kryetarët dhe referentët e BL-ve dhe barnatoret bujqësore, të cilat gjinden në territorin e komunës së Prishtinës.

Struktura e sipërfaqeve			/ në hektar /			
Kultura	Gjithsej	%	Sekt.shtet.	%	Sekt.privat.	%
Elb pranveror	640	9.90	250	100.00	390	6.30
Tërshërë	305	4.70	-	-	305	4.90
Misër	4.500	69.71	-	-	4.500	72.52
Bimë foragjere	250	3.89	-	-	250	4.03
Perime	760	11.80	-	-	760	12.25
Gjithsej:	6.455	100.00	250	100.00	6.205	100.00

Me misër janë planifikuar të mbillen 4.500 ha, ose 69.71 % të sipërfaqes së përgjithshme me kultura pranverore, kryesisht në sektorin privat.

Sipërfaqja prej 640 ha është planifikuar të mbillet me elb pranveror, ose 9.90 % nga sipërfaqja e përgjithshme për mbjellje, prej tyre 250 ha, ose 9 % në sektorin shtetëror dhe 390 ha, ose 61% në sektorin privat.

Me tërshërë janë planifikuar të mbillen 305 ha, ose 4.70 %, bimë foragjere 250 ha, ose 3.89 % dhe perime 760 ha, ose 11.80 %.

7. Raporti përfundimtar për dëmet e shkaktuara nga të reshurat, më 28.01.2004

Drejtorati i Zhvillimit Rural ka formuar komisionin për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet. Në këtë komision kanë punuar bashkëpunëtorët profesionalë nga Sektori i bujqësisë. Ky komision ka dalë në vendin e ngjarjes, së bashku me kryetarin dhe referentin e BL-së.

Pas vizitave nga terreni, komisioni ka ardhur në përfundim se sipërfaqet e tërësishme, të dëmtuara nga këto vërshime në kultura bujqësore është 24ha.

1. Ballaban----- 10,5 ha
2. Tenezhdoll----- 5,0 ha
3. Vranidoll----- 2,5 ha
4. Prugovc ----- 3,5 ha
5. Sharban ----- 2,5 ha

24,0 ha

1. Raport mbi realizimin e projektit me farë gruri dhe plehra minerale

Projekti “Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale“ është realizuar më 14.10.2004. Shpërndarja është bërë në fshatrat: Keqekollë, Prapashticë, Ballaban, Nishefc,

Dabishefc, Hajkobillë, Glllogovicë, Llukar, Siqevë, Grashticë, Sharban, Mramor, Barilevë, Besi, Rimanishtë, Tenezhdoll, Vranidoll, Thanishtë dhe Marevc.

Janë ndihmuar gjithsej 105 familje, me nga 150 kg farë gruri dhe 150 kg plehra minerale. Shpërndarja është bërë me ndihmën e kryetarëve dhe referentëve të BL-së. Përfituesit nga ky projekt janë të shënuar në listat përcjellëse për 19 fshatra.

Shpërndarja është bërë sipas projektit të paraparë, kështuqë Kuvendi i Komunës së Prishtinës mund të fillojë procedurën e pagesës për këtë projekt.

Vlera e projektit mbërrin shumën 8.426.00 €

2. Planprogrami i mbjelljeve vjeshtore 2004

Komuna e Prishtinës ka sipërfaqe të përgjithshme prej 57.197 ha, me 48 fshatra. Nga kjo sipërfaqe, tokë të punuara janë 19.058 ha, kurse 6.300 ha janë kullosa.

Në vitin 2003-2004, me kultura vjeshtore janë planifikuar të mbjellën 4.555 ha, 3.900 ha në sektorin privat dhe 655 ha në sektorin e kooperativave.

Sektori privat

Kulturat bujqësore	sipërfaqet / ha
Grurë	3.700
Bimë foragjere	200
Total	3.900

Sektori shtetëror (i kooperativave)

Kulturat bujqësore	Koop. Bardhosh	Koop.Llaplasellë
Grurë	70	140
Elb vjeshtor	160	275
Bimë foragjere	...	10
Total	230	425

10. Ndërtimi i shtallës në Stallovë

Qëllimi i ndërtimit të kësaj shtalle ka qenë i karakterit emergjent social, pasi që kemi të bëjmë me një familje me gjendje të rëndë materiale dhe shëndetësore, pasi që 5 nga 9 fëmijët e kësaj familjeje janë të sëmurë mentalisht dhe i vetmi burim i ekzistencës janë bagëtitë që i kanë (4 lopë, 2 viça dhe 10 dele).

Vlera e projektit : 8 988.17 €

11. Realizimi i projektit për pyllëzim në Mat

Gjatë muajit tetor 2004 është realizuar projekti “ Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura “në Mat–Gërmi, në vlerë prej **9 918.75 €**, me pishën e bardhë njëvjeçare (Pinus Silvestris) në sipërfaqe prej 23 000 m².

Në procedurë e sipër është projekti i veterinisë mobile-fushore.

Me këtë projekt është paraparë mbarësimi artificial dhe vaksinimi i 2 108 krerëve lopë. Projekti është njëvjeçar.

Vlera e projektit : 24 186.80 €

Vlera e përgjithshme e projekteve të realizuara në Sektorin e bujqësisë është 79 987,74 €

DREJTORATIT I FINANCAVE DHE I PRONËS

SEKTORI I BUXHETIT

Në pajtim me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendit të punës, puna dhe aktiviteti që e zhvillon ky shërbim do të përmblihet me sa vijon:

- regjistrimi i pagesave dhe faturave nëpërmjet arkës kryesore,
- nënshkrimi i të gjitha pagesave ditore,
- plotësimi dhe pagesa e CPO-ve, janar – dhjetor 2004,
- regjistrimi i të dhënave në Access, xhirollogaria e rregullt 03.01.2004-31.12.2004,
- kontimi xhirollogarisë kryesore, janar-dhjetor 2004,
- regjistrimi i të dhënave në Akces – Prona, 03.01.2004 - 31.12.2004,
- të tjera (shkuarja në MEF, MSHP, Bankë etj),
- regjistrimi i faturave, janar-dhjetor 2004,
- kontimi i të gjitha CPO-ve,
- evidencimi në “Free Balance”, 03.01.2004 –31.12.2004,
- raportet e inkasimit-dorëzimit të kuponëve nga inkasantët,
- kontimi i xhirollogarisë së pronës, janar-dhjetor 2004,
- kontimi i xhirollogarisë së Arsimit dhe çerdheve, janar- dhjetor 2004,
- kontimi i arkës kryesore, janar- dhjetor 2004,
- kontimi i xhirollogarisë së Shëndetësisë, janar- dhjetor 2004,
- kontimi i xhirollogarisë së participimeve të qytetarëve sipas evidencimit të të hyrave, -----
- kontimi i arkës së taksave, janar-dhjetor 2004,
- punë me komisionin për nivelizimin e pagave,
- përgatitja e raportit të shpenzimeve 3, 6, 9, 12 mujor,
- regjistrimi i listës së pagave, janar – dhjetor 2004,
- prezantimi i të dhënave për auditor “ Deloitte & Touche “-2002,
- përpilimi i raportit të të hyrave vetanake janar – dhjetor 2004,
- përpilimi i të hyrave vetanake për vitin 2004 – MEF-it,
- përpilimi i raportit të shpenzimeve për vitin 2004 - MEF-it.
- përpilimi i raportit buxhetor për Arsim dhe Shëndetësi – 2004,
- pagesa e faturave të kompanive të shërbimeve publike për obligimet ndaj Kuvendit të Komunës,
- pagesat e faturave për Drejtoratin e Arsimit,
- përgatitja e projekteve kapitale buxhetore për vitin 2004 – MEF-it,
- regjistrimi i punëtorëve në programin e pagave,
- ofrimi i të dhënave për palën e tretë,
- planifikimi, përgatitja e formularëve për buxhet, mallra dhe shërbime, shpenzime kapitale, subvencione, transfere dhe të tjera sipas kërkesës.

Operimi kompjuterik

Gjatë vitit 2004 janë kryer këto punë sipas planit të këtij viti:

- janë nxjerrë 51269 fatura të tatimit mbi pronën për vitin 2004,
- është bërë regjistrimi i formularëve të pronave-objekteve të reja, 256 raste,
- është marrë raporti për pagesat e tatimit mbi pronën nga bankat komerciale,
- janë regjistruar në kompjuter pagesat e tatimit mbi pronën, të bëra nga tatimpaguesit, 5170 pagesa,
- janë regjistruar të gjitha fletëpagesat e gjobave në komunikacion, 3657 gjoba,
- është bërë përmirësimi në kompjuter i zonave dhe i kategorive tatimore, 236 raste,
- është bërë përmirësimi në kompjuter i adresave (rrugëve), 185 raste.
- janë regjistruar në kompjuter aktvendimet sipas ankesave, 1635 raste.
- është bërë përmirësimi i gabimeve eventuale teknike në faturat e tatimit mbi pronën, 86 raste,
- janë lëshuar 3123 vërtetime për kryerjen e obligimit tatimor,
- puna me palë,
- është bërë regjistrimi i formularëve të pronave-objekteve të reja, 227 raste.

Mbledhja e shënimeve

- është bërë matja dhe regjistrimi i objekteve të paregjistruara gjatë vitit paraprak, 268 raste,
- janë reregjistruar objekte banesore, afariste, industriale dhe garazhe, gjithësejt 48215,
- është bërë kontrollimi i objekteve në terren, në bazë të ankesave të tatimpaguesve, 864 raste.
- puna me palë.

Zyra e shpërndarjes

Në kuadër të këtij shërbimi janë kryer këto shërbime:

- janë përgatitur dhe sistemuar për shpërndarje 51069 fatura tatimore,
- janë shpërndar në teren 50905 fatura tatimore,
- kanë mbetur të pashpërndara edhe 164 fatura në enklava dhe për arsye të problemit me adresa,
- janë shpërndarë 12658 letërkujtesa për tatimin në pronë.

Bordi i ankesave

Në kuadër të këtij Bordi janë kryer këto punë:

- është bërë pranimi i 2220 ankesave nga tatimpaguesit,
- janë shqyrtuar 2220 ankesa dhe janë lëshuar aktvendimet ose janë dërguar komisionet në terren për shqyrtimin e këtyre ankesave, për të cilat ka qenë e nevojshme edhe shikimi i gjendjes,
- është bërë ruajtja dhe arkivimi i ankesave,
- është bërë përcjellja e aktvendimeve për regjistrim në kompjuter.

Shërbimi i transaksionit të pronës

Gjatë vitit 2004, ky Shërbim ka pranuar 2400 lëndë, ku të gjitha lëndët janë kryer në afatin e duhur, prej tyre janë realizuar 2400 lëndë.

Janë arkëtuar 390.250 € kanë mbetur pa arkëtuar 4.800 €

Arka

Është bërë arkëtimi i taksave për transaksionin e pronave, taksave për shfrytëzimin e hapësirës publike (komunale), si dhe i taksave tjera komunale.

Nëpërmes arkës janë inkasuar 427.394 €

Sektori pronësoro – juridik

Ofertat – qarkullimi i paluajtshmërisë

Gjate kësaj periudhe raportuese, këtij Sektori i kanë arritur gjithsej 674 lëndë (oferta për shitjen e tokës urbane, objekteve të banimit, lokaleve afariste, garazheve etj).

Prej tyre, janë vendosur, gjegjësisht janë lëshuar gjithsej 671 vërtetime, me të cilat konfirmohet se Komuna nuk është e interesuar për blerjen e paluajtshmërisë përkatëse, të ofruara me oferta përkatëse. Në procedurë e sipër kanë mbetur, gjithsej 3 lëndë (oferta).

- uzurpime, kërkesa

Gjatë këtij 6-mujori kanë arritur gjithsejtë 166 kërkesa, uzurpime të ndryshme.

Lidhur me identifikimin dhe bisedimin me pronarët e tokave nëpër të cilave kalon ndërtimi i rrugës, sipas projektit përkatës, “Përroi i Zatriqit”, prezanton Shemsi Shala, i cili deklarohej se nuk e kundërshton këtë, por kërkon që t’i bëhet kompensimi i tokës që i merret, me tokë tjetër komunale, përafërsisht të vlerës së njëjtë”.

Për ngastrën që i merret, parashtron provat me shkrim, kontratën mbi Vr.nr.28/98 , dt.06.01.1998, fletën poseduese nr.9480, dt.02.04.1998, kopja e planit dt.09.06.1997, ndërsa nga gjendja e operatit kadastral, sipas flet.posed.nr.9480, dt.01.11.2004 që e siguron gjeodeti i këtij organi, rrjedh se kjo pronë ende evidencohet në emër të Hyrisha Adem Arifit, andaj pas konsultimit të bërë me kryetarin e Komunës, pala udhëzohet që të bën bartjen e kësaj ngastre në emër të vetë në kadastër, ndërsa Komuna do të shikojë mundësinë për gjetjen e pronës, përafërsisht të njëjtë, për t’i bërë kompensim me tokë tjetër.

Procedura është në zhvillim e sipër.

- kërkesat për arkivë

Sipas kërkesave të palëve, nga arkivi është gjetur dokumentacioni i kërkuar për palët: Ramadan Pllana, Shemsi Haxhillari dhe Halit Vokri, janë bërë përgjigjet me shkrim dhe janë dorëzuar për nënshkrim. Gani Berisha kont.mbi shit-blerjen e banesës.

Regjistrimi i lëndëve është në vijim e sipër.

Raporti i buxhetit për vitin 2004

PËRMBAJTJA

I- Realizimi i buxhetit 01 Janar – 31 Dhjetor 2004;

I-a Lista e projekteve kaiptale të zotuarra për vitin 2004;

I-b Shqyrtimet buxhetore për Mallra dhe Shërbime;

I-c Projektet buxhetore sipas drejtorateve – shpenzimet kapitale;

II Arkëtimi i burimeve vetijake;

II-a Pjesëmarrja e arkëtitimit të të hyrave vetijake sipas drejtorateve;

III Paraqitja tabelare dhe grafike e planifikimit-arkëtitimit të të hyrave vetijake për vitin 2004.

	Pozicionet buxhetore	Propozim buxheti 2004				Realizimi 31.12.2004	Përqindja e realizimit
		Grantet	Buri. vetijake	Prerja Buxhet.	Totali		
		10,307,346.00	5,568,140.00	-	15,875,486.00	13,358,688.14	84.15
	1	2	3	4	5=2+3+4	6	7
I	SHPENZIMET E PERSONELIT	2,985,166.00	310,000.00		3,295,166.00	3,131,386.30	
	I - a Pagat dhe udhëtimet zyrtare	1,798,999.00	-		1,798,999.00	1,700,564.37	94.53
	Nr i punëtorëve				-		
1	Pagat	1,378,133.00		20,000.00	1,398,133.00	1,397,072.11	
2	Pagat (per punetoret e Graqanices financuar nga MEF)	75,572.00			75,572.00	62,772.15	
3	Pagat - Sherbimi i Zjarrfiksave	295,294.00			295,294.00	210,984.90	
4	Tatimet dhe kontributet				-		
5	Udhëtimet zyrtare	50,000.00		- 20,000.00	30,000.00	29,735.21	
					-		
	I - b Shpenzimet materiale	215,000.00	10,000.00	90,000.00	315,000.00	306,754.09	97.38
6	Material per zyre	130,000.00		- 45,000.00	85,000.00	81,342.03	
7	Material tjeter	45,000.00		105,000.00	150,000.00	147,563.64	
8	Inventar i imët	40,000.00	10,000.00	30,000.00	80,000.00	77,848.42	
					-		
	I - c Paimet	310,000.00	300,000.00	- 285,000.00	325,000.00	309,391.56	95.20
9	Mobile per zyre	100,000.00		- 95,000.00	5,000.00	1,783.00	
10	Kompjuter printer dhe UPS	50,000.00		45,000.00	95,000.00	93,092.84	
11	Aparate per fotokopje	10,000.00			10,000.00	8,768.75	
12	Vetura		300,000.00	- 235,000.00	65,000.00	60,431.40	
13	Blerje tjera kapitale	100,000.00		- 20,000.00	80,000.00	78,079.81	
14	Servisimet kapitale	50,000.00		20,000.00	70,000.00	67,235.76	
					-		
	I - d Shpenzimet komunale	160,000.00	-	-	160,000.00	142,965.11	89.35
15	Energjia elektrike	50,000.00		- 10,000.00	40,000.00	38,205.82	
16	Nxemja qendrore	20,000.00		- 15,000.00	5,000.00	814.40	
17	Uji dhe nyjet sanitare	20,000.00		5,000.00	25,000.00	22,815.27	
18	Mbledhja e mbeturinave	15,000.00			15,000.00	11,540.94	
19	Telefonat fiks	25,000.00		10,000.00	35,000.00	34,256.77	
20	Telefonat mobil	25,000.00		7,000.00	32,000.00	30,056.11	
21	Kartelet e telefonisë mobile	5,000.00		3,000.00	8,000.00	5,275.80	
					-		
	I - e Parku i veturave	100,000.00	-	- 45,000.00	55,000.00	42,879.48	77.96
22	Nafta dhe benzina	50,000.00		- 35,000.00	15,000.00	10,739.09	
23	Autogomat	10,000.00		- 5,000.00	5,000.00	1,742.00	
24	Servisimet e veturave	10,000.00		15,000.00	25,000.00	23,792.19	
25	Shpenzime te tjera per vetura	30,000.00		- 20,000.00	10,000.00	6,606.20	
					-		
	I - f Shërbimet e përgjithshme	401,167.00	-	240,000.00	641,167.00	628,831.69	98.08
26	Kompenzimi antarëve te Asambles	35,000.00			35,000.00	30,359.27	
27	Kompenzimi antarëve te komiteteteve	60,000.00		5,000.00	65,000.00	62,431.25	
28	Pjesa e mjeteve vetanake per paga	30,000.00		- 12,000.00	18,000.00	15,418.05	
29	Sherbimet kontraktuese	150,000.00		160,000.00	310,000.00	309,862.24	
30	Sherbimet e internetit	5,000.00		10,000.00	15,000.00	13,362.38	

	31	Shpallje dhe konkurse	21,167.00		26,000.00	47,167.00	46,933.50	
	32	Shërbime tjera	100,000.00		51,000.00	151,000.00	150,465.00	
						-		
II		SHËRBIMET PUBLIKE	1,620,000.00	-	-	1,620,000.00	1,358,449.26	83.85
	33	Ndriqimi publik	150,000.00		290,000.00	440,000.00	438,067.89	
	34	Mirembajtja e siperfaqeve gjelbruese	200,000.00		40,000.00	160,000.00	154,063.66	
	35	Mirëmbajtja dimerore e rrugëve	50,000.00		20,000.00	70,000.00	63,011.60	
	36	Pastrimi dhe larja e rrugëve	300,000.00			300,000.00	222,620.97	
	37	Shenjëzimi vertikal dhe horizontal	200,000.00		180,000.00	20,000.00	18,699.98	
	38	Mirembajtja e semaforëve	140,000.00			140,000.00	138,360.25	
	39	Pastrimi dhe mirembajtja e grillave dhe pusetave	200,000.00		30,000.00	170,000.00	42,832.40	
	40	Fontana publike, krojeve dhe toaleteve publike	70,000.00		70,000.00	-		
	41	Dekorimi i qytetit për festa	50,000.00		40,000.00	10,000.00	250.00	
	42	Sanimi dhe mirembajtja e ndriçimit publike	200,000.00		50,000.00	250,000.00	244,294.51	
	43	Pastrimi dhe mirembajtja e portave (hyrese dhe dalese) Lumenjeve Prishtina - Vellusha	60,000.00			60,000.00	36,248.00	
III		PROJEKTET SIPAS DREJTORATEVE	4,807,180.00	5,258,140.00	- 180,000.00	9,885,320.00	8,224,177.82	83.20
III - a		ADMINISTRATA E PËRGJITHSHME	-	100,000.00	-	100,000.00	39,007.50	39.01
	44	Riparimet ne bashksi lokale		100,000.00		100,000.00	39,007.50	
						-		
III - b		Drejtorati për SHËRBIME PUBLIKE	1,515,000.00	3,000,000.00	-	4,515,000.00	3,675,064.46	81.40
	45	Ndertimi i rrugëve dhe trotuareve	695,000.00	3,000,000.00	240,000.00	3,455,000.00	3,049,482.80	
	46	Sanimi i gropave	70,000.00		240,000.00	310,000.00	305,597.19	
	47	Ndertimi i kanalizimeve fekale	400,000.00			400,000.00	319,984.47	
	48	Mbikalimet e rrugëve për kembësor	100,000.00			100,000.00		
	49	Stacionet periferike urbane	200,000.00			200,000.00		
	50	Blerja e paisjeve për pagesë të parkingjeve	50,000.00			50,000.00		
						-		
III - c		INSPEKSIONI	-	130,000.00	-	130,000.00	25,547.75	19.65
	51	Rrënim i ndërtesave ilegale		100,000.00		100,000.00	16,886.00	
	52	Transporti i kiosqeve		30,000.00		30,000.00	8,661.75	
III - d		ZHVILLIMI RURAL	560,000.00	127,162.00	150,000.00	837,162.00	829,781.25	99.12
	53	Mirembajtja dhe renovimi i rrugëve rurale dhe pastr.hap.rreth liqejev	180,000.00		40,000.00	140,000.00	138,865.53	
	54	Ndertimi i rrugëve rurale		60,000.00	80,000.00	140,000.00	139,062.74	
	55	Rregullimi i kanalizimit në vise rurale	105,000.00		100,000.00	205,000.00	202,078.44	
	56	Ndertimi dhe rregullimi i urave në vise rurale		55,000.00		55,000.00	51,115.75	
	57	Kanalizimi fekal dhe atmosferik në Ajvali	240,000.00		2,000.00	242,000.00	241,734.40	
	58	Projekti për Perimtari	15,000.00	10,000.00	3,000.00	28,000.00	28,468.14	
	59	Projekti: Veterina fushore dhe vaksionimi i baktive	20,000.00	2,162.00	5,000.00	27,162.00	28,456.25	
						-		
III - e		ARSIMI	1,150,000.00	200,000.00	650,000.00	2,000,000.00	1,983,978.07	99.20
	60	Riparimi i ndërtesave shkollore	950,000.00		160,000.00	1,110,000.00	1,105,592.78	

61	Inventar dhe mjete konkretizuese per shkolla	100,000.00	100,000.00	315,000.00	515,000.00	512,080.90	
62	Bartja e nxënësve të klas. të- IX - ta - Fshat - Qytet.	100,000.00		225,000.00	325,000.00	322,804.39	
63	Bursa per student		100,000.00	- 50,000.00	50,000.00	43,500.00	
					-		
III - f	KULTURË DHE SPORT	460,000.00	-	-	460,000.00	394,339.14	85.73
64	Manifestimet kulturore	160,000.00			160,000.00	145,010.44	
65	Klubet sportive	100,000.00			100,000.00	86,936.60	
66	Projekte per rini dhe gjini	200,000.00			200,000.00	162,392.10	
					-		
III - g	SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE	560,000.00	-	150,000.00	710,000.00	664,689.93	93.62
67	Dezinsektimi	100,000.00			100,000.00	99,475.00	
68	Deratizimi i rrjetit të kanalizimit	50,000.00			50,000.00	47,437.50	
69	Ndertimi i ambulancave ne viset lokale	360,000.00		150,000.00	510,000.00	503,814.43	
70	Fondi per raste te renda	50,000.00			50,000.00	13,963.00	
III - h	KATASTR DHE PLANIFIKIM	-	1,000,000.00	- 500,000.00	500,000.00	447,454.87	89.49
71	Planifikimi gjeneral i qytetit		1,000,000.00	- 500,000.00	500,000.00	447,454.87	
III - i	EMERGJENCA	492,180.00	-	-	492,180.00	159,018.85	32.31
72	Formimi-Paisja dhe trajnimi i SHMC dhe njesive	54,200.00			54,200.00	23,279.20	
73	Paisja e 'QIAK' dhe punktite te zjarfikseve	91,821.00			91,821.00	43,173.55	
74	Paisja dhe trajnimi i 19 BL - Organiz. Punuese	96,159.00			96,159.00	1,460.00	
75	Sherbmi i zjarfiksave	250,000.00			250,000.00	91,106.10	
III - j	EKONOMIA	70,000.00	-	-	70,000.00	5,296.00	7.57
76	Promovimi i planit strategjik KK Prishtine	10,000.00			10,000.00		
77	Formimi i asoc. Komutit . Te biznesit K Prishtine	10,000.00			10,000.00	5,296.00	
78	Krijimi i nje qendre per inkubator biznesi	50,000.00			50,000.00		
III - k	FINANCA DHE PRONË	-	700,978.00	- 630,000.00	70,978.00	0.00	0.00
79	Projekti tatimit ne prone		700,978.00	- 630,000.00	70,978.00	0.00	
IV	DUKURIT NEGATIVE - NATYRORE	400,000.00	-	-	400,000.00	0.00	0.00
80	Per mbrojtjen e efekteve negative natyrore	400,000.00			400,000.00	0.00	
V	MINORITETET	495,000.00	-	180,000.00	675,000.00	644,674.76	95.51
81	Shpenzimet per zyren e Graqanices (financohet nga MEF)	100,000.00			100,000.00	73,048.49	
82	Shpenzimet per projektet e minoriteteve	395,000.00		180,000.00	575,000.00	571,626.27	
T O A L I		10,307,346.00	5,568,140.00		15,875,486.00	13,358,688.14	84.15

LISTA E PROJEKTEVE TË ZOTIMEVE - 2004

KK
Prishtinë

€ €

Nr Ren.	Pëshkrimi I Projektit	Kodi Buxhetor	Shuma e zotimit	Shuma e paguar	Shuma e mbetur	Vërejtje
I	SHERBIMET PUBLIKE					
1	Pastrimi I rrugëve gjatë dimrit	61610	150,000.00	35,871.25	114,128.75	2004 bartur
2	Furnizimi me kryp dhe zhavor	61610	40,000.00	-	40,000.00	2004 bartur
3	Rindërtimi I rrugës së "Vushtrisë"	61610	366,355.57	306,770.38	59,585.19	2004 bartur
4	Rindërtimi I rrugës së "Caralevës"	61610	385,022.70	113,148.47	271,874.23	2004 bartur
5	Ndërtimi I rrugëve "E.D." dhe "R.H."	61610	58,599.60	56,097.61	2,501.99	2004
6	Rindërtimi I rrugëve "I.F" dhe "V.F"	61610	61,945.00	41,727.75	20,217.25	2004
7	Ndërtimi I ujësjellësit në rrugët "M.K" "E.H" "XH.K"	61610	162,596.21	89,820.00	72,776.21	2004
8	Rindërtimi I rrugëve "R.B" dhe "XH.H"	61610	272,002.74	189,525.91	82,476.83	2004
9	Rindërtimi I rrugës "Idriz Gjilani"	61610	87,542.75	81,409.11	6,133.64	2004
10	Mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbruese të Prishtinës	61610	38,939.00	32,545.00	6,394.00	2004
11	Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve të Prishtinës	61610	109,014.51	88,440.30	20,574.21	2004
12	Riparimi I rrugëve "Drenica-Llapi" dhe "27 Nëntori"	61610	10,861.38	7,173.13	3,688.25	2004
13	Rindërtimi I rrugëve "XH.E" dhe rruga lidhëse "27 Nëntori"	61610	17,220.96	13,767.80	3,453.16	2004
14	Ndërtimi I rrjetit të ujësjellësit në Sofali	61610	192,170.48	-	192,170.48	2004
15	Punët shtesë rruga "Muharem Fejza"	61610	22,944.80	-	22,944.80	2004
16	Mirëmbajtje - kapitale	61610	47,685.36	-	47,685.36	2004
17	Ndërtimi I rrugëve - kapitale	61610	34,439.75	-	34,439.75	2004
18	Kanalizimi atmosferik	61610	47,110.74	34,525.77	12,584.97	2004
19	Pastrimi I grilave	61610	100,000.00	-	100,000.00	2004
20	Ndërtimi I rrugëve	61610	58,599.60	56,097.61	2,501.99	2004
21	Segmenti I rrugës "Xhavit Ahmeti"	61610	237,984.31	-	237,984.31	2004
22	Ndriqimi publik I rrugës "Haxhi Zeka"	61610	217,338.50	104,420.00	112,918.50	2004
23	Ndërtim I rrugës "Haxhi Zeka"	61610	572,348.00	175,946.88	396,401.12	2004
24	Rindërtimi I rrugës "A.Krasniqi"	61610	186,053.65	109,002.52	77,051.13	2004
25	Rregullimi I sipërfaqeve gjelbruese "EM", "SHR" dhe "RS"	61610	40,825.75	21,517.83	19,307.92	2004
26	Ndërtimi I rrugës "M.Ratkoceri"	61610	115,257.36	65,642.13	49,615.23	2004
27	Mirëmbajtja rutinore e rrugëve	61610	150,000.00	118,586.98	31,413.02	2004
28	Ndërtimi I rrugës "A.Krasniqi"	61610	195,547.20	157,241.36	38,305.84	2004
29	Rindërtimi I rrugëve "APT" dhe "GZ"	61610	223,157.67	158,789.18	64,368.49	2004
30	Ndriqimi publik I rrugëve "APT", "GZ", "MB" dhe "XHH"	61610	88,550.00	57,559.80	30,990.20	2004
31	Ndërtimi I rrugëve	61610	5,560.25	-	5,560.25	2004
32	Shenjëzimi I rrugëve	61610	179,825.50	-	179,825.50	2004
33	Mirëmbajtje e rrugëve - kapitale	61610	71,171.24	-	71,171.24	2004
34	Mirëmbajtja e rrugëve	61610	17,051.05	-	17,051.05	2004
35	Ndërtimi I segmentit rrugor	61610	65,329.03	27,310.89	38,018.14	2004
	T O T A L I		4,629,050.66	2,142,937.66	2,486,113.00	
II	ZHVILLIMI RURAL	Kodi Buxhetor	Shuma e zotimit	Shuma e paguar	Shuma e mbetur	Vërejtje
1	Mirëmbajtja dimrore e rrugëve	61610	30,000.00	-	30,000.00	2004
2	Ndërtimi I rrjetit të ujësjellësit në Llukar	61610	68,607.00	-	68,607.00	2004
3	Ndërtimi I rrjetit të kanalizimit në Hajvali	61610	355,520.80	294,749.98	60,770.82	2004
4	Ndërtimi I kanalizimit fekal në Busi	61610	43,055.00	24,937.75	18,117.25	2004
5	Ndërtimi I rrjetit të ujësjellësit në Prugovc	61610	42,051.64	29,428.10	12,623.54	2004
6	Projekt ideor - veterina fushore	61610	24,186.80	10,695.25	13,491.55	2004

7	Ndërtimi I kanalizimit fekal në Trudë	61610	48,979.00	29,387.40	19,591.60	2004
8	Zhavor për rrugën Ballaban - Orllan	61610	23,700.00	22,750.13	949.87	2004
9	Punët shtesë -kanalizimi fekal në Hajvali	61610	33,808.62	-	33,808.62	2004
10	Ndërtimi I urës Barilevë-Lagjja e Verbocve	61610	40,628.43	37,597.00	3,031.43	2004
11	Asfaltimi I rrugës - Lagjja e Llumnicëve	61610	100,533.00	90,479.70	10,053.30	2004
	T O T A L I		811,070.29	540,025.31	271,044.98	
III	SHENDETESIA	Kodi Buxhetor	Shuma e zotimit	Shuma e paguar	Shuma e mbetur	Vërejtje
1	Rrethoja e QMF në Mat	61610	45,950.25	29,764.25	16,186.00	2004
2	Ndërtimi I QMF	61610	32,990.00	-	32,990.00	2004
	T O T A L I		78,940.25	29,764.25	49,176.00	
IV	ARSIMI	Kodi Buxhetor	Shuma e zotimit	Shuma e paguar	Shuma e mbetur	Vërejtje
1	Ndërtimi I shkollës në Mat	61610	249,552.00	231,485.55	18,066.45	2004
	T O T A L I		249,552.00	231,485.55	18,066.45	
VII	ZJARFIKSAT	Kodi Buxhetor	Shuma e zotimit	Shuma e paguar	Shuma e mbetur	Vërejtje
1	Automjetet Sulmuese	61670	71,330.00	-	71,330.00	2004
	T O T A L I		71,330.00	-	71,330.00	
VIII	GRAQANICA	Kodi Buxhetor	Shuma e zotimit	Shuma e paguar	Shuma e mbetur	Vërejtje
1	Ndërtimi I rrugës Sushicë - Janjevë	61610	70,000.00	-	70,000.00	2004
	T O T A L I		70,000.00	-	70,000.00	
G J I T H S E J T			5,909,943	2,944,213	2,965,730	

Vërejtje: Ndryshimi i gjendjës së realizimit në mes zotimit nga alokimi i mjeteve nga gjrobat në trafik .

Në mbështetje të dispozitave të nenit 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45 për vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, të Statutit të Komunës së Prishtinës dhe të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, Kuvendi Komunal i Prishtinës, gjegjësisht Drejtorati për Financa dhe Pronë, paraqet :

BUXHETIN PERMBYLLËS PËR VITIN 2004

Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2004 pasqyron zhvillimin që ka arritur Kuvendi Komunal i Prishtinës, që përbëhet kryesisht nga shpenzimet e operimit – për mallra dhe shërbime dhe shpenzime kapitale – infrastrukturë. Për vitin 2004, buxheti i përgjithshëm i KK Prishtinë ka qenë 15,875,486 euro, duke përfaqësuar një rritje për 15% nga buxheti i vitit 2003.

BAZA BUXHETORE

NDARJA	2003	2004
Granti	9,713,332	10,307,346
Burimet vetijake	4,075,003	5,568,140
T O T A L I	13,788,335	15,875,486

Trendet kryesore që duhet të përmenden janë:

Shpenzimi i përgjithshëm i buxhetit për vitin fiskal 2004 është 84 %. Në bazë të tabelës buxhetore, realizimi i buxhetit përbëhet nga kategorit: Paga dhe Mëditje, Mallra e Shërbime dhe Shpenzime Kapitale.

Komuna e Prishtinës të punësuar ka 4912 punëtorë, ku duhet theksuar se këtu janë përfshir edhe punëtorët e buxhetit sektorial si (Arsimi: parashkollor,fillor dhe i mesëm;

Shëndetësia: Qendra e mjeksisë familjare dhe Enti i mjeksisë urgjente; Zjarrfiksat dhe Zyra lokale e komuniteteve).

I-a Pagat dhe udhëtimet zyrtare

Administrata e përgjithshme komunale nga planifikimi i buxhetit për vitin 2004 në kategorin e pagave, buxheti është realizuar 95 %, ndërsa në vitin 2003 realizimi i buxhetit ka qenë 85%. Ndërkaq pas shqyrtimit buxhetor rritet vlera totale e pagave për 40% , pasi që planifikimi nuk e mbulon realizimin. Prandaj, te pozicioni për udhëtime zyrtare, nga ndryshimi i të dhënave është rezultuar me ndrrimin e gjendjes nga pozicioni i mëditjeve në ate të pagave.

I-b Shpenzimet materiale

Në pozicionin për shpenzime materiale ndryshime ka pësuar në numerin rendor 6, *material për zyre* që është zvogluar për 35%, ku kjo shumë është shpërndarë në pozicionin numer 7 dhe 8 *material tjetër dhe inventar i imët*. Pra, në pozicionin e tërësishëm nga planifikimi, është realizuar 97% e buxhetit për vitin 2004.

Shikuar nga tabela e ndarjes dhe planifikimit buxhetore vërehet se rreth 1% e mjeteve vjen nga të hyrat vetijake, ndërsa 2% grant nga niveli qendror.

I-c Pajimet

Meqenëse paimet kanë të bëjnë me praktikën e punës, e sidomos paisjet kompjuterike të cilat për nga renditja në peshoj kanë tërhequr më së shumti shpenzime. Në vijim në kuadër të shpenzimeve normale për paimet kanë mbetur, pozicionet: (*aparartet për fotokopje, blerjet tjera kapitale dhe servisimet kapitale*). Ku realizimi i buxhetit në vitin 2004 është realizuar 95% . Ndërsa përpjestimi i ndarjes së planifikimit të buxhetit ka rezultuar me 3% mjete nga granti qendror, ndërkaq nga të hyrat vetijake 5%.

I-d Shpenzimet komunale

Në fushën në vijim tek shpenzimet komunale me rishikim buxhetor janë bërë ca ndryshime të vogla në zërat e brendshëm buxhetor, që d.m.th se totali i shpenzimeve komunal ka qenë në nivel të planifikimit krahasuar me realizimin. Në vitin 2004 realizimi ishte në suaza normale 89%. Pra, pjesëmarrja në buxhet për komunalit është rreth 2% nga totali i grantit.

I-e Parku i veturave

Gjithashtu edhe parku i veturave sikurse edhe komunalit, kanë pësuar ndryshime në zvoglimin e planifikimit të buxhetit, ku realizimi ishte më i vogël se planifikimi. Prandaj, nga shumta e tërësishme e planifikimit të buxhetit për parkun e veturave, shpenzime të realizuara janë 78%. Pozicioni i parkut për vetura, pjesëmarrjen në buxhet e ka të ndarë nga granti rreth 1%.

I-f Shërbimet e përgjithshme

Tek shërbimet e përgjithshme është bërë ndryshim – rritje e mjeteve buxhetore. Duke u bazuar në zërat buxhetor e sidomos pozicioni shërbime kontraktuese është rritur-tejkaluar mbi qindpërqind krahasuar me planifikimin, gjithashtu edhe shërbimet tjera kanë pësuar rritje për 51%. Marrë në përgjithësi realizimi i buxhetit tek shërbimet e përgjithshme për vitin 2004 është 98%. Ndërkaq shërbimet e përgjithshme nga planifikimi i ndarjes së buxhetit, pjesëmarrjen në buxhet e kanë të ndarë nga granti rreth 4%.

II – Shërbimet publike (administratë e përgjithshme)

Meqenëse shërbimet publike të cilat janë në kuadër të kategorisë për Mallra e Shërbime, është ndryshuar struktura mes planifikimit dhe realizimit, ku siq shihet në tabelën e realizimit të buxhetit, më së shumti ka ndryshuar pozicioni buxhetor – *ndriqimi publik*, d.m.th. është rritur për 1.9 herë apo 93% e mjeteve buxhetore. Ndërsa në të kundërtën në zërin buxhetor - *shenjëzimi vertikal dhe horizontal*, është bërë zvoglimi i pozicionit buxhetor për 90%. Këto dy pozicione me ndryshime të kundërta janë bërë kryesisht duke u bazuar në planifikim dhe realizim të buxhetit deri në fund të vitit kalendarik 2004. Analizuar realizimin e buxhetit , del se realizimi për vitin 2004 është 84%.

Nga i gjithë planifikimi buxhetor, i vetmi pozicion që ka mbetur pa u shfrytëzuar për shkaqe të ndryshme objektive, është – *fontana publike, kroje dhe toaleta publike*, prandaj mjetet e planifikuar

për këtë zër buxhetor kanë kaluar në pozicionet brenda për brenda pozicioneve buxhetor. Nga totali i grantit për planifikim të buxhetit, për shërbimet publike janë ndarë 16% e mjeteve buxhetore. Prandaj, nga kjo mund të konkludojm se viti 2004 ka pasur një shtytje më të madhe për realizimin e projekteve, të cilat janë me karakter zhvillimor dhe shërbime të tjera në infrastrukturë.

PJESËMARRJA E DREJTORATEVE NË SHPENZIME KAPITALE

III – PROJEKTET SIPAS DREJTORATEVE

Përbërja:

1. Drejtorati i Administratës së Përgjithshme komunale;
2. Drejtorati i Shërbimeve Publike-(DMASHPT);
3. Drejtorati i Inspektionit;
4. Drejtorati i Zhvillimit Rural;
5. Drejtorati i Arsimit;
6. Drejtorati i Kulturës dhe Sportit;
7. Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale;
8. Drejtorati i Kadastërit dhe i Planifikimit;
9. Drejtorati për Emergjencë, Alarmin dhe Siguri;
10. Drejtorati i Ekonomisë;
11. Drejtorati i Financave dhe i Pronës dhe
12. Zyra lokale e komuniteteve.

Në këtë përbërje janë përfshirë drejtoratet sipas ndarjës buxhetore tabelare për vitin 2004.

III- a Administrata e Përgjithshme komunale

Për vitin 2004, administrata e përgjithshme, pjesëmarrjen në buxhet e ka realizuar përmes projektit – *riparimet në bashkësit lokale*, ku nga përqindja e planifikimit është realizuar vetem 39% e mjeteve buxhetore. Pra, ka një rritje nga viti i kaluar dhe vazhdohet me kontinuitet për realizimin e projekteve infrastrukturore.

III b- Drejtorati i Shërbimeve publike

Nga planifikimi i ndarjes buxhetore, drejtorati i shërbimeve publike disponon me më së shumti buxhet, sa i përket ndarjes buxhetore sipas granteve në drejtorate. Ndryshim kanë pësuar pozicionet buxhetore – *ndërtimi i rrugëve dhe trotuarve dhe sanimi i gropave*, të cilat kanë ardhë në pikën plus - minus ndryshim gjendje. Në kontekst të kësaj duhet theksuar se projektet si : *mbikalimet e rrugëve për këmbësor, stacionet periferike urbane dhe blerja e paisjeve për pagesë të parkingjeve*, nuk janë realizuar për shkaqe të ndryshme teknike. Në vitin 2004 shihet se realizimi i buxhetit nga ky drejtorat është 81%, e që ka një ndryshim të dukshëm nga viti i kaluar.

III-c Drejtorati i Inspektionit

Eshtë një ndër drejtoratet që kërkon një bashkëpunim mes gjithë drejtorateve, dhe një koordinim të punëve që më realizimin e detyrave do të vije deri te realizimi i projekteve

buxhetore. Ndarja e planifikimit të buxhetit për inspektionin plotësisht vije nga të hyrat vetijake, e që është mbi 2%. Pra, në vitin 2004 buxheti është realizuar 20%.

III-d Drejtorati i Zhvillimit Rural

Në bazë të planifikimit të buxhetit, për drejtoratin e zhvillimit rural janë ndarë nga granti 5% e mjeteve buxhetore, kurse nga të hyrat vetijake mbi 2%. Marrë në përgjithësi realizimi i buxhetit për këtë drejtorat është thujse qindpërqind, ndërsa krahasuar me vitin paraprak dukshëm ka krijuar rritje. Duhet theksuar se, realizimi i buxhetit të drejtoratit të zhvillimit rural për vitin 2004 është mbi 99%.

III-e Drejtorati i Arsimit

Duhet theksuar se KK Prishtinë, e mbanë përgjegjësin për mbulimin e shpenzimeve kapitale, që ndahen nga buxheti komunale – granti qeveritar. Edhe përkundër kësaj, drejtorati i arsimit ka pasur vështirësi në kategorin për mallra e shërbime, gjegjësisht në ato të pagave, ku është dashur të ndihmohet me mjete tjera shtesë nga administrate e përgjithshme komunale. Kjo ka rrjedh si munges e pamjaftueshme e grantit qeveritar.

Nga granti buxhetor i komunës, për drejtoratin e arsimit në kategorin e shpenzimeve kapitale janë ndarë 11% e mjeteve buxhetore. Inkasimi i të hyrave vetijake në këtë drejtorat janë paraparë rreth 1% për nevoja të ndryshme shkollore. Duke analizuar realizimin e buxhetit të vitit 2004 – (99%), lë për të kuptuar shpenzimin buxhetor në kuptimin normale. Për të bërë këtë balancim të shpenzimeve buxhetore është dashur të rishikohen pozicionet brenda buxhetore .

III- f Drejtorati i Kulturës dhe i Sportit

Për drejtoratin për kulturë dhe sport duhet theksuar se i gjithë shpenzimi buxhetor vije nga granti, që në ndarjen e planifikimit të buxhetit i janë ndarë 4% e mjeteve buxhetore. Shikuar, nga të dhënat në vitin 2004, realizimi i buxhetit është 86%. Pra, nga kjo vërehet se nga viti në vit është një synim më i madhë për realizimin e projekteve buxhetore.

III-g Drejtorati i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale

Gjithashtu sikurse për shpenzimet kapitale në drejtoratin e arsimit, edhe në drejtoratin e shëndetësisë, komuna e mban përgjegjësin e ndarjes së buxhetit për shpenzime kapitale. Kjo formë e ndarjes është rregulluar në bazë të udhëzimit administrative të UNMIK-ut, që në buxhetet sektoriale komuna ti mbuloj shpenzimet kapitale. Këtë obligim Komuna e Prishtinës e ka përfillur qysh me ndarjen e buxhetit për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, që është konfirmuar nga drejtoratet përkatëse. Nëse shiqojm tabelën e ndarjes dhe realizimin e buxhetit, vërehet se 5% e mjeteve janë ndarë nga granti i komunës. Pra, realizimi i buxhetit në vitin 2004 është 94%.

III-h Drejtorati i Kadastrit dhe i Planifikimit

Me arritjen e miratimit të planit rregullativ për kryeqytetin nga KK Prishtinë, në këtë kontekst janë bërë shpenzime për përgaditjen e planeve rregullative për kryeqytetin. Mjetet e parapara për pozicionin buxhetor *planifikimi gjeneral i qytetit* janë tërësisht nga të hyrat vetijake, rreth 18%. Nga ndryshimi i buxhetit mjetet buxhetore janë shpërndarë nëpër pozicione të ndryshme buxhetore. Në fund të vitit realizimi i buxhetit nga ky drejtorat është realizuar 89%.

III- i Drejtorati i Emergjencës

Pjesëmarrja në planifikimin e ndarjes së buxhetit nga ky drejtorat ka qenë 5% e mjeteve buxhetore nga granti komunal. Kurse, realizimi i shpenzime buxhetore deri në fund të vitit ka

qenë 32%, me një fjalë i gjithë realizimi i buxhetit varet nga projektet buxhetore të financuara nga granti .

III-j Drejtorati i Ekonomisë

Sa i përketë ndarjes buxhetore, shuma e tërësishme përbëhet nga granti komunal rreth 1%. Gjykuar nga shpenzimet buxhetore, të realizuara janë 8% e mejteve buxhetore.

III-k Drejtorati i Financave dhe i Pronës

E gjithë shuma e ndarë buxhetore përbëhet nga të hyrat vetijake rreth 13%, meqenëse me janë bërë ndryshime nga tatimi në pronë dhe është zvogluar për 90%, e cila shumë është shpërndarë nëpër zëra tjerë buxhetor. I gjithë shpenzimi për sektorinë e tatimit në pronë ka qenë për furnizimin me material dhe paisje kompjuterike, të cilat kanë shkuar në kuadër të pozicioneve të përgjithshme.

IV Dukuritë natyrore negative

Në kuadër të drejtoratit për emergjencës bënë pjesë zëri buxhetor për dukurit natyrore, të cilat mjete buxhetore janë të rezervuara nga granti komunal ekskluzivisht për fatkeqësit natyrore. Këto mjete të tilla mbesin deri në fund të vitit kalendarik, por me mundësi të destinimit në fusha tjera, e që më vonë janë dedikuar në Drejtorat të Arsimit, për mbulimin e pagave. Pjesëmarrja në grant e këtyre mjeteve është rreth 4%.

V Zyra lokale e komuniteteve

Në bazë të udhëzimit administrative 2001/45 mbi ndarjen e drejtë financiare për komunitete, përqindja e ndarjes për Komunën e Prishtinës është 4.1% e mjeteve buxhetore nga granti komunal. Kjo ndarje është përfillur nga komuna dhe është mbështetur me mjete tjera shtesë, kryesisht përkrahja është bërë në bazë të projekteve. Pjesëmarrja e ZLK-s në buxhetin komunal përbëhet nga granti komunal për 5% e mjeteve të tërësishme buxhetore, pra, buxhetit në vitin 2004 është realizuar 96%.

Shënim:

Analiza e buxhetit për vitin 2004 është bërë vetëm në bazë të realizimit e kursesi edhe më shumë e totalit të zotimeve.

ARKËTIMI I TË HYRAVE VETIJAKE SIPAS DREJTORATEVE PËR VITIN 2004

Realizimi i të hyrave vetijake përbëhet nga:

1. Të hyrat vetijake nga Gjobat në Trafik;
2. Të hyrat vetijake nga Administrata e Përgjithshme;
3. Të hyrat vetijake nga Licencat në Biznes (Ekonomia);
4. Të hyrat vetijake nga Renta;
5. Të hyrat vetijake nga Kadastëri dhe Gjeodezi;
6. Të hyrat vetijake nga Inspekcioni;
7. Të hyrat vetijake nga Leje Ndërtimi (Urbanizmi);
8. Të hyrat vetijake nga Shfrytëzimi i Sipërfaqeve Publike dhe Panot Reklamuese;
9. Të hyrat vetijake nga Transakcioni i Pronës;
10. Të hyrat vetijake nga Tatimi mbi Pronë;
11. Të hyrat nga Participimi – Donacioni i qytetarve dhe
12. Të hyrat të Tjera.

❖ **Të hyrat vetijake nga gjobat në trafik**

Politika e inkasimit të këtyre të hyrave vije drejt nga niveli qendror, fillimisht gjobat në trafik ishin në përpjestim të drejtë në pjesëmarrjen e ndarjes së tyre, por me ndrrimin e politikës së arkëtimit të të hyrave nga niveli qendror, ndryshon ndarja e këtyre mjeteve, ku komunave ju mbeten 30%, ndërsa nivelit qendror 70%.

Shikuar

planifikimin buxhetor për vitin 2003 realizimi i të hyrave vetijake ishte 38%, ndërsa në vitin 2004 arkëtimi i të hyrave vetijake është realizuar 66%. Nga këto të dhëna vërehet se ka një rritje të inkasimit nga gjobat në trafik dhe në bazë të drejtë të ndarjes.

❖ **Të hyrat vetijake nga Administrata e Përgjithshme**

Të hyrat nga administrata e përgjithshme kryesisht hyjnë nga pagesat ditore të shërbimeve të ndryshme administrative komunale.

❖ **Të hyrat vetijake nga Licencat në Biznes**

Zhvillimi i vazhdueshëm do të shqyrtojë gjendjen e tanishme të licencimit dhe të zhvilloj sistem të hapur konkurrues për lëshim të licencave në biznes. Drejtorati i ekonomisë do të zhvilloj dhe administroj një kategori të taksës së licencës për komunitetin e biznesit në teritorin e Komunës së Prishtinës. Ky drejtorat në bazë të planit çdo vit do të shqyrtoj planifikimin dhe realizimin e të hyrave vetijake kryesisht nga komuniteti i biznesit. Ku në vitin 2004 inkasimi i të hyrave është arritur deri në 45%. Pra, nga këto të dhëna vërehet se nevojitet një konsolidim më i lartë në fushën e ekonomisë.

❖ **Të hyrat vetijake nga Renta**

Në bazë të rregullorës 2000/45 e UNMIK-ut, që u lëshua në ligj. Ky legjislacion i dha qeverisë Komunale përgjegjësin për ofrimin e një vistri shërbimeve. Më poshtë si vijon:

- Menaxhimi e pronave Komunale;
- Planifikimin urban, rural dhe përdorimin e tokës;
- Licencimin dhe rregullimin e ndëertimeve si dhe aktivitetet tjera të zhvillimit ekonomik;
- Mbrojtja e ambientit, ofrimi i komunalive, infrastrukturë dhe shërbimet emergjente dhe
- Ofrimi i shërbimeve sociale, banimit, arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe shërbime shëndetësore primare.

Prandaj, duhet theksuar se është fusha në të cilën Komuna më së paku ka mundur të realizoj synimet e veta. Shkas i kësaj është mungesa e funksionimit të infrastrukturës ligjore, ku subjektet të cilat veprojnë mbi pronat komunale janë të obliguara që për shërbimet e tyre biznesore të inkasojnë në arkën e komunës taksën mujore të parapare.

❖ **Të hyrat vetijake nga Kadastru dhe Gjeodezia**

Gjithnjë në vijën e parashikimit, drejtorati për kadastrë dhe gjeodezi ka mbajtur një trend të rritjes së inkasimit të të hyrave vetijake, ndërkaq në vitin 2004 është arritur në pikën deri në 80% e inkasimit të mjeteve vetijake. Ky trend i arkëtimit të të hyrave vetijake të paktën pritet të mos bie nën mesatare.

❖ **Të hyrat vetijake nga Inspekcioni**

Me gjithë vështirësit dhe problemet për t'i përmbushur detyrat dhe obligimet, ky drejtorat ka arritur të realizoj inkasimin deri në 68% të mjeteve të parapara. Inkasimi i këtyre të hyrave pritet të jetë më funksional, duke kooperuar me drejtoratet tjera.

❖ **Të hyrat vetijake nga Urbanizmi dhe Planifikimi**

Shikuar nga planifikimi i ndarjes së buxhetit dhe realizimi i tij, lë të kuptohet se deri me miratimin e planit rregullativ të kryeqytetit, realizimi i buxhetit për hartimin e projekteve rregullative ka qenë në shkallën më të ngadalshme. Por me aprovimin e planit hapsinor është filluar diq të lëvizet dhe të inaksohen të hyra nga dhënja e lejeve ndërtimore dhe të ngjajshme.

Në bazë të planifikimit, inkasimi i të hyrave vetijake në vitin 2004 është realizuar deri në 6%. Kurse një vit më parë-2003 ishte 81% e realizimit-inkasimit. Pra, krahasuar vitin 2003 me 2004, vërehet një rënje drastike e arkëtimit të të hyrave vetijake.

❖ **Të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe panot reklamuese**

Strategjia e inkasimit të shfrytëzimit të sipërfaqeve publike dhe panot reklamuese nuk janë në nivelin e pritur. Nga tabela e arkëtimit të këtyre mjeteve shihet se planifikimi ka qenë i duhur dhe me ndarje të përafërtë. Por nga kjo vërehet një ndryshim nga ai i planifikuar dhe i realizuar, ku në vitin 2004 është arkëtuar deri në 59% e mjeteve të planifikuara. Prandaj, shpresojm pa dyshuar fare se me një politik më racionale, këto të hyra do të rriteshin dhe do të vëshin një rend dhe siguri në komunitetin e biznesit dhe për vet qytetaret.

❖ **Të hyrat nga transaksioni i pronës**

Që nga pas lufta shërbimi mbi transaksionin e pronës ka kryer mjaft transaksione, të cilat janë të hyra të konsiderueshme për buxhetin komunal. Dallimi nga vitet e mëparshme me vitin 2004 janë të theksuara. Këto arkëtime janë realizuar në bazë të transaksioneve në mes të palëve shitë-blerëse. Inkasimi i këtyre të hyrave për vitin 2004 është tejkualuar për 3% nga baza e planifikuar. Ndërkaq, planifikimi i inkasimit të të hyrave për vitin 2004 nga transaksioni ka një rënje të vogël e cila mund të ndryshoj nga gjendja e përgjithshme ekonomike.

❖ **Të hyrat vetijake nga tatimi në pronë**

Sipas rregullorës së UNMIK-ut 2001/23 të aprovuar në vitin 2001 ka filluar implementimi i pilot programit për Tatimin në Pronë. Ky program është eksperimentuar në 4 komuna, në mesin e të cilave ishte edhe Komuna e Prishtinës. Prandaj, të gjitha të ardhurat e mbledhura nga tatimi në pronë do të shkojnë në buxhet komunal dhe do të ju shpërblehen qytetarve si p.sh. në qytezën Pejton është realizuar një pjesë e segmenteve rrugore *ndërtimi dhe riparimi i infrastrukturësë*. Shikuar nga viti kur ka filluar të aplikohet tatimi në pronë, grumbullimi i tatimit në pronë, është përmirësuar dukshëm në vitin 2004 duke u bazuar në këto elemente: *informimi më i mirë i qytetarve, ndërgjegjësimi i tyre, kompletimi i legjislacionit si element shumë i rëndësishëm etj.*

Marrë për bazë të hyrat e planifikuara nga tatimi në pronë, inkasimi është tejkualuar për 15%. Nga kjo shihet se të hyrat e arkëtuar nga tatimi në pronë gjithnjë prijnë dhe do të jenë në rritje e sipër, të cilat do të ju kthehen qytetarve në zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturësë.

❖ **Të hyrat nga participimi – donacionet e qytetarve**

Pjesëmarrja e qytetarve në zhvillimin e infrastrukturës, edhe përkundër shtresave dhe standardit të ulët të qytetarve dhe buxhetit të limituar nuk ka munguar. Mundësia e participimit të qytetarve në vitin 2003 ishte rreth 171 mijë euro, ndërsa në vitin 2004 ka qenë më i ulët dhe arrin shumën mbi 138 mijë euro. Edhe pse këto shuma janë të pakta, iniciativa

dhe inkasimi i qytetarve që të bashkëpunojnë me qeverinë komunale për projektet e ndryshme jetike, nuk ka hezituar dhe do të vazhdojë. Nga kjo shihet se qytetarët kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve në infrastrukturën komunale, bashkërisht në këtë aspekt edhe qeveria komunale nuk do të hezitojë dhe do të japë kontributin e vet.


❖ Të hyra të tjera

Në kuadër të të hyrave tjera bëjnë pjesë: *pagesa fikse për pjesëmarrje në tender, të hyrat nga byfeja dhe ndonjë pagesë terciare – të tjera* (të gjitha të deshifruara). Arkëtimi i këtyre të hyrave në vitin 2003 ishte rreth 44 mijë euro. Ndërkaq marrë për bazë planifikimin për vitin 2004, arkëtuar janë për 1.18 herë më shumë apo mbi 44 mijë euro.

Drejtoria për Financa dhe Pronë

PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË HYRAVE BUXHETORE PËR VITIN 2004

Nr	PËRSHKRIMI	Planifikuar	Realizuar	Përq. e realiz.
1	Të hyrat nga trafiku	915,000.00	602,070.50	65.80%
2	Të hyrat nga administrata	160,000.00	116,621.00	72.89%
3	Licencat në biznes	900,000.00	407,157.53	45.24%
4	Renta	160,000.00	9,320.00	5.83%
5	Të hyrat nga kadastri	200,000.00	159,452.95	79.73%
6	Të hyrat nga inspekcioni	200,000.00	136,767.14	68.38%
7	Leje ndërtimi - Urbanizmi	1,000,000.00	58,751.20	5.88%
8	Shfrytëzimi i sip. Publike & Panot Rek.	300,000.00	177,218.98	59.07%
9	Transakcioni i pronës	380,000.00	390,250.00	102.70%
10	Tatimi në pronë	1,333,000.00	1,536,281.13	115.25%
11	Donacione / Participim	0.00	138,448.00	-
12	Të hyrat tjera	20,140.00	43,835.32	217.65%
TOTAL		5,568,140.00	3,776,173.75	67.82%



DREJTORATI I PLANIFIKIM, I URBANIZËMIT DHE I NDËRTIMTARISË

Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, punët dhe detyrat e punës, nga përgjegjësia e vet e caktuar me Statut dhe me Rregulloren për organizimin e brendshëm të organeve të Komunës, i ka kryer përmes njësive organizative-Sektorit të planifikimit, Sektorit të urbanizëm, Sektorit të ndërtimit dhe Shërbimit për punë të përgjithshme dhe juridike.

Në raste të veçanta, e sipas nevojës, punët dhe detyrat nga përgjegjësia e këtij Drejtorati janë kryer në mënyrë ekipore, duke angazhuar personelin civil të të gjithë sektorëve, konform me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Fushëveprimtaria dhe punët e këtij Drejtorati janë bazuar, kryesisht në zbatimin e rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit dhe rregullimit të hapësirës, nga lëmi i ndërtimit të objekteve inventive si dhe rregullativës dhe vendimeve tjera të nxjerra nga Kuvendi i Komunës, në bazë të ligjeve aplikative.

I. PLANIFIKIMI

a. Hartimi i Planit strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës.

Hartimi i këtij Plani është kryer në bashkëpunim me institutet gjermane, të zgjedhura nga tenderi i organizuar më parë. Më pas ka pasuar marrëveshje bashkëpunimi me komunat fqinje të Prishtinës, si atë të Kastriotit, të Fushë-Kosovës dhe të Lypjanit.

Për hartimin e këtij Plani janë bërë shumë punë përgatitore:

- është bërë mbledhja e shënimeve të nevojshme për hartimin e këtij Plani, si ato nga operati kadastral, ku ka filluar klasifikimi i ngastrave sipas karakterit të pronave.
- është bërë skenimi i planeve detale ekzistuese të lagjeve të qytetit, si dhe i përpunimeve urbanistike ekzistuese, kryesisht të fshatrave,
- janë mbledhur shënime dhe janë organizuar takime punë me drejtoratet përkatëse të komunës, si me Drejtoratin e Ekonomisë, Drejtoratin e Zhvillimit Rural, Drejtoratin e Shërbimeve Publike, Drejtoratin e Arsimit, Drejtoratin e Shëndetësisë dhe me Drejtoratin Emergjencës.
- është bërë skenimi i hartave topografike të komunës së Prishtinës dhe vektorizimi i tyre,
- janë mbledhur shënime nga terreni, si dhe janë organizuar vizita të terrenit së bashku me përkrahësit e këtij projekti të instituteve gjermane,
- janë organizuar takime pune me nivelin qendror, gjegjësisht ministritë përkatëse, si Ministrinë e Planifikimit, Ministrinë e Transportit etj., bashkë me përfaqësuesit e instituteve gjermane,
- janë organizuar takime me ndërmarrjet publike si Batllavën, KEK-un, Ngrohtoren e qytetit, Higjiena-teknikën, Institutin meteorologjik, Riinvestin, Agjencionin REA, OSB, USAID-in etj.
- janë organizuar konsultime publike gjatë fazës së hartimit të këtij Plani, janë organizuar konferenca për shtyp, janë informuar të gjitha nivelet komunale si dhe organet e Kuvendit për vazhdiminë e punimeve,
- është organizuar diskutimi publik në afat prej 30 ditësh, ku gjatë kësaj periudhe janë organizuar 4 tryeza të konsultimeve profesionale me temat (ekonomia, banimi dhe ndërtimi, infrastruktura dhe mbrojtja e ambientit, dhe trafiku).

Në fund ka pasuar Vendimi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, i dt. 02.07.2004, për miratimin e Planit strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës.

Me miratimin e këtij Plani janë përcaktuar strategjitë dhe kahet e zhvillimit të qytetit, janë dhënë zgjidhjet strategjike të infrastrukturës së trafikut rrugor duke përfshirë edhe trenit urban.

b. Planet rregullative

Pas miratimit të PSZHU-së, Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimit ka përgatitur propozimin e prioriteteve të hartimit të planeve rregullative, i cili është shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe trupat e tij, me vendimin nr. 01-35-2427, të datës 10.09.2004.

Sipas detyrave vijuese programore të këtij Drejtorati, të miratuar me Vendimin e përmendur, janë përcaktuar prioritetet për hartimin e planeve rregullative dhe atë:

- p.rregullativ. “Qarkoret”,
- p.rregullativ. “Qendra 1”,
- p.rregullativ. “Qendra 2”,
- p.rregullativ. “Dodona”,
- p.rregullativ. “Arbëria”,
- p.rregullativ. “Kalabria”,
- p.rregullativ. “Mati”,
- p.rregullativ. “Tophane”.

Në bazë të këtij prioriteti, janë përgatitur materialet për tender - programi dhe detyra projektuese për hartimin e këtyre planeve rregullative, për të cilat janë shpallë tenderët si dhe është bërë zgjedhja e ofertuesve më të përshtatshëm.

Me detyrat projektuese është kërkuar që planet rregullative të hartohen në bashkëpunim të plotë me këtë Drejtorat , të cilat plane duhet të punohen në tri faza dhe atë, incizimin gjeodezik, profilin urban dhe zgjedhjen ideore.

1. P.rregullativ “Dodona”

Ky plan rregullativ zë pozitën qendrore, të përkufizuar me zonën Qendër dhe parkun e qytetit. Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit si zonë mikste urbane (banim dhe biznes), me përmbajtje përcjellëse. Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 17 ha.


2. P.rregullativ “Tophane”

- Ky plan rregullativ përkufizohet me rr. “UÇK-ja”, “Zagrebi”, dhe “Ilir Konusheci”.
- Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit si zonë mikste urbane (biznes dhe banim të dendur), me përmbajtje përcjellëse.
- Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 30 ha.
- Çështje me rëndësi në hartimin e këtij plani, përveç tjerash është qasja dhe përkufizimi me pjesën e qarkores Qendër.




3. P.rregullativ “Arbëria III”

- Ky plan rregullativ përkufizohet me rr.”Tirana”, gjegjësisht hekurudhën ekzistuese, lagjen “Arbëria II”, dhe varrezat ortodokse.
- Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit si zonë mikste urbane (biznes dhe banim të dendur), me përmbajtje përcjellëse.
- Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 84 ha.
- Çështje me rëndësi dhe karakteristike në hartimin e këtij plani, përveç tjerash është qasja dhe përkufizimi me pjesën e qarkores Qendër.



4. P.rregullativ “Mati”

- Ky plan rregullativ përkufizohet me Kodra e Diellit I, Aktashin III ,Kodra e Diellit II, kurse nga ana lindore përkufizohet me përrockën.
- Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit si zonë mikste urbane (biznes dhe banim të dendur), si dhe me përmbajtje përcjellëse.
- sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 184 ha.



5. P.rregullativ “Qendra”

- Ky plan rregullativ zë pozitë qendrore dhe përkufizohet me Rr “Agim Ramadani”, “Ilir Konusheci”, “Trepça”, “UÇK-ja”, “Luan Haradinaj”, “Tirana” dhe rr.”Tringë Ismajli”.
- Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit si boshti i qytetit.
- Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 12 ha.
- Rëndësi dhe karakteristikë e këtij plani është se me këtë përfshihen objektet kulturore, administrative dhe institucionale të nivelit qendror dhe komunal, dhe paraqet qendrën e qytetit.



6. P.rregullativ “Kalabria”

- Ky plan rregullativ shtrihet në pjesën jugperëndimore të qytetit e që përkufizohet me magjistralen Mitrovicë – Shkup, rrugën Prishtinë- F.Kosovë, dhe me qarkoren e brendshme.
- Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit e destinuar për banim, si zonë mikste urbane (biznes dhe banim të dendur), zone industriale dhe me përmbajtje përcjellëse, gjelbërim e të tjera.
- Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 280 ha.
- Rëndësi dhe karakteristikë e këtij plani është se me këtë përfshihet terminali i ardhshëm i trenit urban.



7. P.rregullativ „Qendra 2“

- Ky plan rregullativ përfshinë pozitën qendrore të qytetit, përkatësisht trekëndëshin e rrugëve “Nëna Tereza”, “Bill Klintoni” dhe “Perandori Justinian”.
- Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan është prej 4.1 ha.
- Rëndësia e realizimit të këtij plani është rregullimi i hapësirës, ku përveç katedrales, do të plotësohet edhe me përmbajtje tjera si afarizëm, parking garazhe etj.



8. P.rregullativ për Qendrën Universitare

- Ky plan rregullativ ka kufijtë e definuar ekzistues , dhe përfshinë hapësirën në mes rrugëve „Nëna Tereza“, „Eqrem Çabej“ dhe „Agim Ramadani“.
- Qëllimi i hartimit të këtij plani është rregullimi i kësaj hapësire me destinim sipas PSZHU-së të qytetit, me destinim të caktuar me plotësim të përmbajtjeve në bazë të programit zhvillimor të Arsimit të lartë nga Ministria e Arsimit dhe Rektoratit të Universitetit të Prishtinës.
- Sipërfaqja e përafërt që përfshin ky plan rregullativ është prej 13.50 ha.
- Rëndësia e këtij plani është rregullimi dhe definimi i kompleksit si tërësi duke e plotësuar me objekte për nevojat e arsimit të lartë.



Projektet e qarkoreve:


1. Qarkorja “Qendër”

- Kjo rrugë përkufizon bërthamën e qytetit, lagjet “Dardania”, “Ulpiana”, “Qendër”, “Tophane” dhe “Lakërishte”, duke u shtrirë nga Stacioni i autobusëve, përgjatë rrugës Mitrovicë - Prishtinë, rr. “Fehmi Lladrovci”, rr. “Agim Ramadani”, rr. “Ilir Konusheci”, duke u mbyllur me rr. “Zagrebi” dhe atë “Tirana”.
- Qëllimi i hartimit të këtij projekti sipas PSZHU-së është rregullimi i trafikut të qytetit.
- Gjatësia e përafërt e kësaj qarkoreje është prej 8 km.
- Rëndësia e këtij projekti qëndron në atë se më të përmbillet kjo qarkore, meqë një pjesë e kësaj qarkoreje është ekzistuese.



2. “Qarkorja e brendshme”

- Kjo rrugë, nga ana lindore përshkon pyllin e qytetit, nga ana jugore kalon nëpër boshtin e ardhshëm të qytetit, nga ana perëndimore kalon nëpër Zonën industriale.
- Qëllimi i hartimit të këtij projekti sipas PSZHU-së është rregullimi i trafikut të qytetit, dhe krijon qasje në hapësirat e reja sipas këtij plani.
- Gjatësia e përafërt e kësaj qarkoreje është 25 km.
- Rëndësia e këtij projekti qëndron në atë se , më të shkarkohet trafiku i qytetit.



c. Caktimi i lokacioneve

Për objekte me destinime të caktuara, e në bazë të kërkesave dhe programeve urbane- arkitektonike, janë hulumtuar dhe përcaktuar lokacione adekuate, janë kryer incizimet në terren, janë konsultuar planet ekzistuese urbanistike dhe organet ekzekutive kompetente të Komunës lidhur me statusin pronëso-ro-juridik të atyre lokacioneve. Janë përgatitur prezantimet grafike, në bazë të të cilave nxjerrë propozim vendimet të cilat janë prezantuar për shqyrtim në Bordin e drejtorëve , Komitetin për Planifikim , Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe në Kuvendin e Komunës.

Në bazë të këtyre vendimeve dhe kërkesave, ky Drejtorat ka përgatitur kushtet urbanistiko-teknike për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, i cili është i domosdoshëm për procedurë të mëtejme.

Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investuese Komuna, janë përgatitë materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tenderëve, është marrë pjesë në komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave, si dhe është bërë menaxhimi i realizimit – ndërtimit të këtyre objekteve nga personeli civil profesional i këtij Drejtorati.

1) Lokacionet për objekte shëndetësore:

- caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – Laboratorit për kontroll të cilësisë së barnave, në emër të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës-Agjencionit për produkte medicinale,
- caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës së mjekësisë familjare në lagjen “Kalabria”,
- kushtet e përkohshme të ndërtimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në kompleksin e lagjes “Kodra e Trimave”,
- caktimin e lokacionit dhe përgatitjen e kushteve urbanistike-teknike për Qendrën e Shëndetit Mental për Adoleshentë në kuadër të QKU-së,
- caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për Punë Sociale,
- caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Institutit të Mjekësisë Ligjore
- caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kardiokirurgjike
- caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Shtëpisë me karakter gjysmë të mbrojtur- Mat
- caktimin e rrethojës për Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Mat.

2) Lokacione për objekte sportive

- Është përgatitë pëlqimi urbanistik për shfrytëzimin e tokës për ndërtimin e fushës së sportit për klubin e sportit “2 Korriku”.
- Caktimi i lokacionit të përkohshëm për terrene sportive në lagjen “Dardania” dhe “Kodra e Diellit”.

3) Lokacione për objekte arsimore

- Kushtet për Çerdhen në Dardani.
- Kushtet dhe tenderi për Çerdhen në Ulpianë.
- Rregullimi i hapësirës me kushtet urbanistike për objektin e shkollës në kompleksin e qendrës në lagjen “Kodra e Trimave”.

4) Lokacione për objekte me karaktere të ndryshme:

- caktimi i lokacionit për ndërtimin e objekteve –Teatrit të Operës dhe të Baletit dhe Galerisë së Arteve,
- caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë,
- Vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Fshatit ndërkombëtar në Prishtinë,
- caktimi i lokacionit për ndërtimin e autoparkut para kompleksit të QKU-së,
- caktimi i lokacionit për objektin e xhamisë në fshatin Bardhosh,
- rregullimi i hapësirës me kushtet urbanistike për objektin e xhamisë në Fushën e Pajtitimit,
- caktimi i lokacionit dhe dhënia e tokës në shfrytëzim të përkohshëm shoqatës bëmirëse “Nëna Terezë”,
- lokacion për Tregun e gjelbër me shumicë – Bërrnicë e Ulët,
- dislokimi i Tregut të gjelbër,
- caktimi i lokacionit të përkohshëm për Tregun e druve,
- caktimin e lokacionit për vendosjen e objekteve të përkohshme – qoshqeve për Shoqatën e grave.

d. Përgatitja e materialeve, detyrave dhe programeve projektuese për hapjen e tenderëve

Gjatë periudhës raportuese, gjithashtu janë përgatitur materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tenderëve nga përgjegjësia e këtij Drejtorati, si psh :

- për renovimin e fushave sportive, sipas kërkesës së Drejtoratit të Kulturës, të Gjinisë dhe të Sportit, të shkollës fillore “Zenel Hajdini” në Prishtinë, shkollës fillore “Shkëndija” në Hajvali, dy fushat në lagjn “Ulpiana” , fushën për sport në Gërmi, për terrenin e klubit futbollistik “2 Korriku” si dhe për renovimin e teatrit “Dodona” .
- janë përgatitur materialet për tender me detyrën projektuese për Qendrën e Mjekësisë Familjare në l. “Kalabria” dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen “Kodra e Trimave”, të cilat janë në procedurë,
- për zgjidhjen ideore të Fshatit ndërkombëtar,
- për caktimin e lokacionit për ndërtimin e autoparkut para kompleksit të QKU-së,
- për rekonstruimin e teatrit “Dodona”,
- për ndërtimin e Shkollës fillore në Mat.
- është përgatitur materiali për tender me detyrën projektuese për zgjidhjen ideore të kompleksit të banesave në Kodrën e Diellit, komisioni ka përcaktuar fituesin, i cili ka hartuar edhe projektin kryesor.

Në bashkëpunim me Zyrën e prokurimit është përgatitur tenderi për ndërtimin e këtij kompleksi, i cili është në procedurë për zgjidhjen e ofertuesit më të përshtatshëm.

Është vazhduar puna në hapjen e tenderit të përsëritur nga ana e UNDP-së për përcaktimin e kryesit të punëve për pilotprojektin “rregullimin e rrugës Nëna Tereza”, është përcaktuar fituesi dhe ka filluar realizimi i këtij projekti, i cili ka përfunduar me sukses, pas një vonesë për shkak të punëve shtesë, dhe për shkakun e punëve nga ana e “Termokosit”.

II. URBANIZMI

ZGJIDHJA E KËRKESAVE TË PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË.

Gjatë periudhës raportuese, këtij Drejtorati i kanë arritur 895 kërkesa, ndërsa të bartura nga viti paraprak kanë qenë 112 kërkesa, që do të thotë se gjatë këtij viti raportues kanë qenë për punë 1007 kërkesa, zgjidhja e të cilave bie në përgjegjësinë e këtij Drejtorati.

Kërkuesit kanë qenë persona fizikë dhe juridikë.

Përmbajtja e kërkesave ka qenë kryesisht: caktimi i lokacioneve, lëshimi i lejeve urbanistike për caktimi e kushteve urbanistike-teknike, lëshimi i lejeve ndërtimore, vendosja e objekteve të përkohshme, informacione për destinimet e sipërfaqeve në planet përkatëse urbanistike, për caktimin e dispozitave sipas planeve detale, për rrënimin e objekteve ekzistuese, për lëshimin e vërtetimeve për dëme të shkaktuara nga lufta, për ndërrimin e destinimit të përdorimit të objekteve ekzistuese, për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe kërkesa për informacione të tjera mbi kushtet për rregullimin e hapësirës, si dhe kërkesa dhe kundërshtime me përmbajtje të ngjashme.

Vendosja e kërkesave, në shumicën e rasteve është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare, ndërsa për një pjesë të tyre, nuk ka qenë e nevojshme të nxirret konkluzion përfundimtar, por të njëjtat janë vendosur në bazë të informacioneve, përgjigjeve dhe lëshimit të vërtetimeve, si dhe provave tjera të kërkuara.

Gjendja e kërkesave të arritura, mënyra e zgjidhjes së tyre dhe e atyre në procedurë, në mënyrë tabelore duket si më poshtë.

1	2	3	4	5
Të arritura gjatë periudhës raportuese	Të bartura nga periudha paraprake (2003)	Gjithësej për punë gjatë vitit raportues	Të zgjidhura	Në procedurë
895	112	1007	791	216

Mënyra e vendosjes sipas kërkesave të paraqitura në tabelën e sipërme duket si vijon:

1	2	3	4	5	6
Të zgjidhura	Leje urbanistike	Leje ndërtimore	Informim Konkluzave vërtetime	Me vendime Kuvendit	Të refuzuara
791	130	60	258	25	318

a. Mënyra e vendosjes sipas kërkesave

Zgjidhja e kërkesave është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare, aktvendimeve, konkluzave, përgjigjeve dhe vërtetimeve, si dhe në bazë të përgatitjes së propozim-vendimeve për Kuvendin komunal.

Vendosja sipas kërkesave për caktimin e kushteve urbanistike-teknike dhe lejimi i ndërtimeve, është bërë kryesisht në formë të rikonstruimit të objekteve ekzistuese me zgjerime minimale nga shkak se në shumicën e rasteve, hapësirat ku është kërkuar lejimi i ndërtimit, në bazë të planit të përgjithshëm urbanistik dhe planit strategjik, zhvillimor urban i Prishtinës e kanë patur destinimin e banimit, por për këto hapësira kanë munguar planet rregullative.

Po ashtu, për lejimin e ndërrimit të destinimit të sipërfaqeve banesore në hapësira afariste, është bërë vetëm në rastet kur ky ndërrim ka mundur të bëhet pa ndërhyrje nga aspekti i konstruksionit-stabilitetit të objektit dhe pamjes vizuale të objekteve, ndërsa pas miratimit të Vendimit komunal për caktimin e kriterëve bazë për ndërrim destinimi në mbledhjen e mbajtur më dt.10.08.2004, janë caktuar kryesisht kushtet urbanistiko-teknike për përligjjen e destinimeve të bëra.

b. Arsyet kryesore për refuzimin e kërkesave

Gjatë shqyrtimit të kërkesave, arsye kryesore për nxjerrjen e konkluzionit për refuzimin e tyre ka qenë:

- çështja pronësore-juridike e pazgjidhur në tokën apo hapësirën ku është kërkuar lejimi i ndërtimit,
- sipërfaqet në të cilat është kërkuar lejimi i ndërtimit, sipas PU-së, kanë pasur destinim tjetër nga ai i kërkuari, si dhe nga arsyeja e qasjes së programeve komunale për nxjerrjen e planeve rregullative.
- kërkesat për lejimin e ndërtimeve jashtë kufijëve të fshatrave, përkatësisht në tokën bujqësore ose në afërsi të rrugëve magjistrale, hekurudhore dhe rrugëve tjera,
- kërkesat për lejimin e ndërrimit të destinimit të hapësirave në objektet banesore (kolektive), për të cilat nuk është argumentuar e drejta pronësore e kërkuësve në ato hapësira, si dhe ato të cilave nuk ka mundur t'u ndërrohet destinimi pa ndërhyrje me punë ndërtimore dhe pamundësi të shfrytëzimit të qasjeve ekzistuese, si dhe mungesën e bazës së mjaftuar juridike,
- kërkesa për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike pa provën mbi të drejtën e shfrytëzimit të asaj sipërfaqeje.

Me miratimin e Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor 2003/30 të datës 10.09.2003, mundësia e ndërrimit të destinimit të përdorimit është kufizuar me nxjerrjen paraprake të planeve përkatëse urbanistike për komplekset përkatëse të zonave urbane, kështu që pas kësaj date, të gjitha kërkesat për ndërrimin e destinimit të përdorimit janë refuzuar me arsyetimin e përmendur deri në miratimin e Vendimit të Komunës për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit, me të cilin vendim janë zëvendësuar planet urbanistike nga ky aspekt.

Dukuri tjetër e shpeshtë e cila ka ndikuar në marrjen e konkluzionit për refuzimin e kërkesave ka qenë se kërkesat për lëshimin e lejeve urbanistike për caktimin e kushteve urbanistike-teknike dhe për lejimin e ndërtimit janë paraqitur pas përfundimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore me qëllim ndërtimi, ndërrimi të destinimit apo pas kryerjes së punëve të konsiderueshme gjë që është konstatuar gjatë shqyrtimit të kërkesave në procedurën e daljes në vendshikim, kështu që ky Drejtorat, konform me rregullativën ligjore në fuqi, këto kërkesa i ka refuzuar me arsyetim se janë zhvilluar punimet ndërtimore pa u caktuar kushtet urbanistike-teknike dhe pa u lejuar ndërtimi.

c. Kërkesat e aprovuara dhe ato në procedurë

Në numrin e kërkesave të paraqitura si të aprovuara është paraqitë numri i lejeve urbanistike mbi caktimin e kushteve urbanistike-teknike, lejet ndërtimore, konkluzionet me të cilat është lejuar zhvillimi i punimeve ndërtimore, të cilat nuk e kanë ndryshuar projektin e objektit ekzistues përkatësisht punët, të cilat komform me rregullativën ligjore, nuk janë trajtuar ndërtim as rikonstruim, si dhe konkluzionet tjera me të cilat është zgjidhur çështja pa qenë e domosdoshme të nxirret vendim i veçantë dhe të cilat janë zgjidhur në favor të kërkuësve, propozim-vendimet e miratuara nga Kuvendi për caktimin e lokacionit, lëshimi i vërtetimeve mbi shkallën e dëmtimit nga pasojat e luftës, si dhe kërkesat tjera të ngjashme në favor të palëve.

Në numrin e lëndëve të paraqitura në procedurë, pos lëndëve për të cilat është kërkuar plotësimi i tyre janë edhe ato të cilat kanë arritur në gjysmën e dytë të muajit dhjetor të vitit raportues.

d. Veprimet sipas kërkesave për legalizimin e ndërtimeve pa leje-arbitrare

Kjo kategori e kërkesave janë shqyrtuar duke kryer veprime nga përgjegjësia e këtij Drejtorati (përpos kërkesave për legalizimin e mbindërtimeve dhe shndërrimeve në objekte kolektive), përkatësisht janë kompletuar lëndët dhe është konstatuar gjendja faktike në teren, si dhe është kërkuar nga kërkuesit që kjo gjendje, vija rregullative dhe ajo ndërtimore, të caktohet nga Drejtorati i Kadastrit dhe që në shumicën e rasteve këto kërkesa janë plotësuar edhe me këto të dhëna.

Mirëpo, përgjegjësia e këtij Drejtorati për nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare ka qenë e kufizuar, sepse me rregullativën ligjore në fuqi (vendimi mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje Nr. 01-351-711 dt. 16.05.2001 Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve nr. 01-010-3 dt. 03.01.2002, përgjegjësia për vendosje sipas këtyre kërkesave i është dhënë një organi kolegjal, e që ky organ asnjëherë nuk ka vepruar për zgjidhjen e këtyre kërkesave.

Pasi që është nxjerrë Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës, është pushuar procedura për vendosje sipas këtyre kërkesave e që për një veprim të këtillë të gjithë kërkuesit janë informuar për pushimin e procedurës për vendosje sipas tyre deri në miratimin e planeve rregullative, siç u tha më lartë, kërkesat për legalizimin e ndërrimit të destinimit të përdorimit janë në shqyrtim e sipër, bazuar në Vendimin komunal nr.01-35-2425 dt.10.09.2004.

e. Vendosja sipas kërkesave për pranimin teknik të objekteve dhe lejimi i tyre për përdorim dhe shfrytëzim

Pasi konform me rregullativën ligjore në fuqi, pas përfundimit të ndërtimit, investitori është i obliguar që të pajiset me leje përdorimi dhe shfrytëzimi, e cila leje mund të lëshohet vetëm pas kontrollimit teknik nga komisioni profesional i formuar nga organi që ka lëshuar lejen për ndërtim, këtij Drejtorati gjatë kësaj periudhe i janë paraqitur 4 kërkesa për caktimin e komisionit profesional për kontrollim teknik të objekteve të përfunduara sëndërtuari dhe 4 kërkesa për leje përdorimi dhe shfrytëzimi.

Ky Drejtorat duke shqyrtuar këto kërkesa e ka caktuar komisionin përkatës për 4 raste, ndërsa sipas kërkesave për leje përdorimi dhe shfrytëzimi është lëshuar vetëm 4 këso leje.

f. Dhënia e informacioneve dhe vlerësimi i dëmeve nga pasojat e luftës të objekteve të dëmtuara nga lufta

Gjatë vitit raportues, ky Drejtorat i ka caktuar komisionet përkatëse për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet nga pasojat e luftës për 4 raste sipas kërkesave të palëve. Pasi që tërë dokumentacioni mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara udhëhiqet në këtë Drejtorat, gjatë këtij viti janë dhënë shumë informacione dhe shënime sipas kërkesave të bashkësive lokale, si dhe organizatave tjera joqeveritare ndërkombëtare, si dhe organizatave tjera.

Po ashtu, gjatë vitit raportues janë lëshuar 39 vërtetime mbi shkallën e dëmtimit të pësuar nga lufta, sipas kërkesave të personave civil dhe juridik.

g. Punët tjera nga përgjegjësia e Drejtoratit

Gjatë vitit raportues nga ky Drejtorat është kërkuar që të bëhen vlerësimet profesionale mbi paramasat dhe parallogaritë për shpalljen e tenderëve për ndërtimin dhe rikonstruimin e objekteve për të cilat Komuna ka qenë investitor përkatësisht për objektet me të cilat qeveriset Komuna.

Po ashtu, për këtë kategori të objekteve është kërkuar nga ky Drejtorat që të caktojë persona profesionalë për mbikëqyrjen e zhvillimit të punimeve ndërtimore, si dhe caktimin e komisionit profesional për kontrollimin teknik të këtyre objekteve pas përfundimit të ndërtimit, përkatësisht rikonstruimit, si dhe analiza të tjera për investime.

III. NDËRTIMTARIA

Gjatë periudhës raportuese, Sektori për Ndërtimtari i Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë të Komunës së Prishtinës i ka kryer punët dhe detyrat nga përgjegjësia e vet duke u përqëndruar në:

- **Detyra projektuese, pëlqime urbanistike dhe përcjellje të projekteve për:**

- a) projektimin dhe rekonstruimin e 32 rrugëve të qytetit, (për 25 rrugë projektet kanë përfunduar, kurse për 7 rrugët të tjera janë duke u punuar projektet).
- b) projektimin e rrugës Qytet – Mramuer,
- c) kanalizimi i fshatit Hajvali,
- d) projektimin e rrugës “Xhevat Begolli”
- e) shtrirjen e kablllove për 10 KV në lagjen “Kodra e Trimave”
- f) shtrirjen e kablllove për 110 KV
- g) për ujësjellësin në Sefali,
- h) ndërtimin e kanalizimit në rrugën “Haxhi Zeka”
- i) ndërtimin e ujësjellësit, kanalizimit dhe riparimit të rrugëve “Edmond Hoxha”, ”Shaip Kamberi” dhe “Mustafa Kruja”
- j) përgatitja e tenderit për Unazat dhe Trenin urban.

Në kuadër të këtyre punëve është bërë edhe incizimi e fotografimi në teren, janë përgatitur bazat gjeodezike, janë kërkuar të dhënat mbi infrastrukturën nëntokësore ekzistuese nga ndërmarrjet që menaxhojnë me atë infrastrukturë si: KEK-u, PTK-ja, Ujësiellësi rajonal “Prishtina”, pastaj janë përgaditur detyrat projektuese dhe materialet e nevojshme për tender, si dhe janë përcjellë punët gjatë projektimit.

- **Mbikëqyrja e objekteve:**

- a) renovimi i objektit të stomatologjisë në Prishtinë
- b) renovimin e bahkësive lokale VII, II, III, X,
- c) qendra e mjekësisë familjare nr. III. dhe V,
- d) asfaltimin e rrugës Suteskë – Mramor,
- e) Shtëpia e Kulturës në Bardhosh e Keçekollë,
- f) rregullimi i zyrave të komitetit boshnjak,
- g) ndërtimi i urës në fshatin Barilevë, lagjen e Vërbovcëve,
- h) rindërtimi i objekteve në fshatin Çagllavicë,
- i) ndërtimin e kanalizimit në Hajvali, Besi dhe Trudë,
- j) Ndërtimin e ujësiellësit në Lugar e Sefali,
- k) Ndërtimin e objektit të Agim Çavdërbashës në Çagllavicë dhe NPT ”Drini”.
- l) ndërtimin e bazës dhe vendosjen e objekteve montuese në lagjen “Fusha e Pajtimit”,
- m) ndërtimi i shkollës në fshatin Ballaban,
- n) ndërtimi i shkollës në fshatin Mat,
- o) rikonstruimi i teatrit të rinjëve “Dodona”,
- p) renovimi i ambulancës në Bardhosh.

- **Vlerësimet e tenderëve:**

1. Tereni sportiv dhe shkallët e shkollës fillore “Ismail Qemajli”,
2. Rrethojat e qendrës “Ulpiana”,
3. Vlerësimi i fshatit ndërkombëtar. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e Shkollës Fillore në Hajkobillë,
4. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Hajvali,
5. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e dritareve të shkollave në Komunën e Prishtinës,
6. Vlerësimin e tenderit për ndërtimin e urës në lagjen e Vërbovcëve,
7. Vlerësimi i ofertave për Graçanicë, Llapnasellë dhe Preoc,
8. Vlerësimi i objekteve të dëmtuara në ngjarjet e marsit,
9. Vlerësimi i tenderit për rindërtimin e objekteve të dëmtuara,

10. Vlerësimi i ofertave për pastrimin e lumejëve “Prishtina”, “Vellusha” dhe përroit te Lagja e Spitalit,
11. Vlerësimi i ofertave për furnizimin me inventar për Entin e Mjekësisë Urgjente,
12. Vlerësimi i ofertave për ndërtimin e ujësjellësit në Sofali,
13. Vlerësimi i ofertave për rrugën “Ymer Lutfi Paqarizi”,
14. Vlerësimi i ofertave për rrugën Koliq – Podaj, si dhe rrugën Suteskë –Mramor.
15. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e urës në Ballaban,
16. Vlerësimi i tenderit për renovimin e rrugës Stallovë-Koliq,
17. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e urës në lagjen e Vërbovcëve,
18. Vlerësimi i tenderit për renovimin e Mjekësisë Familjare nr. 5,
19. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e ujësjellësit në Prugovc,
20. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e trotuarit për rrugën “Ahmet Krasniqi”,
21. Vlerësimi i tenderit për ndërtimin e kanalizimit në Mat,
22. Vlerësimi i tenderit për vendosjen e kontejnerëve të zjarrfikësve në Llapnasellë,
23. Vlerësimi i tenderit për projektimin e rrugëve; faza e dytë dhe e tretë,
24. Vlerësimi i tenderit për projektimin e ujësjellësit në Sofali,
25. Vlerësimi i tenderit për projektimin e renovimit të teatrit “Dodona”,
26. Vlerësimi i tenderit për dhënie me koncesion të Fshatit Ndërkombëtar,
27. Vlerësimi i tenderit për rikonstruimin e objekteve në Çagllavicë,
28. Vlerësimi i tenderit për shtruarjen me zhavor të rrugëve në fshatrat Teneshdoll e Vranidoll,
29. Vlerësimi i ofertave për projektimin e objektit të garazhit,
30. Vlerësimi i ofertave për projektimin e qarkoreve dhe trenit urban.

- **Marrja pjesë në pranim teknik të objekteve**

- a. Qendra e Mjekësisë Urgjente,
- b. Objekti i BL. VII, XII dhe XIII, si dhe të Bashkësisë Lokale në Keqekollë,
- c. Shtëpia e Kulturës në Bardhosh e Keqekollë,
- d. Objekti i stomatologjisë,
- e. Qendra e mjekësisë familjare nr. III.
- f. Asfaltimi dhe ndërtimi i kanalizimit në rrugën “Gjon Sereçi”
- g. Asfaltimi i rrugës Suteskë – Mramor,
- h. Ambulanca në fshatin Mat,
- i. Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Milevc,
- j. Ndërtimi i ujësjellësit në Teneshdoll,
- k. Ndërtimi i rrugës në lagjen Spahiaj në Keqekollë,
- l. Ndërtimi i rrugës Stallovë – Koliq,
- m. Ndërtimi i shkallëve lidhëse në mes Kadastrit dhe Komunës,
- n. Asfaltimi i rrugës në lagjen e Llumnicëve,
- o. Renovimi i Bashkësisë Lokale nr.10,
- p. Renovimi i ambulancës në fshatin Bardhosh,
- q. Të shkollave fillore në Dardani, Hajkobilë dhe Ballaban
- r. Të objektit të Kriminalistikës
- s. Të objektit afarist banesor C2 në Prishtinë.

Vlerësimi i dëmeve, përgatitja e projekteve për objektet e dëmtuara në fshatin Çagllavicë.

Janë incizuar në teren dhe vlerësuar 11 objekte banimi, 2 objekte afariste dhe objektet sekondare 8.

Për të gjitha këto objekte janë përgatitur projektet e zbatimit dhe materiali për tenderim, si dhe mbikëqyrja e ndërtimit të 10 objekteve të banimit.

- **Përgaditja e paramasave:**

- a) Për renovimin e Qendrës Familjare nr 3 dhe 5.
- b) Për renovimin e bashkësive lokale 7, 12, 13 dhe të Shtëpisë së Kulturës në Keqekollë,
- c) Rregullimi i rrugës në Lagjen e Llumnicëve,

IV. Punët juridike

Gjatë periudhës raportuese është punuar në:

- janë përgatitur të gjitha propozim-vendimet me arsyetimet përkatëse e të përmendura me këtë raport pune,
- harmonizimin e të gjitha akteve për nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare, me Ligjin e ri për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtim, si dhe me aktet tjera nënligjore të nxjerra në bazë të tyre,
- përgatitja e propozim-vendimit për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore e miratuar në mbledhjen e Kuvendit komunal të mbajtur më dt.10.08.2004,
- përgatitja e propozim-vendimit mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore e miratuar në mbledhjen e Kuvendit komunal të mbajtur më dt. 30. 06. 2004,
- dhënia e udhëzimeve profesionale për zbatimin e rregullativës ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve dhe konkluzioneve përfundimtare nga përgjegjësia e këtij Drejtorati,
- marrja pjesë në vendosjen e kërkesave më të ndërlikuara nga lëmi I planifikimit dhe ai i ndërtimit,
- përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore për punën e Drejtoratit,
- përgatitja e informatave për trupat e Kuvendit komunal, për administratën ndërkombëtare, pushtetin qendror, si dhe përgjigjet sipas pyetjeve të delegatëve të Komunës së Prishtinës dhe
- punë të tjera rutimore për zbatim të ligjshmërisë.

Punët tjera nga personeli për shërbime të përbashkëta

Në punën e Drejtoratit, gjatë periudhës raportuese janë punuar edhe punë të tjera administrative dhe logjistike si; udhëheqja e arkivit intern të Drejtoratit, pranimit dhe ekspeditimi i materialeve të arritura për punë dhe të punuara me punë të tjera për nevojat e Drejtoratit.

VI. VËSHTIRËSITË DHE PENGESAT E PARAQITURA NË REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA

Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës nga përgjegjësia e këtij Drejtorati, janë vërejtur pengesa të ndryshme, të cilat kanë ndikuar dukshëm në efikasitetin, azhuritetin dhe realizimin e punëve dhe detyrave të punës nga përgjegjësia e këtij Drejtorati.

Një ndër pengesat me ndikim vendimtar ishte mungesa e infrastrukturës ligjore, sepse rregullativa ligjore e aplikueshme në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, është shumë e vështirë të aplikohet nga shkak i ndërrimit të sistemit si tërësi, tjetërsimit të pronës nga ajo shoqërore në pronësi private, si dhe pamundësisë së eksproprijimit të pronës private për qëllime të realizimit të planeve urbanistike, si dhe nxjerrjes së planeve të reja urbanistike.

Pengesë serioze në aspektin e planifikimit hapësinor ishte atakimi enorm i hapësirave të lira me ndërtime ilegale, si brenda kufijëve të planit zhvillimor urban, ashtu edhe jashtë kufijëve të tij.

Po ashtu, ndikim vendimtar dhe pengesë serioze në realizimin e shumë vendimeve komunale nga përgjegjësia e këtij Drejtorati ishte edhe kufizimi i të drejtës së administrimit të Komunës

në tokën në pronësi të saj me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, si dhe mosdefinimi adekuat i pronësisë shoqërore, publike apo komunale.

propozimi i masave

- që me një akt të veçantë të bëhet ndarja e kompetencave në mes të drejtorateve në mënyrë më decizive, sepse me Statutin dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm të organeve ekzekutive të Komunës, këto kompetenca janë dukshëm të ngatërruara,
- të intensifikohet bashkëpunimi ndërdrejtoral i Komunës për çdo iniciativë të projekteve urbanistike në kuadër të përgjegjësisë së secilit Drejtorat, deri në realizimin e projekteve,
- që me rebalanc të buxhetit të Komunës për vitin 2005, të shqyrtohet mundësia e rritjes së mjeteve financiare për nevojat e këtij Drejtorati, me qëllim të realizimit të planprogramit të punës për vitin 2005,
- të rritet (shtohet) numri i personelit civil profesional në Drejtorat, e veçanërisht ai nga lëmia e arkitekturës,
- Të propozohet që Kuvendi i Kosovës të nxjerr rregullativë ligjore mbi definimin e të drejtës pronësore dhe administrimin në hapësira të përbashkëta në objektet banesore të tërësisë së përbashkët (kolektive),
- me qëllim të efikasitetit në punën e këtij Drejtorati është e nevojshme të bëhet riorganizimi i brendshëm.

DREJTORATI I KULTURËS DHE I GJINISË

Në fillim të vitit 2004, Drejtorati bëri një rezymë të projekteve të realizuara gjatë vitit 2003 dhe konstatoi se viti i kaluar ishte relativisht i suksesshëm, sepse u mbështetën dhe u realizuan mbi 85 projekte të ndryshme të iniciuara nga Drejtorati dhe nga subjekte të tjera kulturore. Në bazë të këtij konstatimi, doli nevoja që këtë vit të hartohen strategji të reja, për ngritjen e cilësisë së projekteve dhe për orientimin kah investimet kapitale për ta përmirësuar sado pak infrastrukturën kulturore në Prishtinë e rrethinë.

Në gjashtë muajt e parë të këtij viti, u realizuan dhe u mbështetën mbi 65 projekte të vogla dhe të mëdha, të cilat shënuan ngritje të jetës kulturore në qytetin e Prishtinës dhe në viset rurale.

U rinovua dhe u promovua Shtëpia e Kulturës në fshatin Bardhosh. U rinovua në tërësi shtëpia e Kulturës në Keqekollë. U rinovua dhe u promovua shtëpia e Hivzi Sylejmanit dhe iu dha në shfrytëzim Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. U hap tenderi për projektin e renovimit të teatrit “Dodona” në Prishtinë. U pajis me inventar të ri salla e Teatrit të Brinjëve të qytetit të Prishtinës. Kjo sallë gjendet në lokalet e shkollës fillore “Emin Duraku” në Prishtinë. Me nga 30 ulëse u pajisën dy biblioteka që do të hapen së shpejti. Drejtorati ka participuar me mjete financiare në lyerjen e jashtme të Teatrit Kombëtar. Është bërë pasurimi i bibliotekës “Hivzi Sulejmani” me 1418 tituj të rinj, apo 7547 ekzemplarë. Është bërë adaptimi i objektit në Shkollën Fillore në Kishnicë për bibliotekë publike, si dhe është bërë përgatitja e projektit për adaptimin e objektit për bibliotekë publike në fshatin Shkabaj.

Në lëmin e veprimtarisë botuese, Drejtorati për Kulturë e ka mbështetur botimin e 6 veprave kryesisht të autorëve të rinj dhe atë: “SYTË E MI JON” të autores Arbnore Pllana, “U RRITSH ME LULET E BOTËS”, i autorit Bahtir Hamza, “PËRTEJ HESHTJES” Jeton Kelmendi, “NËPËR KOHË”, Remzi Limani, “GURË ME RRËNJË” Ali Sh. Berisha, “MONOGRAFIA E KATARINA JOSIPIT”, “ARNAVUD-ARTISTËT SHQIPËTAR NË PERANDORINË OSMANE “ ”GJYSHJA MBRETËRESHË E PRINCI NË SHTËPI” të Jonuz Fetahajt, “NËPËR KOHË” të Rudina Bërdynajt, Monografia e karikaturave të Veli Blakçorit, “ÇËSHTJA E SIGURISË NACIONALE TË KOSOVES” të gjeneral Ramadan Qehajës, “GOMARI QE DESHI TË BËHEJ MBRET” I Arif Demollit dhe Manifestimi letrar për të rinj “MUZAT POETIKE “që e realizoi klubi letrar i Prishtinës “HILMI RAKOVICA”.

Nga veprimtaria teatrale kemi mbështetur këto projekte: FESTIVALIN E TEATROVE PROFESIONALE “KOSOVA INFEST”, teatri i fëmijëve, kukullave dhe të rinjëve “DODONA” pjesëmarrje në Festivalin e Parisit me shfaqjen e Bekim Lumit” MËSIMI”, pjesëmarrjen e teatrit “DODONA” në Festivalin e Pogradecit me shfaqjen me

kukulla të Melihate Qenës “GONI TROZOVAQI”, pastaj realizimin e shfaqjes së Xhemail Lutës “PALLATI 176” që e përfaqësoi Prishtinën në Festivalin e Teatrove të Kosovës në Ferizaj dhe të Fushë-Kosovës, shfaqjen teatrale të Artur Tahirajt “ÇELËSI”, shfaqjen teatrale te Akademisë së Arteve që mori pjesë në Festivalin e Çekisë dhe për rolin kryesor të femrës aktorja Yllka Gashi u shpërblye me Çmimin e Parë të jurisë.

Pasi veprimtaria filmike nuk ka shënuar rritje, këtë vit i kemi përkrahur me mjete simbolike katër projekte “GOMARËT E KUFIRIT” të Jeton Ahmetajt, filmin e shkurtër të Agron Maliqit, filmin e shkurtër “LAMTUMIRË GJON” të Shotë Bukoshit dhe filmin e shkurtër të Kushtrim Hoxhës. Në Javën e Filmit Shqiptar për Fëmijë u shfaqën 12 filma për fëmijë të metrazhit të gjatë dhe të vizatuar.

Nga lëmi i muzikës i kemi përkrahur gati të gjitha shoqëritë kulturo-artistike që vepronë në Prishtinë dhe rrethinë dhe atë: SHKA “Qamili i Vogël”, “Malësia e Gollakut”, “Dervish Shaqa”, “Hivzi Sylejmani”, “Gerçek”, “Ars Kosova”, “Qamëria”, “Minatori i ri” dhe Orkestri frymor i qytetit të Prishtinës etj.

Pjesëmarrja e grupeve artistike të Prishtinës në festivalet e ndryshme ishte relativisht e kënaqshme, me ç’rast Drejtorati i ka përkrahur disa nga këto si pjesëmarrjen e Qendrës së Pionierëve në Festivalin e Silivrit në Turqi, pastaj pjesëmarrjen e SHKA “Gerçek” në Festivalin e Ankarasë, pastaj pjesëmarrjen e teatrit “Dodona” në dy Festivale (Paris dhe Pogradec), realizimi i Festivalit “TALENTËT E RINJË TË MUZIKËS SERIOZE” TE REGJIONIT TË PRISHTINËS, “SHOW FESTI”, pjesëmarrjen e SHKA “Qamili i Vogël” dhe “Dervish Shaqa” në Elbasan e Deçan, SHKA “Hivzi Sylejmani” në Festivalin e Klinës, realizimi i Festivalit të Folklorit në Prizren nga “LOTI DHE KUJTIMI”, që është realizim i Festivalit tashmë tradicional SKENA E RE MUZIKORE E PRISHTINËS.

Manifestimet tradicionale të Prishtinës edhe këtë vit i kemi realizuar në tërësi dhe me ngritje të cilësisë: “DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE”, “DITA E PRISHTINËS”, “MATURIADA”, “KARVANI I SHKRIMTARËVE PËR FËMIJË”, “PANAIRI I GJASHTË I LIBRIT”, “35- VJETORI I VDEKJES SË KATARINA JOSIPIT”, “OLIMPIADA KULTURORE E QERDHEVE TE FËMIJËVE TE PRISHTINËS”, “SFILATA E MODËS E GJIMNAZIT “SAMI FRASHËRI” NË PRISHTINË”, FESTIVALI TRADICIONAL I FËMIJËVE “YLBERI I PRISHTINËS”, FESTIVALI I MUZIKËS KAMERTALE “KAMERFEST” FESTIVALI I FLAUTËS “TINGUJT E FLAUTIT” FESTIVALI EVROPIAN NE TIRANË KU MORI PJESE KORI “XIXËLLONJAT”, FESTAT E FUNDVITIT (DITA E FLAMURIT, KRISHTËLINDJET DHE VITI I RI), si dhe shumë manifestime të tjera në Prishtinë dhe jashtë saj.

Punë të madhe dhe suksese të shënuara kanë arritur edhe institucionet kulturore të Komunës si:

BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE “HIVZI SYLEJMANI”

Gjatë muajit janar, udhëheqja e kësaj biblioteke e bëri rregullimin e koleksionit të librit në Fushë-Kosovë. Po ashtu e mbajti edhe manifestimin e dhënies së shpërblymit për tre lexuesit më të mirë, pastaj mori pjesë në Seminarin që e organizoi Ministria e Kulturës. Gjatë muajit shkurt e bëri promovimin e librit “NË SYTË E SHPRESËS” së Donjeta Gashit. Në Bibliotekën “Përrallat” u organizua takim me kompozitorin Andin Randobrava, i cili bisedoi me fëmijë për krijimtarinë e tij muzikore për fëmijë. Po ashtu u organizuan edhe takime të tjera me lexues e krijues, të dobishme për veprimtarinë bibliotekare. Ishin shkrimtarët si Jeton Kelmendi, Avdi Shala, Hajro Ulqinaku, pastaj veteranët e Arsimit Mehmet Gjevori, Haki Krasniqi, Ali Bajgora etj. Në vazhdimësi u kontrolluan dhe u mbikëqyrën bibliotekat në viset rurale dhe ato regjionale.

Gjatë muajt prill u shënuara Java e Bibliotekave e organizuar nga BKUK, e cila u përcoll me aktivitete të shumëta artistike dhe bibliotekare. Gjatë muajit maj u mbajtën shumë manifestime të tjera si: Ora letrare e Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë, në të gjitha degët e bibliotekës (14 degë). U bë edhe prezentimi i shumë revistave dhe veprave me vlerë të autorëve të huaj, të cilët e patën rastin të takohen drejtpërdrejtë me lexues, ndërsa gjatë muajit qershor ishte muaji i takimeve të aktorëve tanë me lexues. Bibliotekën e vizituan Leze Qena, Luan Jaha, Dibran Tahiri, etj.

Në gjashtëmujorin e dytë është bërë revizioni i fondit të librit dhe janë hequr nga përdorimi i librave të dëmtuar dhe ata të cilët më nuk janë të nevojshëm të qëndrojnë në raftet e bibliotekave. Kjo punë ka zgjatur deri më 26 tetor të vitit 2004. Është bërë një koordinim i mirë i Bibliotekës së Prishtinës, përkatësisht i Bibliotekës Ndërkomunale të Prishtinës dhe bibliotekave të tjera të regjionit si në Kastriot, Besianë, Drenas, Lypjan dhe Fushë-Kosovë.

Këtë vit biblioteka është pasuruar me 1.418 tituj me 7.547 ekzemplarë. Në Bibliotekën “Hivzi Sulejmani” merren edhe gjashtë gazeta me pagesë dhe pa pagesë si të përditshmet “Koha ditore”. Bota sot”, “Zëri”, “Pavarësia” dhe “Epoka e re”, ndërsa tri prej tyre “Koha Ditore”, “Bota sot” dhe “Zëri” lidhen dhe ruhen në sektorin e periodikut. Këtë vit për herë të parë doli edhe revista e parë letrare për të rinj “OAZA”, të cilën e boton Biblioteka për t’i afirmuar talentët e rinj. Kjo bibliotekë ka 5.101 anëtarë dhe 72.175 libra të lexuar.

ARKIVI I QYTETIT

Në gjashtë muajt e parë të këtij viti ishte paraparë rregullimi I Arkivit të Gjykatës së Rrethit në Prishtinë dhe atë që nga vitit 1945 e deri në vitin 1963 dhe 1964-1983. Nëse këtë punë e shikojmë në prizmin statistikor, atëherë shihet se lëndë civile kontestimore në periudhën 1945-1963. Gjykata e Rrethit të Prishtinës ka pasur 6.694 lëndë arkivore në periudhën 1964-1983, 7572 lëndë arkivore, po ashtu lëndë civile kontestimore. Janë tiktuar 429 lëndë të Gjykatës komunale të Prishtinës, ndërsa me lëndë arkivore janë pajisur 240 palë, që e kanë kërkuar ndihmën e Arkivit, ndërsa institucionet shtetërore janë pajisur me 360 lëndë arkivore të kërkuara. Ky arkiv gjatë vitit 2004, ka punuar në kushte të vështira mirëpo me angazhimin e Drejtoratit për Kulturë dhe Gjini, si dhe të strukturave të tjera të Komunës, Arkivi i Qytetit së shpejti do të vendoset në ndërtesën e re (ish-Shkolla e Mesme Teknike), e cila është një zgjidhje e kënaqshme dhe krijon kushte për punë normale të Arkivit të Qytetit.

INSTITUTI I MONUMENTEVE

Gjatë kësaj kohe është bërë prezentimi i zbulimeve arkeologjike të Keqekollës nga epoka e hershme e hekurit. Po ashtu ka marrë pjesë aktive në përpilimin e Hartës Arkeologjike të Kosovës, si dhe është bërë njohja me lokalitetet si në Sharban, Siçevë e Zajçevc, ku supozohet se ka trashëgimi të pasur arkeologjike.

Vlenë të theksohet edhe puna e madhe që po bëhet në bashkëpunim me Institutin shtetëror të Kosovës për përgatitjen e dokumentacionit teknik për dy kulla të Drenicës, fotodokumentacioni i Hamamit të Prishtinës, incizimi i tri kullave në Korreticë të Ulët dhe dy në Abri, përgatitja e raportit për kishat e djegura nga ngjarjet e marsit, përgatitja e raportit për atelenë e djegur të Agim Çavdarbashës, prezantimi i bërthamës së qytetit të Prishtinës dhe Tyrbes së Sulltan Muratit në Mazgit. Një punë intensive hulumtuese ka vazhduar edhe në gjysmën e dytë të vitit 2004.

Po ashtu është bërë përgatitja e dokumentacionit për rrethinën e vendzbulimit arkeologjik të Artanës. Është bërë konservimi dhe restaurimi i 18 enëve të qeramikës nga varrezat dardane të Keqekollës, si dhe është hulumtuar rrethina e Besianës dhe Prishtinës. Është përgatitur projekti për sanimin e Tyrbes së Sulltan Muratit dhe të Bajraktarit në Mazgit e Gazimestan. Tani është duke u punuar me të madhe në paramasën orientuese të Hamamit të Prishtinës për restaurim dhe konservim.

TEATRI I TË RINJVE, FËMIJËVE DHE KUKULLAVE “DODONA”

Edhe teatri “Dodona” ka pasur një veprimtari të ngjeshur gjatë këtyre gjashtë muajve të kaluar. Ka realizuar tri premiera (dy për të rritur dhe një për fëmijë) dhe atë PROFESOR 6, TURNI I NATËS DHE MINUKU LOZONJAR. Janë ripërpunuar dhe kthyer në skenë GONI TRAZOVAQI DHE KOMEDIA SHQIPTARE. Janë realizuar edhe mbi 106 repriza të shfaqjeve të ndryshme ku kanë kaluar mbi 10.000 shikues me një mesatare të shikueshmërisë së shfaqjeve 88 shikues për çdo shfaqje. Siç kemi theksuar edhe me lartë, teatri ka marrë pjesë në të gjitha Festalet që mbahen në Evropë dhe ka organizuar edhe manifestime të tjera nga fushëveprimi kulturo-artistik. Në dhjetor të vitit 2004, ka filluar

renovimi i objektit, i cili do të bëhet në dy faza dhe do të zgjas deri në qershor të vitit 2005. Gjatë kësaj kohe, të gjitha shfaqjet do të mbahen në skenën e Teatrit Kombëtar. Vlenë të theksohet se gjatë vitit të kaluar, punë të madhe ka bërë edhe Bordi i teatrit dhe anëtarët e tij, që janë caktuar nga Asambleja komunale e Prishtinës.

QENDRA E PIONIERËVE, 2000

Është institucion i rëndësishëm për jetën kulturo-artistike dhe argëtuese të fëmijëve të qytetit. Gjatë kësaj periudhe ka realizuar 10 programe artistike të kombinuara kolazh. Vlen të përmendet përgatitja e koreografive të reja nga muzika folklorike, kultivimi dhe realizimi i muzikës për fëmijë, asaj solistike dhe korale, përgatitja e një ekspozite me vizatime të fëmijëve etj.

Qendra e pionierëve ka marrë pjesë në Festivale ndërkombëtare dhe vendore dhe në të gjitha manifestimet e organizuara në qytet me rastin e festave të ndryshme. Në pjesën e dytë të vitit ka vazhduar puna me fëmijë ku ka përgatitur disa valle të reja, ka mbajtur orë të reja letrare për fëmijë dhe programe muzikore ku janë animuar mbi 550 fëmijë moshash të ndryshme. Vlenë të theksohet se Qendra e Pionierëve punon në kushte shumë të vështira për shkak të mungesës së objektit në të cilin punon.

TEATRI I TË RINJVE TË QYTETIT

Ky teatër edhe pse punon në kushte jashtëzakonisht të vështira, në saje të punës së palodhshme të trupës, regjisorit dhe ndihmës së pakursyer të Drejtoratit për Kulturë e Gjini, arriti të realizojë një shfaqje jashtëzakonisht simpatike “PALLATI 176” me të cilën me sukses e përfaqësoi Prishtinën në Festivalin e Teatrove Amatore të Kosovës në Ferizaj, duke fituar dy shpërblime të rëndësishme. Duhet theksuar se ky është teatri i vetëm amator i Prishtinës. Teatri e zhvillon veprimtarinë e vet në sallën e shkollës fillore “Emin Duraku” në Prishtinë. Në nëntor të vitit 2004, ka filluar realizimi i shfaqjes “E PËRHITURA“, e cila u shfaq në dhjetor të vitit 2004.

SEKTORI I GJINISË

Sektori për Gjini në projektet e realizuara natyrash të ndryshme që i përkrahën dhe mbështetën OJQ-të e grave, tregoi një sukses në ndjeshmërinë ndaj problemeve të gruas dhe njëkohësisht ndihmoi në krijimin e një imazhi të ri të gruas kosovare; imazhin e gruas aktive në zhvillimin e shoqërisë civile.

Gjatë kësaj kohe ka pasur një aktivitet të ngjeshur duke i përcjellur rregullisht të gjitha seminarët, debatet, mbledhjet, konferencat, panairët etj. që kanë të bëjnë me çështjet gjinore. Rregullisht ka kontaktuar dhe i ka mbështetur projektet interesante që e çojnë përpara afirmimin e gjinisë sidomos asaj femërore. Ka mbështetur projekte natyrash të ndryshme, si tryeza të rumbullakëta, trajnime, debate, kurse të ndryshme, pjesëmarrje të tyre në programet e organizuara nga Drejtorati për Kulturë dhe Gjini lidhur me rastin e festave të ndryshme, si dhe iu ka kushtuar kujdes të veçantë avancimit të pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.

Fushatën “Partitë politike punojnë për Gratë”, organizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës në bashkëpunim me OSBE-në, si dhe Drejtoratin për Kulturë e Gjini, ishte një debat në të cilin merrnin pjesë OJQ të ndryshme, si dhe personalitete të institucioneve. U diskutua dhe janë nxjerrur konkludime të ndryshme, si dhe rekomandime për rolin dhe ndikimin e gruas në partitë politike.

Ky sektor gjatë vitit të kaluar ka kontaktuar, punuar dhe debatuar në tryeza e trajnime të ndryshme me 17 OJQ, të cilat në mënyra të ndryshme merren me çështjet gjinore. Mbështetja dhe implementimi i projekteve të OJQ-së Qendra për Rehabilitimin e Nënës dhe Fëmijës, si dhe OJQ-ja “LULEBORA” lidhur me rastin e festës së 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Këto projekte të realizuara kishin për qëllim avancimin dhe ngritjen e nënave vetëmbajtëse në shoqëri, si dhe ngritja e pozitës së femrave nga viset rurale. Te arriturat e këtij projekti ishin avancimi dhe ngritja e tyre në lëmi të ndryshëm të jetës.

Projekti me temën “JETA NË PERIUDHËN E TRETË” i organizuar nga shoqata e grave pensioniste “VITA - JETA” në Prishtinë dhe i mbështetur nga Drejtorati për Kulturë dhe

Gjini ishte realizimi i trajnimit për mbijetesën e grave pensioniste. Edhe pse gratë pensioniste përballen me probleme të shumta në shoqërinë tonë, trajnimi kishte të arritura pozitive lidhur me zbutjen e problemeve të tyre si dhe vazhdimin e mëtejme të integritetit të tyre në shoqëri. Projekti gjashtëmujor i OJQ-së “ELDA” i mbështetur nga Sektori për Gjini i Drejtoratit për Kulturë dhe Gjini është realizuar në dy faza dhe është treguar shumë i suksesshëm. Ekziston konstatimi i ekspertëve se ky projekt është një shkollë gjashtëmujore, e cila e mbërrijti qëllimin e vet duke aftësuar për shkrim-lexim mbi 60 femra te komuniteteve te ndryshme (shqiptarë, ashkali, turq etj). Qëllimi i projektit ishte ngritja arsimore dhe integrimi i femrave të të gjitha etniteteve në shoqërinë kosovare.

Konferenca “A jemi në rrugë të drejtë të fuqizimit të grave”? nga KËI ishte një konferencë që kishte për qëllim që të përpilojë konkluzat dhe rekomandime për veprim, të cilat çojnë drejt fuqizimit të grave dhe me qëllim të promovimit të barazisë gjinore gjatë periudhës së tranzicionit të Kosovës, si dhe t’i bashkojë gratë e Kosovës me hisenikët e shoqërisë civile, Qeverisë dhe sektorit privat.

“Fuqizimi i Grave ne Sindikatë” nga “Fridrich Ebert Stiftung” dhe Rrjeti i Grave Sindikaliste të Kosovës, ishte një konferencë kombëtare që kishte për qëllim implementimin e programit pozitiv për fuqizimin e gruas në Sindikatë, si dhe shoqërisë civile, pastaj bashkëpunimi me interes për respektimin e çështjes gjinore, si dhe rrjetëzimi i grave sindikaliste me sektorë të tjerë të shoqërisë duke i përfshirë OJQ-të e grave brenda dhe jashtë shtetit.

Trajnimi i OJQ-së “Bardha” ishte një kurs i rrobaqepësisë dhe trokovatje që për qëllim e kishte ngritjen e disa femrave në shoqëri, ku kanë përfituar mbi 30 femra. Të arriturat e projektit ishin kyçja e shumicës në proceset zhvillimore që krijon një strategji për emancipimin e tyre, si dhe pasqyrimin e statusit të tyre në shoqëri. Projekti me titull: “Edhe ne dimë të votojmë” i organizuar nga OJQ – VIOLET dhe i mbështetur nga Drejtorati, kishte për qëllim sensibilizimin e femrave për të dalë në zgjedhjem, si dhe përfaqësimin e tyre në vendimmarrje. Ishte një projekt i cili pati mjaft sukses.

JETA KULTURORE NË GRAÇANICË

Jeta kulturore në Graçanicë e rrethinë është zhvilluar kryesisht në Shtëpinë e Kulturës “GRAÇANICA”. Edhe pse në kushte shumë të vështira, gjatë vitit 2004 janë zhvilluar një varg aktivitete, të cilat kanë shënuar rezultate shumë të mira.

Gjatë muajt janar 2004, në Galerinë e Shtëpisë së kulturës është mbajtur një orë e madhe letrare me rastin e Kërshëndellave ortodokse, pastaj janë organizuar 8 mbrëmje argëtuese, një mbrëmje muzikore me grupin “TRIK FX” dhe shumë manifestime të tjera. Në muajin mars, veç diskotekës, e cila ka punuar rregullisht. Po ashtu edhe Klubi letrar “NIKONAR” ka organizuar mbrëmje letrare me shkrimtarët e rinj.

Gjatë muajve prill, maj e qershor janë mbajtur shumë manifestime nga grupi letrar “NIKONAR”, pastaj nga çerdhja e fëmijëve “GJURGJEVAK”, me ç’rast mori pjesë edhe ylli i muzikës Sllagjana Delibashiq. Po ashtu u mbajt KOLONIA TRADICIONALE E ARTISTËVE, u zgjodh bukuroshja e Kosovës për Graçanicën, u mbajt një koncert i shkollës së muzikës “STEVAN MOKRANJAC”, u promovua libri i shkrimtarit Ivan Ivanoviq, pastaj u mbajt ekspozita e madhe tradicionale “GRAÇANICA 2004”, si dhe u organizuan shumë manifestime tjera.

Gjatë muajve të verës u realizuan shumë programe që kishin karakter argëtues si p.sh. mbrëmjet humoristike e muzikore, ku morën pjesë artiste të njohur të estradës, teatrit dhe veprimtarive të tjera kulturore.

Në shtator, fillon sezoni i ri artistik dhe atë pikërisht me grupet artistike amatore vendase dhe nga trevat të tjera të Kosovës, si nga Shtërpca, Beogradi, Kusca, etj. Nga grupe të ndryshme amatore u realizuan edhe disa drama për fëmijë si: “KËSULKUQJA” dhe “KUTIA MAGJIKE”. Sektori për Gjini po ashtu ka mbajtur disa seminare dhe trajnime te ndryshme me ndihmën e donacioneve ndërkombëtare nga Norvegjia “GRATË DINË DHE MUND TË UDHËHEQIN”. Pasi viti i kaluar ishte viti i zgjedhjeve në Kosovë, OSBE-ja mbajti shumë seminare lidhur me procesin e zgjedhjeve. Organizata ndërkombëtare OKSFAM ka mbajtur disa ligjërata me temën “DHUNA NË FAMILJE” dhe seminare tjera për AIDS-in. Një punë

të mirë kanë bërë edhe bibliotekat si degë të bibliotekës “HIVZI SYLEJMANI” të Prishtinës. Edhe pse në kushte të vështira dhe me mjete minimale financiare, në këtë pjesë të Komunës së Prishtinës është arritur që të krijohet një ambient kulturor i begatshëm.

REKAPITULIM

1. Investimet kapitale në infrastrukturë

-Renovimi i teatrit “DODONA”, faza e pare (përfshirë këtu edhe projektin)	97.544€
-Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Bardhosh.....	24.000€
-Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Keqekollë.....	9.700€
-Renovimi i bibliotekës në Kishnicë (përfshirë ketu8 edhe projektin).....	4.730€
-Renovimi i fasadës së Teatrit Kombëtar.....	5.886€

Gjithësej: 141.860 €

2. Investimet për pasurimin e fondit të librit në bibliotekën e qytetit.

- Pasurimi i fondit të librit	12.900€
-------------------------------------	---------

3. Shpenzimet për festivale në vend dhe jashtë vendit.

- Kosova-Infest (Festivali Ndërkombëtar i Teatrove Profesionale të Evropës i mbajtur në Prishtinë prej datës 1 deri me 10 tetor, 2004.).....	20.000€
- Festivali i talentëve të rinj.....	1.200€
- Festivali i muzikës folklorike në Prizren.....	1.700€
- SHOW FEST.....	3.000€
- Ylberi i Prishtinës	18.000€
- Festivali në Silivri - Turqi.....	5.000€
- Skena Muzikore e Prishtinës.....	10.000€
- Kamerfest (Festivali i muzikës kamertale).....	2.000€
- Tingujt e Flautit.....	2.500€
- Festivali i Ankarasë (SHKA GERÇEK).....	1.200€
- Festivali i Durrësit	2.100€
- Festivali i Teatrit në Paris “DODONA” me shfaqjen MËSIMI).....	2.400€
- Festivali i Çekisë (Teatri Alternativ për fëmijë -Zana Hoxha)	1.500€
- Festivali i dramës për fëmijë në Tunis. Skena alternative- Jeton Neziraj).....	1.000€
-Festivali i teatrove me kukulla në Pogradec “DODONA”.....	2.500€
-Festivali Ballkanik i Teatrove për Fëmijë në Tiranë “DODONA”.....	2.000€
-Festivali i Koreve të fëmijëve në Tiranë “XIXËLLONJAT”	1.792€

Gjithsej për festivale: 77.892 €

4. Veprimtaria botuese.

- Botimi i tri monografive dhe 5 veprave letrare.....	10.092 €
-------------------------------------------------------	----------

5. Manifestimet e ndryshme

- Dita e Prishtinës.....	10.972 Euro
- Dita e shpresës (Sulmet e NATOS).....	2.100
- Karvani i shkrimtarëve.....	3.000
- 1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	8.724
- Ditët e Filmit Shqiptar të fëmijëve (12 filma).....	2.000
- 2 Korriku	2.000
- Maturiada	8.546
- Olimpiada e Fëmijëve	500
-Panairi i Librit, 2004.....	1.200

- Qendra e Pionierëve (Ekspozita për nënën më 8 Mars).....	1.450
- Spektakli - Top modelja kosovare.....	500
- Kremtimi i ditës së Bajramit të Madh.....	1.100
- 28 Nëntori (Muzat poetike).....	2.500
- 30 Vjetori i punës së Venera Mehmetagajt.....	1.500
- Bienali i Pikturës në Tiranë.....	1.000
- Bienali i Pikturës SHAFK.....	800
- Harta Arkeologjike e Kosovës	500
- Arkivi i Qytetit (pjesëmarrje në takimet e arkë. Në Tiranë.....	600

Gjithësej për manifestime: 46.592 €

Projektet e shoqërive kulturo-artistike

- Orkestri frymor i Qytetit	1.200 €
- SHKA “Qamili i Vogël”.....	500
- SHKA “Çamëria”	1.500
- SHKA “Minatori i Ri”	1.200
- SHKA “Dervish Shaqa”.....	800
- Teatri i të Rinjëve të Qytetit.....	4.000
- Teatri Alternativ (Shfaqja Çelësi).....	500

Gjithësej projektet e shoqërive kulturo-artistike..... 10.500 €

Projektet filmike

- Gomarët e kufirit (Jeton Ahmetaj).....	2.100 Euro
- Fole një fjalë Gjon (Shota Bukoshi).....	600
- Agron Maliqi (Zonja e madhe) film dokumentar.....	500

Gjithësej projekte filmike 3.200 Euro

SEKTORI I GJINISË

- Qendra për Rehabilitimin e Nënës dhe Fëmijës	680 €
- OJQ “Lulebora”.....	650 €
- OJQ “Bardha” (kurs rrobaqepësie).....	600 €
- OJQ “Vita Jeta” (gratë pensioniste).....	300 €
- OJQ “Elda” (kurs 6 mujor për zhdukjen e analfabetizmit në fshat.....	3.000 €
- OJQ “Vor Fashen” (promovim manekinet e reja)	400 €
- OJQ “Shpresa” (Emine Syla – Handikap).....	500 €
- Gjumnazi “Sami Frashëri” (svilatë mode e të rejave dhe të rinjve).....	420 €
- Shoqata Ndërkombëtare për Edukim Muzikor –Besa Shema	1.500 €
- Florita Dërguti (pjesëmarrje në Fest. Në Tiranë (EPTA).....	300 €
- Handikap Kosova (Manifestimi qendror dhe ekspozita).....	2.500 €
- Shoqata e gruas “Lulishtja e ndalë dhunën”.....	470 €
- Shoqata e të Verbërve	450 €
- OJQ “VIOLETË” (Edhe gratë dinë të votojnë - trajnim.....	1.500 €
- OJQ “Dera e hapur” (Seminar tre ditor për femra).....	700 €
- OJQ “Kalabria” (seminar me gratë që u janë vrarë burrat në luftë)	970 €

Gjithësej për Sektorin për Gjini 12. 520 €

Gjithësej mjete të realizuara nga Drejtorati për Kulturë dhe Gjini..... 315. 556 €

ZYRA E BASHKËSIVE

Zyra komunale e bashkësive gjatë vitit 2004 ka funksionuar në harmoni me destinimin që si servis t'i afrojë shërbimet komunale bashkësive joshqiptare dhe në përputhje me rregullativat komunale në fuqi. Komuna përmes Zyrës së bashkësive intensivisht është kujdesur për nevojat e bashkësive: serbe, rome, ashkali, boshnjake, turke dhe të tjera, në harmoni me mundësitë dhe obligimet e saj.

Duke pasur parasysh se Zyra punon në kuadër të tre sektorëve, atëherë do të parashtrojmë më shumë detaje në kuadër të rezultateve të tyre.

• Shërbimi i administratës së përgjithshme dhe financave

Në periudhën raportuese, shërbimi i administratës së përgjithshme kryesisht ka punuar në drejtimin e respektimit të obligimeve të punëtorëve në vendin e punës, ka hartuar planin e punës për vitin vijues, aplikimin e urdhërësive të UNMIK-ut, si dhe në aplikimin e udhëzimeve administrative për punën e shërbimeve në Kosovë. Në aplikimin e drejtë të udhëzimeve administrative, kemi pasur një varg kontaktesh personale me drejtoratet në Prishtinë.

Kontaktet e shërbimit të administratës së përgjithshme me kolegët nga Prishtina janë bërë sipas nevojës dhe të njëjtat kanë qenë të natyrës profesionale dhe kryesisht korrekte.

Ka pasur edhe vizita të kolegëve shqiptarë në Zyrën e bashkësive në Graçanicë.

Në fund të vitit kalendarik, Shërbimi e ka bërë vlerësimin e suksesit të realizimit të detyrave të punës për secilin punëtor, me ç'rast është konstatuar se dy punëtorë kryesisht i kanë kryer me sukses obligimet e punës, pra sukcesi kryesisht ka qenë i kënaqshëm. Po ashtu është hartuar plani i punës i Shërbimit për secilin individ, i cili do të jetë krah i punës për vitin e ardhshëm afarist.

Shërbimi i financave, po ashtu e ka hartuar planin financiar të punës, si për pjesën "Malli dhe shërbimet" e po ashtu dhe për pjesën e mjeteve financiare për investime kapitale. Buxheti për vitin 2004 është realizuar në përputhje me planin, të cilin e karakterizojnë këto të dhëna themelore:

- malli dhe shërbimet.....73.048 euro
- investimet kapitale.....493.951 “
- rrogat e të punësuarëve.....59.946 “
- donacionet.....179.921 “

Për realizimin e këtillë, gjithësesi ka merita bashkëpunimi udhëheqja e Zyrës me drejtoratet përkatëse të Komunës.

Shërbimi i përgjithshëm dhe ai financiar në vitin raportues, ka punuar edhe në programin e ofrimit dhe sendërtimit të ndihmës sociale, ku ka qenë edhe i kyçur, kështu që përmes kësaj pjese të ngarkesës është realizuar shpërndarja e materialit për djegie për rastet sociale të të gjitha bashkësive etnike që i takojnë Zyrës së bashkësive në Graçanicë.

• Shërbimi i arsimit dhe i shëndetësisë

Në reduktimin që është bërë në maj të vitit 2004 dhe që ka të bëjë me personelin administrativ dhe ndihmës në institucionin parashkollor dhe në shkollat fillore e të mesme në gjuhën serbe, të cilat funksionojnë në territorin e Komunës së Prishtinës, nga listat e rrogave janë shlyer rreth 160 punëtorë administrativë dhe ndihmës, si dhe punëtorët e ish-Ndërmarrjes së "Trafikut urban", të cilët kanë qenë të paguar nga Departamenti i Arsimit për shërbimet që kanë ofruar në kuptim të transportit të nxënësve.

Spektori i arsimit, në bashkëpunim me të gjitha shkollat, ia dorëzon faturat Departamentit të arsimit në Prishtinë për pagesën e llojeve të ndryshme të shpenzimeve, të qirave, të shpenzimeve materiale, të shpenzimeve për meremetimin e shkollave etj. Jemi të mendimit se procedura që nga dita e dorëzimit të faturës (e dokumentacionit komplete për pagesën e faturës), deri në ditën e realizimit është mjaft e gjatë (për disa pagesa procesi i realizimit ka zgjatur prej 5-6 muaj).

Regjistrimi i minibusëve shkollor është kryer. Është bërë kontrollimi teknik dhe sigurimi, pastaj vazhdimi i regjistrimit, krahas problemeve të mëdha me Shërbimin Doganor dhe Shërbimin për vazhdimin e regjistrimit të automjeteve (nga Spektori i ynë vazhdimisht është

kërkuar dokumentacioni shtesë, të cilin nuk e kemi pasur në shërbimin tonë, por ajo ka qenë në lokacione të ndryshme).

Nga data 27. 09. 2004 bëhet shpërndarja e shpenzimeve materiale nëpër të gjitha shkollat në territorin e Komunës së Prishtinës, e cila përmban materialin shpenzues (materiale të rrymës elektrike dhe të ujit, rekuizitat sportive, materialin e zyrave dhe atë higjienik) me vërejtje se për shkak të mungesës së mjeteve, të gjitha shkollat nuk kanë marrë shpenzime materiale. Në kuadër të shkollës fillore “Milladin Mitiq” në Llapnasellë është ndërtuar objekti i ri – shkolla për arsimin special, si projekt i MUNT-it. Projekti është kryer me sukses, por mbetet që i njëjti të pajiset me inventar për nxënësit me nevoja speciale. Në muajin korrik të vitit 2004, në bisedë me të gjithë drejtorët e shkollave, është dakorduar që të bëhet nivelizimi i fondit të orëve (zvogëlimi i fondit të orëve në bazë të numrit të nxënësve), punë kjo që ka vazhduar muajin shtator kur aty për aty me kontrollimin e orarit të orëve, është bërë nivelizimi i fondit të orëve për personelin mësimor.

Çdo muaj, Shërbimi i arsimit i Zyrës komunale të bashkësisë në Graçanicë ka pasur probleme lidhur me ndryshimet në listat e rrogave. Numri i vogël i formularëve që i kemi dërguar, nuk ka qenë i realizuar krahas shpjegimeve të përhershme gojore nga ana e zyrtarit të Komunës së Prishtinës, Xhevat Hajdari. Për shkak të situatës së këtillë, disa herë kemi arritur në situatë problematike me punëtorët e arsimit, që është dashur të jenë të paguar nga ana e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës. Si pasojë e fakteve të theksuara, dy drejtorë të shkollave kanë qenë të shlyer nga regjistri i rrogave (i Shkollës së Mjekësisë dhe asaj të Ndërtimitarisë dhe Komunikacionit).

Në pjesën e shëndetësisë primare, fatkeqësisht nuk kemi pasur rezultate duke pasur parasysh se drejtori aktual i këtij institucioni e ka refuzuar bashkëpunimin me Zyrën tonë.

- **Shërbimet publike**

Në kuadër të Shërbimit për Shërbime Publike veprojnë këta sektorë:

- infrastruktura dhe planifikimi,
- shërbimi i inspektionit,
- shërbimi i gjeodezisë – gjeometri dhe
- koordinuesi për zhvillim ekonomik.

Për periudhën e theksuar të raportimit janë paraparë dhe realizuar mjaft projekte, të cilët ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës së bashkësisë joshqiptare të Komunës së Prishtinës. Përmes këtij raporti, do t’i pasqyrojmë projektet e realizuara.

Projektet e realizuara:

- sanimi i rrugëve lokale,
- rregullimi i varrezave ortodokse në Prishtinë,
- punimi i trafostacionit me shtylla në Shushicë,
- sanimi i ndriçimit rrugor në fshatra,
- punimi i urës B.A. në Preoc,
- shenjimi i komunikacionit në fshatra,
- pastrimi i deponive të bërlllogut në fshatra,
- sanimi i brigjeve të lumit Graçanka,
- punimi i rrjetit të kanalizimit në Llapnasellë,
- betonimi i platosë së shkollës në Kishnicë,
- punimi i rrjetit të ujësjellsit në Çagllavicë,
- rregullimi i lokacionit të parkingut në Graçanicë dhe të tjera.

Projektet e realizuara për bashkësitë joshqiptare

- sanimi i morgut të varrezave të romëve në Graçanicë,
- pajisja e qendrës informative të boshnjakëve,
- pajisja e shoqatës së turqëve në Prishtinë,
- punimi i trafostacionit në mëhallën e romëve në Graçanicë,
- asfaltimi i rrugës së ashkalive “Bedri Gjini” në Prishtinë.

Për projektet e theksuara, ekipi i ekspertëve i ZBK të Graçanicës e ka hartuar dokumentacionin e tërësishëm projektues-technik për të gjitha këto projekte.

Inspektorët po angazhohen dhe po punojnë në teren në bazë të kërkesave dhe lajmërimeve të qytetarëve në harmoni me autorizimet e veta. Ata po ballafaqohen me probleme të mëdha në terren, andaj edhe rezultatet janë minimale.

Në kuadër të Shërbimit të Gjeodezisë punon një gjeometër, ndërkaq puna e tij bazohet në terren në bazë të kërkesave të qytetarëve. Ai po ashtu punon edhe në hartimin e dokumentacionit projektues-technik.

Zyra e bashkësive në Sektorin për zhvillim ekonomik i ka zyrtarët e vet në Slivovë dhe Bërnice të Poshtme. Shërbimi i përmendur punon në përmirësimin e kushteve të jetesës së bashkësisë dhe këtë e bënë përmes donatorëve, të cilët e përkrahin zhvillimin e ekonomisë së vogël, të mesme dhe të bujqësisë, si dhe përmes projekteve që dalin nga Zyra.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr. _____ **Dt.** _____

KRYETARI I KUVENDIT

Ismet Beqiri